REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

KURRIKULA PËR SHKOLLAT ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK

ARSIMI BAZË DHE I MESËM I LARTË

DEGA: MUZIKË

KLASA: I-XII

Tiranë, 2016

IZHA
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

BASHËPUNUAN PËR PROGRAMET MËSIMORE:

Koordinatorë:

Majlinda HALA, IZHA

Drejtues dhe grupi i mësuesve të degës muzik, shkolla artistike “Jordan Misja”

Redaktor letrar: IZHA
Erida KOLECI

INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT 1
I. QËLLIMET E ARSIMIT ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA "MUZIKË" 4
II. PROFILI PROFESIONAL ARTISTIK I NXËNËSVE NË PËRFUNDIM TË ARSIMIT TË MESËM ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA "MUZIKË", ARSIMI 9- VJEÇAR DHE 3 -VJEÇAR. 4
1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë". 4
2. Kompetenca të përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit me drejtim të orientuar artistik, në degën "Muzikë". 4
3. Kompetenca specifike artistike të nxënësit në përfundim të arsimit me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë" 5
4. Mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të të arsimimit me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë". 5
III. PLANET MËSIMORE 5
1. Plani mësimor i arsimit bazë për shkollat artistike, viti shkollor 2016 – 2017, dega "Muzikë" 6
2. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike) ..... **Error! Bookmark not defined.**
3. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (artistike) ..... **Error! Bookmark not defined.**
4. Udhëzime për planin mësimor, dega "Muzikë", arsimi bazë dhe i mesëm i lartë (9+3). 8
IV. UDHËZIME PËR PROCESIN MËSIMOR, DEGA "MUZIKË", ARSIMI BAZË DHE I MESËM I LARTË (9+3 12
V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN DHE PROVIMET 12
VI. PROGRAMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE TEORIKO- ARTISTIKE 14
VII. PROGRAMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE PRAKTIKO- ARTISTIKE 28

I. QËLLIMET E ARSIMIT ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA "MUZIKË"

Qëllimi kryesor i arsimit në këtë degë është zhvillimi dhe formimi artistik i nxënësve për t'u perfeksionuar në veprimtari të ndryshme që lidhen me muzikën, si dhe krijimi i një personaliteti për të jetuar dhe për t'u përballuar me sfidat e ndryshme. Për të realizuar këtë, shkolla me drejtim të orientuar artistik, dega muzikë u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi;
- mundësi për të zhvilluar kompetencat profesionale të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar përparimin drejt arsimimit të mëtejshëm dhe drejt punësimit;
- mbështetje për t'u njohur me zhvillimet artistike bashkëkohore;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, përqendrimit dhe punës artistike;
- mbështetje për t'u zhvilluar dhe për t'u formuar artistikisht duke i shërbyer vetes dhe komunitetit ku jetojnë, përmes pjesëmarrjes në veprimtari të ndryshme artistike;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës artistike të punës individuale dhe në grup.

II. PROFILI PROFESIONAL ARTISTIK I NXËNËSVE NË PËRFUNDIM TË ARSIMIT TË MESËM ME DREJTIM TË ORIENTUAR ARTISTIK, DEGA "MUZIKË", ARSIMI BAZË DHE I MESËM.

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë".

Në shkollat me drejtim të orientuar artistik që ofrojnë arsimim në degën "Muzikë", kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

a) fillojnë për herë të parë arsimin e detyruar në klasën e parë, në ciklin fillor të arsimit bazë;
b) kanë mbaruar arsimin bazë në shkollat e muzikës;
c) kanë mbaruar arsimin bazë;
d) janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli arsimor profesional.

2. Kompetenca të përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit me drejtim të orientuar artistik, në degën "Muzikë".

Në përfundim të arsimit të mesëm me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë", sistemi (9+3), nxënësit do të zotërojnë këto kompetenca kryesore:

- komunikojnë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre, duke argumentuar opinionet për çështje të ndryshme profesionale dhe artistike;
- përdorin burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve artistike, të nevojshme për zhvillimin e tyre personal dhe artistik;
- zhvillojnë potencialin e tyre të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive në fushën e artit dhe të muzikës;
- angazhohen fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin artistik, personal dhe shoqëror;
- respektojnë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale;

- demonstrojnë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tyre;
- tregojnë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tyre artistike;
- organizojnë drejt procesin e të nxënit të tyre dhe shfaqin gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- respektojnë parimet e punës në grup dhe bashkëpunojnë aktivisht në arritjen e rezultateve të të nxënit;
- vlerësojnë dhe vetëvlerësojnë për të përmirësuar dhe për të çuar më tej arritjet e tyre artistike.

3. Kompetenca specifike artistike të nxënësit në përfundim të arsimit me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë"

Në përfundim të arsimit me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë", nxënësi do të jetë i aftë të ushtrojë kompetencat artistike si më poshtë:
- ka njohuri teoriko-muzikore në lëndët e historisë së muzikës, bazë për të kuptuar karakterin historik të muzikës në veçanti dhe të arteve në përgjithësi;
- formon njohuri teoriko-praktike muzikore në lëndët e solfezhit, harmonisë, analizës së veprave muzikore etj.;
- deshifron strukturat meloritmike përmes elementeve teknike të praktikave muzikore;
- zhvillon shprehitë e dëgjimit muzikor e ritmik për një perceptim të saktë intonativ në realizimin e diktateve ritmike dhe melodike;
- krijon njohuri teoriko-muzikore në specialitetin përkatës, bazë për të kuptuar dhe për të interpretuar vepra nga llojë të ndryshme muzikore;
- formon aftësi teoriko - praktike muzikore bazë për kuptimin dhe për interpretimin e veprave muzikore sipas stilit të epokave, mjedisit gjeografik, gjinive muzikore dhe personaliteteve;
- zhvillon njohuritë teoriko - praktike muzikore mbi mënyrën e ekzekutimit duke marrë shkas nga domethënia që vepra trajton;
- shpjegon tiparet themelore të kulturës muzikore sipas epokave historike bazuar në vepra të kompozitorëve të ndryshëm, të huaj dhe shqiptarë;
- njeh parimet bazë të ndërtimit të veprave muzikore;
- zbërthen veprat muzikore, duke përfuar prej tyre kënaqësi estetike;
- demonstron aftësitë e luajtjes së teknikave të instrumentit përkatës duke ekzekutuar me individualitet aftësitë e tij interpretuese në programin e diplomës;
- interpreton pjesë të ndryshme muzikore në instrument solo dhe në grup për t'u bërë pjesë në formacione të ndryshme orkestrale;
- zotëron elementet e teknikës vokale dhe interpreton me cilësi artistike pjesë të ndryshme muzikore që kërkon programi i diplomës.

4. Mundësitë e arsimimit të mëtejshëm dhe të punësimit në përfundim të të arsimimit me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë".

Përfundimi me sukses i i shkollës me drejtim të orientuar artistik, i pajis nxënësit me **diplomën dhe me certifikatën** e përfundimit të shkollimit.
Ky nivel dijesh i jep mundësi nxënësit të konkurrojë për të vazhduar studimet e larta në profesionin e tij në Akademinë e Arteve ose edhe në degë të tjera.

III. PLANET MËSIMORE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr……. Prot. Tiranë, më 2016

PLANI MËSIMOR I ARSIMIT BAZË, PËR SHKOLLAT ARTISTIKE[1], VITI SHKOLLOR 2016 - 2017

MIRATOHET

MINISTËR
LINDITA NIKOLLA

DEGA: MUZIKË

SPECIALITETET[2]: ***piano, violinë, violonçel, kitarë, flaut, klarinetë, fizarmonikë***

KLASAT										
SHKALLËT		**Shkalla 1**		**Shkalla 2**			**Shkalla 3**		**Shkalla 4**	
Nr	**FUSHAT/LËNDË**	**Klasa 1**	**Klasa 2**	**Klasa 3**	**Klasa 4**	**Klasa 5**	**Klasa 6**	**Klasa 7**	**Klasa 8**	**Klasa 9**
KURRIKULA E PËRGJITHSHME										
I	**GJUHET DHE KOMUNIKIMI**	**8**	**8**	**9**	**8**	**8**	**8**	**8**	**8**	**8**
1.1	Gjuhëshqipe	8	8	6	5	5	5	5	5	5
1.2	Gjuhë e huaj e pare	-	-	3	3	3	3	3	3	3
II	**MATEMATIKË**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**
III	**SHKENCAT E NATYRËS**	**1**	**1**	**1**	**2**	**2**	**2**	**4**	**6**	**6**
3.1	Dituri natyre	i	i	i	2	2	-	-		
3.2	Fizikë	i	i	i	i	I	1	2	2	2
3.3	Kimi	i	i	i	i	I	-	-	2	2
3.4	Biologji	i	i	i	i	I	1	2	2	2

[1]Ky plan mësimor fillon të zbatohet për here të pare në vitin shkollor 2016-2017, në klasat 1-2 dhe 6-7 për kulturën e përgjithshme dhe nga klasa e parë për kulturën artistike.
[2]Instrumentet fillojnë në klasë të parë dhe të gjashtë, si më poshtë:
- ***Klasa 1:*** Instrumentet: piano, violin dhe violonçel.
- ***Klasa 6:*** Instrumentet: kitarë, flaut, klarinetë dhe fizarmonikë.

3.5	Gjeografi	i	i	i	i	I	-	-	-	-
IV	**SHOQËRIA DHE MJEDISI**	**1**	**1**	**1**	**2**	**2**	**3**	**5**	**5**	**5**
4.1	Edukim përshoqërinë	1	1				-	-		
4.2	Qytetari	i	i	1	1	1	1	1	1	1
4.3	Histori	i	i		1	1	1	2	2	2
4.4	Gjeografi				i	I	1	2	1	1
V	**ARTE**	**1**	**1.5**	**2**	**1**	**1.5**	**2**	**1**	**1**	**1**
5.1	Art pamor	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.2	Teatër					0.5	1	-		
5.3	Kërcim	-	0.5	1						
VI	**EDUKIMI FIZIK, SPORTI DHE SHËNDETI[3]**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**
VI.1	Edukimifizik, sporti dhe shëdeti	2	2	2	2	2	2	2	2	2
VII	**TEKNOLOGJI DHE TIK**	**-**	**-**	**-**	**2**	**2**	**2**	**1**	**1**	**1**
7.1	TIK	-	-	-	1	1	1	1	1	1
7.2	Aftësimi teknologjik praktik	-	-	-	1	1	1	-	-	-
VIII	**KURRIKULA ME ZGJEDHJE[4]**	**1**	**1**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**	**2**
TOT I ORËVE KP		**18**	**18.5**	**21**	**23**	**23.5**	**25**	**27**	**29**	**29**
B	**KURRIKULA ARTISTIKE**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**4**	**5**	**5**	**5**
IX.1	Instrument sekondar (piano)	-	-	-	-	-	-	-	1	1
IX. 2	Solfezh	2	2	2	2	2	2	2	2	2
X	**SPECIALITET**									
X. 3	Instrument	2	2	2	2	2	2	2	2	2
	GJITHSEJ A+ B	**22**	**22.5**	**25**	**27**	**27.5**	**29**	**30**	**33**	**33**

[3]Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti, me planin e ri për këtë profil shkolle do të bëhet me 2 orë në javë.
[4]Kurrikula me zgjedhje (1/2 orë) përdoret ngashkollapër nevoja apo interesa të nxënësve në mësimin e një gjuhe të huaj të dytë, projekte kurrikulare, etj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr……. Prot. Tiranë, më 2016

PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ORIENTUAR (ARTISTIKE)[5], VITI SHKOLLOR 2016 – 2017

MIRATOHET
MINISTËR
LINDITA NIKOLLA

DEGA: MUZIKË
SPECIALITETI : ***piano, violinë, violë, violonçel, kontrabas, kitarë, flaut, klarinetë, firzamonikë***

Nr.	**Fushat e të nxënit/Lëndët**	**Shkalla 5**		**Shkalla 6**
		Klasa 10 *(orë/javë)*	**Klasa 11** *(orë/javë)*	**Klasa 12** *(orë/javë)*
A.	**KURRIKULA E PËRGJITHSHME**			
I.	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**	**5**	**5**	**6**
I. 1	Gjuhë shqipe	2	2	1
I.2	Letërsi	1	1	2
I.3	Gjuhë e huaj e parë	2	2	3
II.	**MATEMATIKË**	**2**	**3**	**3**
III.	**SHKENCAT E NATYRËS**	**5**	**0**	**0**
III.1	Fizikë	2	0	0
III.2	Kimi	2	0	0
III.3	Biologji	1	0	0
IV.	**SHOQËRIA DHE MJEDISI**	**4**	**5**	**0**
IV.1	Shkenca sociale (Qytetari[6] dhe Filozofi[7]	2	1	0
IV.2	Histori	1	2	0
IV.3	Gjeografi	1	2	0
V.	**TEKNOLOGJI DHE TIK**	**1**	**1**	**0**
V.1	TIK	1	1	0

[5] Ky plan mësimor fillon të zbatohet për herë të parë në vitin shkollor 2016-2017, në klasën e dhjetë.
[6] Qytetaria zhvillohet në klasën e 10të.
[7] Filozofia zhvillohet në klasën e 11-të.

VI.	**EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDETI**	**2**	**2**	**2**
VI.1	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2
	TOTALI I ORËVE	**19**	**15**	**10**
B.	**KURRIKULA ARTISTIKE**	**14**	**18**	**19**
VII	**LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE**	**5**	**5**	**3**
VII.1	Histori muzike	3(2+1)	3 (2+1)	3 (2+1)
VII.2	Foklor muzikor	2 (1+1)	2	0
VIII	**LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE**	**6**	**10**	**13**
VIII.1	Harmoni	0	3 (2+1)	3 (2+1)
VIII.2	Analizë muzikore e veprave	0	3 (2+1)	3 (2+1)
VIII.3	Teori solfezhi instrumentistë primarë	1	1	1
VIII.4	Orkestër/kor	2	2	2
VIII.5	Muzikë dhome	1	1	2
VIII.6	Orkestracion	0	0	2 (1+1)
VIII. 7	Instrument sekondar - zgjedhja e parë	1	-	-
8	Instrument sekondar - zgjedhja e dytë[8]	1	0	0
IX	**SPECIALITETI**	**3**	**3**	**3**
IX. 1	Specialitet: *piano, violinë, violë, violonçel, kontrabas, klarinetë, flaut, kitarë, firzamonikë*	3	3	3
C	**KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE**	**0-2**	**0-2**	**0-2**
TOTALI	**A+B +C (Nr. i orëve javore gjithsej)**	**33/35**	**33/35**	**29/31**

[8] Kjo lëndë do të zhvillohet nga të gjithë nxënësit, në klasën e 10, 11-të (një instrument popullor).

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr……. Prot. Tiranë, më 2016

PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ORIENTUAR (ARTISTIKE)[9], VITI SHKOLLOR 2016 – 2017

MIRATOHET

MINISTËR
LINDITA NIKOLLA

DEGA: MUZIKË
SPECIALITETI : ***Firzamonikë, korno, trombë, trombon, perkusion, fagot, kitarë, kanto, flaut, oboe, saksofon***

Nr.	**Fushat e të nxënit/Lëndët**	**Shkalla 5**		**Shkalla 6**
		Klasa 10 *(orë/javë)*	**Klasa 11** *(orë/javë)*	**Klasa 12** *(orë/javë)*
A.	**KURRIKULA E PËRGJITHSHME**			
I.	**GJUHËT DHE KOMUNIKIMI**	**5**	**5**	**6**
I. 1	Gjuhë shqipe	2	2	1
I.2	Letërsi	1	1	2
I.3	Gjuhë e huaj e parë	2	2	3
II.	**MATEMATIKË**	**2**	**3**	**3**
III.	**SHKENCAT E NATYRËS**	**5**	**0**	**0**
III.1	Fizikë	2	0	0
III.2	Kimi	2	0	0
III.3	Biologji	1	0	0
IV.	**SHOQËRIA DHE MJEDISI**	**4**	**5**	**0**
IV.1	Shkenca sociale (Qytetari[10] dhe Filozofi)	2	1	0
IV.2	Histori	1	2	0
IV.3	Gjeografi	1	2	0
V.	**TEKNOLOGJI DHE TIK**	**1**	**1**	**0**
V.1	TIK	1	1	0
VI.	**EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE**	**2**	**2**	**2**

[9]Ky plan mësimor fillon të zbatohet për herë të parë në vitin shkollor 2016-2017, në klasën e dhjetë.
[10] Qytetaria zhvillohet në klasën e 10- të dhe Filozofia në klasën e11të.

	SHËNDETI			
VI.1	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2
	TOTALI I ORËVE	**19**	**16**	**11**
B.	**KURRIKULA ARTISTIKE**	**20**	**25**	**23**
VII	**LËNDËT TEORIKE ARTISTIKE**	**5**	**5**	**3**
VII.1	Histori muzike	3(1+2)	3 (2+1)	3 (2+1)
VII.2	Foklor muzikor	2 (1+1)	2	0
VIII	**LËNDËT PRAKTIKE ARTISTIKE**	**10**	**16**	**16**
VIII.1	Harmoni	0	3 (2+1)	3 (2+1)
VIII.2	Analizë muzikore e veprave	0	3 (2+1)	3 (2+1)
VIII.3	Teori solfezhi instrumentistë sekondarë	5	4	4
VIII.4	Orkestër/kor	2	2	2
VIII.5	Muzikë dhome	0	2	2
VIIII.6	Orkestracion	0	0	2 (1+1)
VIII.7	Instrument sekondar - zgjedhja e parë	1	1	1
VIII.8	Instrument sekondar - zgjedhja e dytë	2	1	0
IX	**SPECIALITETI**	**4**	**4**	**4**
IX. 1	Specialitet: *Firzamonikë, korno, trombë, trombon, perkusion, fagot, kitarë, kanto, flaut, oboe, saksofon*	4	4	4
	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE[11]	**0-2**	**0-2**	**0-2**
TOTALI	**A+B +C (Nr. i orëve javore gjithsej)**	**39/41**	**41/43**	**34/36**

[11]Brenda hapësirës së kurrikulës në bazë shkolle zhvillohet dhe shërbimi komunitar. Shërbimi komunitar është i detyruar të kryhet në 18 orë, në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të. Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara. Ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore.

4.***Udhëzime për planin mësimor, dega "Muzikë", arsimi bazë dhe i mesëm i lartë (9+3).***

Kohëzgjatja e arsimit bazë dhe të mesëm të lartë artistik është:
- 9 vite shkollimi, nga klasa 1-9, për nxënësit që fillojnë për herë të parë në klasë të parë.
- 4 vite shkollimi, nga klasa 6-9, për nxënësit që fillojnë për herë të parë në klasë të gjashtë.
- 3 vite arsimi i mesëm i lartë, për nxënësit që vijnë nga arsimi i detyruar 9-vjeçar.

Kohëzgjatja e vitit shkollor për arsimin bazë është:
- Në klasat e 1-9, viti shkollor ka gjithsej 35 javë mësimore.

Kohëzgjatja e vitit shkollor për arsimin e mesëm të lartë është:
- Në klasën X, viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim.
- Në klasën XI, viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim.
- Në klasën XII, viti shkollor ka gjithsej 34 javë mësim.
- 2 javë mësimore në klasën 10-11-të janë praktika mësimore.

Kurrikula i arsimit me drejtim të orientuar artistik në degën "Muzikë", zhvillohet nga 3 grupe kurrikulare.
- Lëndët e kulturës së përgjithshme të përbashkëta për gjithë specialitetet e arsimit bazë dhe të mesëm të lartë, miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Sporteve.
- Lëndët teorike-praktike-artistike (programet mësimore janë pjesë e kësaj kurrikule)
- Lëndët e specialitetit (programet mësimore janë pjesë e këtij kurrikuli)

IV. UDHËZIME PËR PROCESIN MËSIMOR, DEGA "MUZIKË", ARSIMI BAZË DHE I MESËM I LARTË (9+3)

Mësuesit e lëndëve të kulturës së përgjithshme, asaj teorike, artistike dhe të specialitetit duhet të përzgjedhin dhe të përdorin forma dhe metoda pune të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv në njohuritë e kulturës së përgjithshme dhe artistike të nxënësve duke i drejtuar ata në aftësimin dhe në krijimin e kompetencave artistike.
E rëndësishme është që planifikimi i mësimdhënies të bazohet në një proces fillestar, i cili duhet të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si:
- niveli i hyrjes së nxënësve;
- përmbajtja mësimore e lëndëve teorike artistike, praktike dhe speciale, të parashikuara sipas nivelit moshor dhe shkallës së vështirësisë;
- rezultatet e pritshme në kulturën artistike dhe atë të përgjithshme;
- mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore artistike etj.

V. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN DHE PROVIMET

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teoriko- artistike, teoriko- praktike dhe të specialitetit bëhet nga mësuesit me metoda dhe me instrumente vlerësimi të përzgjedhura nga vetë ata.
Vlerësimi i nxënësve bëhet me notat 4-10, si gjatë vitit shkollor ashtu edhe në provimet përfundimtare.
- Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).

- Vlerësimi do të bëhet me notë që vendoset për materialet që luan nxënësi.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe i përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi i nxënësit në saxhot do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria e shkollës (me jo më pak se 3 veta).
- I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.
- Vlerësimet e nxënësve do të diskutohen nga anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe i përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

Në përfundim të arsimit bazë, nxënësi i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
- Provimi i specialitetit
- Provimet e Lirimit

Vlerësimi në shkollën e mesme me drejtim të orientuar artistik, dega "Muzikë" bazohet në disa shtylla kryesore, të cilat padyshim detajohen nga komisionet përkatëse të ngritura nga shkolla. Çdo komision për vlerësimin e arritjeve të nxënësve detajon më tej mënyrën e vlerësimit, në varësi të specialitetit dhe aftësive të nxënësve sipas vitit shkollor.
Në përfundim të kësaj shkolle u nënshtrohet provimeve të mëposhtme:
- Provimi i formimit artistik (teorik dhe praktik)
- Provimi i specialitetit
- Provimet e Maturës Shtetërore

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave mbi kulturën e përgjithshme dhe atë profesionale artistike.

Të dhëna për "Dëftesën e pjekurisë" si dhe "Diplomë" / dhe **"Certifikatë të Maturës Shtetërore" që fitohet në përfundim të arsimit profesional artistik në degën "Muzikë"**

Në përfundimin të arsimit bazë nxënësit pajisen me **"Dëftesën e pjekurisë" dhe në** përfundimin të arsimit të mesëm artistik, shkolla e pajis e pajis nxënësin me "**Diplomë" /** dhe **"Certifikatë të Maturës Shtetërore"** e cila njihet në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas modelit të miratuar nga MAS-i.

VI. PROGRAMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE TEORIKO-ARTISTIKE

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO, VIOLINË, VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **I**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së I, nxënësi:

- njeh notat në vija dhe në fusha;
- njeh vlerat e notave dhe të pushimeve;
- njeh çelësin e solit dhe të fa-së;
- zhvillon njohuritë për notat poshtë dhe lart pentagramit;
- zbaton gjatë leximit pikën e vlerës dhe marrëdhënien me vlerën e notës përkatëse.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Njohja me muzikën.	Ç'është muzika?	1 orë	
Notat në vija e në fusha, vlerat e notave.	Nota e plotë.	2 orë	1 orë
	Nota gjysmë.	2 orë	1 orë
	Nota çerekshe.	2 orë	1 orë
	Koha 4/4.	2 orë	1 orë
Koha 4/4. **3/4, 2/4.**	Pentagrami. Notat në vija.	2 orë	2 orë
	Notat në fusha.	2 orë	2 orë
	Notat poshtë pentagramit.	1 orë	1 orë
	Toni e gjysmë/toni.	2 orë	2 orë
	Pushimi i plotë.	1 orë	1 orë
	Koha 2/4.	2 orë	1 orë
	Pushimi 2/4 (gjysmë).	1 orë	1 orë
	Pushimi 1/4 (çerekësh).	1 orë	1 orë
	Notat sipër pentagramit.	1 orë	1 orë
	Lidhjet muzikore.	1 orë	1 orë
	Shenjat e përsëritjes.	1 orë	1 orë
	Koha3/4. Nota gjysmë me pikë.	2 orë	2 orë
Çelësi i Basit ose i fa-	Çelësi i basit (i fa-së).	2 orë	2 orë

së. **Shkalla Do +.**	Notat në vija e në fusha.		
	Nota 1/8 tetëshe. Pushimi 1/8 tetësh.	2 orë	2 orë
	Pika e vlerës pas notës 1/8.	1 orë	1 orë
	Shkalla do+ maxhore.	2 orë	2 orë
	Çelësi i fa-së, notat poshtë pentagramit.	2 orë	2 orë
	Çelësi i fa-së, notat sipër pentagramit.	2 orë	2 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **II**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 2-të, nxënësi:

- njeh figura të ndryshme ritmike me kombinime 1/4, 1/8, 1/16 të medhe pa pikë;
- njeh shkallët me diezis e bemol: sol+, fa+;
- njeh përkatëset e tyre dhe mënyrën si gjenden dhe ndërtohen;
- lexon dhe dëgjon nota të shkëputura e të lidhura;
- realizon diktime të thjeshta ritmike dhe melodike.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Lartësia e tingujve. Shkrimi muzikor. (rikujtesë).	Shkrimi i notave, lartësia e tyre.	1 orë	1 orë
	Vlerat ritmike 4/4, 3/4, 2/4. Pika e vlerës.	1 orë	1 orë
	Ngjyrat muzikore, shenja e përsëritjes.	1 orë	1 orë
	Vlerat e thjeshta dhe vlerat e përbëra. Figurat ritmike me pikë.	1 orë	1 orë
Figurat e ndryshme ritmike, me pikë ose jo.	Arpezhi i shkallës do+ tetrakordi.	1 orë	1 orë
	Shenja e shartimit #, b, bekuadër.	1 orë	2 orë
	Nota 1/16, pushimi 1/16.	1 orë	4 orë
	Figura ritmike 1/8 dhe dy 1/16.	1 orë	4 orë
	Nota e njëjtë me dy emra.	1 orë	2 orë
	Figura ritmike me pikë e kombinime 1/16, 1/8,1/4 etj.	1 orë	4 orë
	Shenja D.C al Fine dhe Korona.	1 orë	2 orë
Shkallët maxhore.	Shkalla sol + diezi i parë në armaturë.	1 orë	4 orë
	Figura të ndryshme ritmike.	2 orë	4 orë
	Shkalla fa+ bemoli i parë.	1 orë	4 orë
Shkallët minore.	Shkallët minore (përkatëset). Shkalla la- (do+).	1 orë	4 orë
	Shkalla mi- (sol +).	1 orë	4 orë
	Shkalla re – (fa+).	1 orë	4orë
	Minueti.	1 orë	2 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **III**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 3-të, nxënësi:

- njeh llojet e ndërtimit të shkallëve minore;
- njeh shkallët + e - me diezis e bemol: re+, si-, sib+, sol –;
- lexon dhe dëgjon të ndryshme, si dhe realizon diktime melodike dhe ritmike;
- njeh figura të ndryshme ritmike dhe me kombinime kohësh e vlerash.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Shkallët + dhe -.	Shkalla Do+ Sol+ Fa+.	1 orë	1 orë
	Shkalla La – Mi – Re - .	1 orë	1 orë
Shkallët minore dhe 3 mënyrat e ndërtimit.	Ngjyrat muzikore, toni e ½ toni.	1 orë	1 orë
	Vlerat dhe figurat ritmike.	1 orë	1 orë
	Shpejtësitë e kohëve. Thekset.	1 orë	3 orë
	Shkalla La- , 3 format e minorit.	2 orë	4 orë
	Shkalla Mi- , 3 format.	2 orë	4 orë
	Shkalla Re- 3 format.	2 orë	4 orë
	Trioleti. Llojet e tij.	2 orë	4 orë
Shkallët + dhe -.	Shkalla Re + me 2 diezis.	1 orë	4 orë
	Shkalla si- me 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla Sib + me 2 bemola.	1 orë	4 orë
	Shkalla sol- me 3 forma.	2 orë	4 orë
Kohët muzikore.	Kohët muzikore 2/8, 3/8, 4/8.	1 orë	4 orë
	Kohët muzikore 2/2, 3/2, 4/2.	1 orë	4 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **IV**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 3-të, nxënësi:

- lexon dhe këndon saktë figura të ndryshme ritmike dhe kombinime kohësh dhe vlerash;
- njeh shkallët + e - me diezis e bemol: La+ e fa#- me 3 forma, Mib+ e do- me 3 forma;
- lexon dhe dëgjon nota të ndryshme, si dhe realizon ditkime ritmike dhe melodike;
- lexon rrjedhshëm në ritmet e përbëra 6/8, 9/8, 12/8.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Figurat ritmike. Trioleti. Shkallët. Kohët e përbëra 6/8, 9/8, 12/8.	Figura me vlera të ndryshme ritmike. Trioleti.	2 orë	2 orë
	Shkallët + dhe – të mësuara.	2 orë	2 orë
	Koha e përbërë 6/8.	1orë	4 orë
	Shenjat e shartimit bb, x.	1 orë	1 orë
	Koha e përbërë 9/8.	1orë	4 orë
	Notat në harmonikë.	1 orë	2 orë
	Koha e përbërë 12/8.	1orë	4 orë
	1/2 tonikromatik e diatonik.	1orë	4 orë
Shkallët + e -.	Shkalla La+ me 3 diezis.	2 orë	4 orë
	Shkalla fa#- me 3 forma.	2 orë	4 orë
	Çelësi i Do-së (çelës i përbashkët).	2 orë	4 orë
	Shkalla Mib + me 3 bemola.	2 orë	4 orë
	Shkalla do- me 3 forma.	2 orë	4 orë
Format muzikore.	Konvencionet në solfezh, piano, violinë, pedali, harkatat, përsëritja.	1 orë	4 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **V**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 5-të, nxënësi:

- nxërton dhe këndon intervalet nga prima deri në kuistë;
- njeh shkallët + dhe - me diez dhe bemol, mi+ e do#-me 3 forma, lab + e fa-me 3 forma;
- lexon dhe dëgjon nota të ndryshme, si dhe realizon ditkime ritmike dhe melodike;
- njeh dhe lexon rrjedhshëm sinkopën.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Figurat ritmike. Shkallët + dhe -.	Figura me vlera të ndryshme ritmike.	1 orë	1 orë
	Shkallët + me 3 # e b të mësuara.	1 orë	1 orë
	Shkallët përkatëse – me 3 forma.	1 orë	1 orë
	Sinkopa, figura ritmike.	2 orë	4 orë
Intervalet.	Intervalet e thjeshta. Prima $I_{1.}$	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta. Sekonda $I_{2.}$	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta. Terca $I_{3.}$	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta. Kuarta $I_{4.}$	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta. Kuinta $I_{5.}$	1 orë	4 orë
	Vlera e notës dhe e pushimit 1/32.	2 orë	4 orë
Shkallët + dhe -.	Shkalla mi + me 4 diezis.	1 orë	4 orë
	Shkalla do#- me 3 forma.	1 orë	4 orë
	Shkalla lab+ me 4 bemola.	1 orë	4 orë
	Shkalla fa- me 3 forma.	1 orë	4 orë
Format muzikore.	Periudha, forma më e thjeshtë muzikore.	1 orë	4 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 6-të, nxënësi:

- ndërton dhe këndon intervalet nga seksta deri në oktavë;
- njeh shkallët me dieza dhe bemola: si + e sol#- me 3 forma, reb+ e sib-me 3 forma;
- lexon, dëgjon dhe realizon diktime ritmike dhe melodike;
- njeh akordin, kuintakordin dhe funksionet kryesore të shkallës: T,S,D.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Intervalet. Sinkopa.	Intervalet nga I_1 deritek I_5.	1 orë	1 orë
	Ritmika. Figurat e sinkopës.	1 orë	1 orë
Intervalet. I_6deritek I_8.	Intervalet e thjeshta. Seksta I_6.	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta SeptimaI$_7$.	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta. Oktava I_8.	1 orë	4 orë
	Akordi, ndërtimi. Llojet e tij.	2 orë	4 orë
	Kuintakordi. Llojet e tij.	1 orë	4 orë
	Emrat e gradëve të shkallës + e -.	1 orë	2 orë
	Funksionet kryesore T S D.	2 orë	4 orë
	Pika e dyfishtë.	1 orë	2 orë
Shkallët + e -.	Shkalla Ssi + me 5diezis.	1 orë	4 orë
	Shkalla sol#- me 3 forma.	1 orë	4 orë
	Shkalla reb+ me 5 bemola.	1 orë	4 orë
	Shkalla sib- me 3 forma.	1 orë	4 orë
Ritmika.	Grupet e çrregullta.	1 orë	2 orë
Format.	Forma 2- pjesëshe e thjeshtë.	1 orë	2 orë
		Gjithsej	**68 orë**

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 7-të, nxënësi:

- ndërton, këndon dhe dëgjon A_5 A_6 A^6_4;
- njeh shkallët + dhe - me diezis e bemol: fa#+ e re#-me 3 forma, solb+ e mib-me 3 forma, dob+ dhe lab- me 3 forma;
- njeh rrethin e kuintave dhe modet diatonikel
- shkruan diktim me 1 dhe 2 zëra si edhe lexon ushtrime "a prima vista".

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Ritmika. Akordi A_5. Përmbysjet e A_5: A_6 A^6_4.	Figura ritmike të mësuara.	1 orë	1 orë
	Akordi A_5 dhe llojet. Përmbysja e akordeve.	1 orë	4 orë
	Sekstakordi A_6 .Llojet.	1 orë	4 orë
	Kuartsekstakordi A^6_4.	1 orë	4 orë
Kohët.	Kohët e përziera 5/8, 5/4, 7/8, 7/4 , 9/8, 9/4, 12/8, 12/4.	1 orë	4 orë
Shkallët + e -.	Shkalla fa# + .	1 orë	4 orë
	Shkalla re#- me 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla solb+.	1 orë	4 orë
	Shkalla mib- me 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla dob+.	1 orë	4 orë
	Shkalla lab- me 3 forma.	2 orë	4 orë
	Rrethi i kuintave.	1 orë	4 orë
	Modet diatonike.	1 orë	4 orë
Format.	Forma 3- pjesëshe e thjeshtë.	1 orë	2 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 8-të, nxënësi:

- ndërton dhe këndon D7 me përmbysje;
- ndërton 3 format e shkallëve maxhore;
- lexon, dëgjon dhe realizon diktime ritmike dhe melodike;
- njeh saktë zgjidhjen e tingujve dhe të intervaleve.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Figurat ritmike. Çelësat.	Figura me vlera të ndryshme ritmike.	1 orë	1 orë
	Sistemi i çelësave.	1 orë	1 orë
	Përcaktimi i oktavave.	1 orë	1 orë
	Emërtimi i notave sipas alfabetit.	1 orë	2 orë
Format muzikore.	Motivi, fraza, tema muzikore.	1 orë	4 orë
	Miniaturat si 2-3 pjesëshe..	1 orë	4 orë
	Modi maxhor 3 format.	2 orë	4 orë
Zgjidhjet e tingujve.	Shenjat e shkurtimit.	1 orë	4 orë
	Intervalet e thjeshta e të përbëra.	2 orë	4 orë
	Zgjidhja e tingujve sipas gradëve të qëndrueshme.	1 orë	4 orë
Dominant septakordi. D_7 dhe Përmbysjet.	Përmbysja e zgjidhja e intervaleve.	1 orë	4 orë
	Tingujt, intervalet e tonalitetet enharmonike.	1 orë	4 orë
	Shenjat e zbukurimit.	1 orë	4 orë
	Dominant septakordi, zgjidhja.	2 orë	4 orë
	Përmbysjet e D_7 dhe zgjidhjet.	2 orë	4 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO,VIOLINË,VIOLONÇEL**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasëssë 9-të, nxënësi:

- ndërton A_5, A_6 , A^6_4 , D_7, D^6_5, D^4_3 , D_2;
- zgjidh saktë D_7 dhe përmbysjet e tij;
- lexon, dëgjon dhe realizon diktime ritmike dhe melodike;
- lexon dhe këndon ushtrimet në ritme të përziera, si dhe njeh grupet e çrregullta.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë. Figurat ritmike.	Figura me vlera të ndryshme ritmike.	1 orë	1 orë
	Ndërtimi i A5 dhe D7 me përmbysje.	1 orë	2 orë
Ritmet e përziera.	Ritmet e përziera 5/4,5/8,7/4 7/8.	2 orë	4 orë
	Koha 9/4 e 9/8.	1 orë	2 orë
Çelësat në ushtrime.	Shkalla kromatike.	1 orë	2 orë
	Koha e përzier 12/4 e 12/8 .	1 orë	2 orë
	Çelësat e altit e tenorit.	2 orë	4 orë
	Çelësat e sopranit, mexosopranit.	2 orë	4 orë
	Çelësi i baritonit.	1 orë	4 orë
Ndërtimi i akordeve.	Akordet mbi 7 gradët e shkallës.	1 orë	4 orë
	Akordet maxhore T S D.	1 orë	4 orë
	Akordet minore, septakordi.	1 orë	4 orë
	Grupet e çrregullta.	2 orë	4 orë
	Melizmat.	2 orë	4 orë
Format.	Minueti, fuga, etydi, balada etj.	2 orë	2 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT, FIZARMONIKË, KITARË , KLARINETË (FILLESTAR)**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 6-të, nxënësi:

- lexon notat muzikore dhe vlerat e tyre;
- demonstron kuptimin e kohëve të thjeshta.;
- ndërton shkallët do+, sol+, fa+, la-, mi-, re-;
- dëgjon dhe realizon diktime ritmike dhe melodike me tingujt e shkallës do+.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Njohja me pentagramin dhe me notat muzikore. Kohët.	Pentagrami. Çelësi i solit, notat në vija e fusha.	1 orë	3 orë
	Notat sipër e poshtë pentagramit.	1 orë	2 orë
	Koha 4/4. Nota dhe pushimi i plotë.	1 orë	2 orë
	Koha 2/4. Nota dhe pushimi gjysmë .	1 orë	2 orë
	Nota ¼, pushimi ¼. Masa e paplotësuar.	1 orë	2orë
Vlerat dhe figurat ritmike dhe shenjat muzikore.	Nota dhe pushimi 1/8.	1 orë	2 orë
	Pika e vlerës. Koha ¾.	1 orë	2 orë
	Lidhja e vlerës dhe e shprehjes.	1 orë	2 orë
	Pika e vlerës te nota ¼. Figura ritmike.	1 orë	3 orë
	Shkalla do+. Toni, 1/2 toni.	1 orë	3 orë
	Çelësi i basit. Notat me këtë çelës.	2 orë	4 orë
	Shenjat e përsëritjes.	1 orë	2 orë
	Shenjat e shartimit: # dhe b në armaturë.	1 orë	2 orë
	Nota 1/16 dhe pushimi 1/16.	1 orë	2 orë
	Figurat ritmike me 1/8, 1/16. Pika e vlerës te nota 1/8.	1 orë	4 orë
Shkallët + e -.	Shkalla la minore dhe 3 format.	2 orë	3 orë
	Shkalla Sol+ e mi- dhe 3 format.	2 orë	3 orë
	Shkalla Fa+ e mi- dhe 3 format.	2 orë	3 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT, FIZARMONIKË, KITARË , KLARINETË (FILLESTAR)**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 7 - të, nxënësi:

- kupton lëvizjet e tingujve tek intervalet nga prima deri te kuarta;
- ndërton shkallët Re+, Sib+, La+, Mib+ , si dhe përkatëset e tyre minore në 3 forma;
- njeh çelësin e Do-së si çelës i përbashkët;
- lexon dhe këndon në ritmet e thjeshta 2/2 ,2/4, 2/8, 3/2, 3/4, 3/8;
- lexon apo këndon simbolin e trioletit;
- dëgjon dhe realizon diktime ritmike e melodike.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Figura ritmike dhe shkallët muzikore.	Figura të njohura ritmike.	1 orë	2orë
	Shkallët + e – me 1 shenjë.	1 orë	2 orë
	Lëvizja e tingujve. Intervalet.	1 orë	2 orë
	Thekset në muzikë.	1 orë	2 orë
	Intervali i Primës $I_{1.}$	1 orë	2orë
Intervalet prima deri tek kuarta. Shkallët. Ritmika.	Intervali i Sekondës $I_{2.}$	1 orë	2 orë
	Intervali i Tercës $I_{3.}$	1 orë	2orë
	Intervali i Kuartës I_4	1 orë	2 orë
	Shkalla Re +, si – në 3 format.	2 orë	4 orë
	Shkalla Sib +, sol-në 3 format.	2 orë	4 orë
	Shkalla La +, fa#- në 3 format.	2 orë	4 orë
	Shkalla Mib+, do- në 3 format.	2 orë	4 orë
	Çelësi i përbashkët i do-së.	2 orë	2 orë
	Ritmet 2/2, 2/4, 2/8, 3/2, 3/4, 3/8.	4 orë	4 orë
	Notat kryesore kaluese dhe ndihmëse.	2 orë	2 orë
	Trioleti dhe llojet e tij.	2 orë	2 orë

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT, FIZARMONIKË, KITARË , KLARINETË (FILLESTAR)**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 8 - të, nxënësi:

- njeh lëvizjet e tingujve, intervalet nga kuinta deri te oktava;
- njeh shkallët Mi+, Lab+,Si+, Reb+ si dhe përkatëset e tyre minore në 3 forma;
- lexon dhe këndon ritmet e përbëra 6/4, 6/8, 6/16, 9/4, 9/8, 9/16;
- njeh sinkopën;
- njeh vlerën 1/32 notë dhe pushim;
- dëgjon dhe realizon diktime ritmike e melodike.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë.	Figura të njohura ritmike.	1 orë	2orë
	Shkallët + e – me 2 dhe 3 shenja.	1 orë	2 orë
	Intervalet Prima-Kuarta I_1-I_4.	1 orë	2 orë
Ritmet e Përbëra.	Ritmet e përbëra 6/4, 6/8, 6/16.	1 orë	3 orë
	Ritmet e përbëra 9/4, 9/8, 9/16.	1 orë	3orë
	Ritmet e përbëra 4/2,4/4, 4/8.	1 orë	3 orë
	Ritmet e përbëra 12/4,12/8,12/16.	1 orë	3orë
	Sinkopa përmes figurave ritmike.	1 orë	2 orë
	Vlera 1/32 nota dhe pushimi.	1 orë	4 orë
Shkallët muzikore.	Shkalla Mi +, sol#-në 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla Lab +, fa- në 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla Si+, sol#- në 3 forma.	2 orë	4 orë
	Shkalla Reb+, sib- në 3 forma.	2 orë	2 orë
Intervalet.	Intervali i Kuintës I_5.	1 orë	2 orë
	Intervali i sekstës I_6.	1 orë	2 orë
	Intervali i septimës I_7.	1 orë	2 orë
	Intervali i oktavës I_8.	1 orë	2 orë
	Përcaktimi i oktavave.	1 orë	

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT, FIZARMONIKË, KITARË , KLARINETË (FILLESTAR)**
Lënda: **SOLFEZH**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 9 - të, nxënësi:

- njeh rrethin e kuintave;
- ndërton shkallët fa#+, solb, do#+, dob+ , si dhe përkatëset e tyre minore në 3 forma;
- ndërton intervalet e përbërë konsonante e dizonante, diatonike e kromatike, si dhe zgjidhjet e tyre;
- njeh A_5, A_6, A^6_4;
- njeh enharmonizimin në nota, intervale e tonalitete, si dhe në forma të thjeshta muzikore;
- dëgjon dhe realizon diktime ritmike e melodike.

2. Përmbajtja tematike e lëndës "Solfezh"

Tematikat	Temat mësimore	Orët e teorisë	Praktika
Rikujtesë.	Figura të njohura ritmike dhe sinkopa.	1 orë	2 orë
	Shkallët + e – deri në 5 shenja #,b.	1 orë	2 orë
	Intervalet Prima-Oktava I_1-I_8.	1 orë	2 orë
Ritmet e përziera.	Ritmet e përziera 5/4, 5/8, 7/4, 7/8 .	1 orë	3 orë
	Ritmet e përziera 9/4,9/8,12/4,12/8.	1 orë	3 orë
Shkallët.	Shkalla Fa# +, re#-në 3 forma.	1 orë	3 orë
	Shkalla Solb +, mib- në 3 forma.	1 orë	3 orë
	Shkalla Do#+, la#- në 3 forma.	1 orë	3 orë
	Shkalla Dob+, lab- në 3 forma.	1 orë	3 orë
Intervalet.	Rrethi i kuintave.	1 orë	
	Enharmonizimi: notat, intervalet.	2 orë	2 orë
	Intervalet e përbëra.	1 orë	2 orë
	Intervalet konsonante, dizonantë kromatikë.	2 orë	2 orë
	Përmbysja dhe zgjidhja intervaleve.	2 orë	2 orë
Kuintakordi.	Akordi llojet: A_5, A_6, A^6_4.	3 orë	4 orë
	Emrat e gradëve të shkallës T S D.	1 orë	2 orë
	Pika e dyfishtë.	1 orë	2 orë
Format.	Periudha si forma më e thjeshtë.	1 orë	2 orë
	Minueti, preludi, etydi etj.	1 orë	2 orë

VII. PROGRAMET E PËRGJITHSHME TË LËNDËVE PRAKTIKO-ARTISTIKE

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO**
Lënda: **PIANO**
Klasa: **I**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Piano"

- njeh instrumentin e pianos dhe shprehitë fillestare;
- realizon tingullin non legato (portato), pastaj graduaisht legato dhe sakato;
- zhvillon elementEt e kombinimit të tingujve në pesë gishtat dhe aplikimin e tyre në disa ushtrime dhe pjesë;
- merr njohuri dhe koncepte mbi tempin, si dhe organizimin e frazës brenda tempit të pjesës në lojën e 3 ose 4 pjesëve;
- kupton shenjat dinamike (p) piano, (f) forte, mf (mezzoforte) dhe shenjat, të cilat tregojnë rritjen apo uljen e intensitetit të tingullit crescendo dhe diminuendo ose decrescendo;
- luanj 30 ose 40 etyde dhe pjesë të vogla, gjatë klasës së parë;
- përvetëson *elementet teknike* dhe *artistike* për këtë grupmoshë.

2. Përmbajtja e programit të lëndës "Piano"

Programi i detyruar	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme
Pjesë shqiptare.	**Një pjesë shqiptare** - T.Harapi – Trëndafili i vogël, - G.Avrazi – Atdheu - L.Dizdari – Pjesë të vogla, etyde - A.Shtuni – Variacione mbi temë popullore.	**Nxënësi:** - luan partiturën saktë; - luan pastër ritmet; - realizon veprën në tingëllim dhe në karakter.
Pjesë e huaj.	**Një pjesë e huaj** - A.Nikoleva- Luajtja në piano - Gnesina – ABC e pianos - F.Beyer – Shkolla per piano - J.Bastien – Niveli fillestar i pianos - Tomson – Libri i parë - C.Czerny – Etyd op.599 - B.Bartok – Mikrokozmos - Gadike – Etyde të vogla - A.Diabelli – Pjesë Op.149 me 4 duar.	- merr njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme dhe i zbaton ato në veprat që luan; - punon për realizimin e tingëllimit të këtyre veprave; - luan saktë dhe me emocion.

	- S.Cesi përshtatje nga Diabelli për 4 duar. - S.Cesi – Përshtatje nga Czerny e Diabelli - Schytte – Complete Jazz Piano for young Pianist.	
Shënim: *Pjesët me 4 duar, përbëjnë një rëndësi shumë të veçantë në formimin artistik të nxënësit.*		

Klasa I		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: Nuk luan kontrolle teknike në këtë nivel (klasa e parë).	***Programi në saxho:*** Nuk luan saxhon e parë.	***Programi në saxho:*** - Një etyd - Një pjesë shqiptare - Dy pjesë të huaja, duke përfshirë edhe ato me 4 duar.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO**
Lënda: **PIANO**
Klasa: **II**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Piano":

- përvetëson pasazhet mbi figurat dhe grupe të shumëllojshme;
- zhvillon fuqinë dhe stabilitetin e duarve dhe të gishtave;
- merr njohuritë fillestare për përdorimin e pedalit;
- mëson shkallët maxhore, si dhe arpezhin e tonikës me tre tinguj;
- luan ushtrimet, etydet e pjesët në tempet reale, duke zhvilluar aftësitë krijuese të tij, brenda kërkesave teknike artistike;
- luan me nivel dhe me kërkesa artistike profesionale programin e përcaktuar.

2. Përmbajtja e programit të lëndës "Piano"

Programi i detyruar	Temat mësimore	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**4 shkallë të plota**: - maxhore; - minore.	***Nxënësi:*** - luan shkallët pastër; - ka unifikim të duarve gjatë luajtjes; - luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha mënyrat; - luan lirshëm, me qëndrim të drejtë në piano; - krijon marrëdhënie të drejtë të përgatitjes së gishtit dhe natyrshmërisë e plastikës së pulsit; - luan shkallët në 4 mënyra.
Etyde	**Etyde** - Gniesine, etyde të vogla, pjesa e parë. - Beyer, etyde - Gedike, etyde. - Dizdari,etyde. - Schytte, etyde. - Berens, etyde op.70.	- luan etydet pastër; - realizon drejt teknikisht importimin; - realizon etydet në tempet reale; - realizon frazën dhe nuancën muzikalisht; - respekton partiturën duke përdorur me kujdes pedalin;
Pjesë polifonike	**Tre pjesë polifonike** - J.S.Bach, kompozime të vogla. - Kunc, 200 kanone të shkurtra. - Lahovickaja, përmbledhje veprash polifonike.	- luan pastër veprën; - luan saktë lojën në polifoni; - realizon lojën në polifoni duke punuar veçmas me secilin zë; - merr njohuri teorike mbi periudhën dhe

	- Hendel, Korel, Kriger etj.	stilin; - pasuron njohuritë e tij, duke dëgjuar e mësuar nga ekzekutime të pianistëve botërorë.
Sonatë	**Një sonatë komplet ose 1 kohë sonatë** - Bethoven G Dur (sonatina). - Moxart Variacione G Dur. - Klementi Sonatina C Dur. - Haslinget Sonatina Pleyel Sonatina. - Raineke Sonatina.	- lexon saktë dhe pastër partiturën; - punon në vazhdimësi për tingull me cilësi; - punon me kërkesë për organizimin e veprës në *stil e karakter*, duke pasur të qartë mendimin, për periudhat kur janë shkruar veprat; - realizon për *frazim* dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor; - merr njohje të plotë mbi formën e sonatës; - koncepton sonatën si një vepër unike, pavarësisht nga karakteret e ndryshme të kohëve të saj; - realizon me kujdes përdorimin e pedalit (shpjegohen nga mësuesi ushtrime ndihmëse për këtë qëllim).
Pjesë shqiptare	**Një pjesë shqiptare** - Album pianistik per fillestarë. - Zadeja- Valle, Tregimi i gjyshes. - T.Daija-Vals. - F.Ibrahimi- Pjesë lirike, Tokatina. Prelud. - F.Ibrahimi- Lepurushi. - T.Harapi- Prelud.	- luan partiturën saktë; - luan pastër ritmet e thyera (në qoftë se ka); - punon për realizimin e veprës në tingëllim dhe në karakter.
Pjesë e huaj	**Një pjesë e huaj** - Çcajkovski- Pjesë për femijë. - B.Bartok- Mikrokozmos. - Tomson -Libri i dytë. - Gedike op.36 . - Schuman op.68. - C. Frank - Ankesa e një kukulle. - Kabalevskij 0p.30. - Scot- Kuti lojrash dhe pjesë te tjera. - Moxart- Sonatina të vogla me 4 duar. - Pjesë me 4 duar: Shubert, Moxart, Hyden,Shuman etj.	- merr njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme etj.; - realizon tingëllimin e këtyre veprave; - luan saktë dhe me emocion; - interpreton muzikalisht programin.

Klasa II		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Kryhen 4 kontrolle teknike. - Në çdo kontroll luhet 1 shkallë dhe dy etyde.	**Programi në saxho:** - Një vepër polifonike. - Një sonatinë. - Një pjesë shqiptare ose një pjesë e huaj, duke përfshirë dhe pjesët me 4 duar.	**Programi në saxho:** - Një vepër polifonike. - Një sonatinë. - Një pjesë shqiptare ose një pjesë e huaj, duke përfshirë dhe ato me 4 duar.
Shënim: *Mësuesi zgjedh se në cilën saxho të luhet pjesa shqiptare.*		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO**
Lënda: **PIANO**
Klasa: **III**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës "Piano", nxënësi:

- përvetëson pasazhet mbi figurat dhe grupe të shumëllojshme;
- zhvillon fuqinë dhe stabilitetin e duarve dhe gishtave;
- bën diferencimin midis zërave;
- përvetëson shkallët maxhore dhe minore me dy oktavë;
- merr njohurite fillestare për përdorimin e pedalit;
- realizon shkallët maxhore si dhe arpezhi i tonikës me tre tinguj;
- luan ushtrimet, etydet e pjesët në tempet reale, duke zhvilluar aftësitë krijuese;
- të tij, brenda kërkesave teknike artistike;
- luan me nivel dhe me kërkesa artistike profesionale programin e përcaktuar.

2. Përmbajtja e programit të lëndës "Piano"

Programi i detyruar	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	**4 deri 6 shkallë të plota**: - *Maxhore.* - *Minore.* - *2 oktavë.* - *Arpezhe.* - *Akorde.*	**Nxënësi:** - luan shkallët pastër; - unifikon duart gjatë luajtjes; - luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha mënyrat; - luan lirshëm, me qëndrim të drejtë në piano; - krijon marrëdhënie të drejtë të përgatitjes së gishtit dhe natyrshmërisë e plastikës së pulsit; - luan shkallët në 4 mënyra.
Etyde	**Etyde** - Leomoan etyd op.37. - Bertini 25 etyde op.100. - Duvernoy etyde op.176. - Gedike etyde op.32, op. 47. - Lak etyde op. 172. - Czerny etyde op. 849.	- luan etydet pastër; - realizon drejt teknikisht impostimin; - realizon etydet në tempet reale; - realizon frazën dhe nuancën muzikalisht; - respekton partiturën duke përdorur me kujdes pedalin.
Pjesë polifonike	**Dy pjesë polifonike** - J.S.Bach - Prelude të vogla. - J.S.Bach- Kompozime të vogla.	- luan pastër veprën; - luan saktë lojën në polifoni; - realizon lojën në polifoni duke punuar veçmas me secilin zë;

	- R.Sokoli –Kanone.	- merr njohuri teorike mbi periudhën dhe stilin; - pasuron njohuritë, duke dëgjuar e dueh mësuar nga ekzekutime të pianistëve botërorë.
Sonatë dhe variacione	**Një sonata komplet ose 1 kohë sonatë** - Klementi sonatina (të zgjidhen). - Diabelli sonatina. - Kulau sonatina. - Kulau Variacione G. Dur. - Guestina - Tema me 6 variacione. - Kabalevskij - variacione op. 51.	- lexon saktë dhe pastër partiturën; - realizon në vazhdimësi për tingull me cilësi; - realizon me kërkesë për organizimin e veprës në *stil e karakter*, duke pasur të qartë mendimin, për periudhat kur janë shkruar veprat; - realizon *frazim* me qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor; - krijon njohje të plotë mbi formën e sonatës; - koncepton sonatën si një vepër unike, pavarësisht nga karakteret e ndryshme të kohëve të saj; - realizon me kujdes përdorimin e pedalit (shpjegohen nga mësuesi ushtrime ndihmëse për këtë qëllim).
Pjesë shqiptare	**Një pjesë shqiptare** - Album pianistik për fëmijë- T.Harapi - Kompozitorë shqiptarë për pianistët e rinj. - Zadeja- Kombajnat,Valle, Në aksion. - F. Ibrahimi Valle, Bariu i vogël.	- luan partiturën saktë; - luan pastër ritmet e thyera (në qoftë se ka); - punon për realizimin e veprës në tingëllim dhe në karakter.
Pjesë e huaj	**Një pjesë e huaj** - Schumann- Album për fëmijë. - B.Bartok- Mikrokozmos. - Hydn- Lojëra të vogla. - Moxart - 14 pjesë për fëmijë. - Çcajkovski - Album për të rinj op. 39. **Pjesë me 4 duar**: Diabelli, Moxart, Hyden, Shubert, Stravinsk, Bartok.	- merr njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme etj.; - punon për realizimin e tingëllimit të këtyre veprave; - luan saktë dhe me emocion; - interpreton muzikalisht programin.

Klasa III		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Kryhen 4 kontrolle teknike . - Në çdo kontroll luhet 1 shkallë dhe 2 etyde.	**Programi në saxho:** Dy pjesë polifonike. - Një sonatë (1 kohë ose 3 kohë). - Një pjesë shqiptare ose një pjesë e huaj dhe një pjesë me 4 duar .	**Programi në saxho:** Dy pjesë polifonike. - Një sonatë (1 kohë ose 3 kohë). - Një pjesë shqiptare ose një pjesë e huaj dhe pjesë me 4 duar .
Shënim: *Mësuesi zgjedh se në cilën saxho të luhet pjesa shqiptare.*		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **PIANO**
Lënda: **PIANO**
Klasa: **IV**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano"**

Programi i detyruar	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	**4 shkallë të plota**: - Maxhore. - Minore. - 2 oktavë. - Arpezhe. - Akorde.	**Nxënësi:** - luan shkallët pastër; - unifikon duart gjatë luajtjes; - luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha mënyrat; - luan lirshëm, me qëndrim të drejtë në piano; - krijon marrëdhënie të drejtë të përgatitjes së gishtit dhe natyrshmërisë e plastikës së pulsit; - luan shkallët në 4 mënyra.
Etyde	**Etyde** - Czerny op. 449 Etyde të zgjedhura (32 dhe 50). - Berens.op. 6l. - Heler op. 47. - -Lemoan etyde op. 3.	- luan etydet pastër; - realizon drejt teknikisht impostimin; - realizon etydet në tempet reale; - realizon frazën dhe nuancën muzikalisht; - respekton partiturën duke përdorur me kujdes pedalin.
Pjesë polifonike	**Dy pjesë polifonike** - J.S.Bach- Prelude të vogla. - Hendel Buloë- 12 kompozime të vogla. - Glinka 4 fuga me dy zëra.	- luan pastër veprën; - luan saktë lojën në polifoni; - realizon lojën në polifoni duke punuar veçmas me secilin zë; - merr njohuri teorike mbi periudhën dhe stilin; - pasuron njohuritë, duke dëgjuar e dueh mësuar nga ekzekutime të pianistëve botërorë.
- realizon lëvizjen e ½ tonit ndërmjet gishtit të parë dhe të dytë.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat. - Ushtrime gishtash, Radionov.	**Nxënësi:** - realizon impostimin e duarve dhe të harkut; - realizon terheqje harku të qetë me njëtrajtshmëri dhe pastërti të tingullit në të katër telat; - vendos dorën e majtë sa më drejt për të forcuar artikulacionin;
Shkallë muzikore	- 4-5 shkallë minore ose maxhore me 1 oktavë me nga dy arpezhe dhe me forma të ndryshme harkatash nga Radionov.	- zhvillon edukimin e veshit dhe intonacionit përmes ekzekutimit të shkallëve muzikore; - forcon artikulacionin e dorës së majtë;
Ushtrime dhe etyde	- Radionov: mësimet fillestare të violinës. - F. Hoxha: Metoda 1 ushtrime. - J. Higgins: Essential elements for string.	- kupton lojën teknike hap pas hapi, duke përdorur ushtrime dhe etyde të ndryshme

Kompozime të vogla të shoqëruara me piano	- 5-6 kompozime me piano. - F.Hoxha: Repertor pedagogjik (përmbledhje pjesësh)/ - B.Barber: repertor përmbledhës. - Suzuki FL I. - Radinov.	

Klasa I	
Kontrolle teknike	**Saxho**
Programi ne kontroll teknik: (2 në semestin e dytë): - 1 shkallë + ose – me 1 oktavë, me nga dy arpezhe dhe forma të ndryshme harkatash. - 2 ushtrime me karaktere te ndryshme.	**Programi në saxho:** - 5-6 kompozime (pjesë) të ndryshme.
Shënim: Në raste të vecanta të një ecurie më të madhe të nxënësit, vendos mësuesi përkatës për pasurim të programit dhe aktivizimin më të hershëm para stafit pedagogjik. Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.	

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **II**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 2-të, nxënësi:

- zhvillon më tej reflekset manuale;
- përmirëson impostimin në kohë.;
- ushtrohet në arritjen e pastërtisë intonative dhe tingullore, nëpërmjet disiplinave ndihmëse, si: tërheqje harku me kohëzgjatje të përcaktuar (4- 8 kohë) dhe ushtrime gishtash Radionov;
- krijon pavarësi në lëvizjen e gishtit të dytë dhe në realizimin e gjysmëtonit;
- përvetëson lojën në pozicionin e parë;
- realizon gjatë lojës në instrument, figura të ndryshme ritmike;
- realizon gjysmëtonin ndërmjet gishtit 0-1 dhe 2-3 si dhe 3-4.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Tërheqje harku me vlera të ndryshme në 4 telat. - Ushtrime gishtash Radionov. - Ushtrime me 2 zëra Radionov.	Nxënësi: - ushtrohet çdo ditë me ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe të artikulacionit te gishtave.
Shkallë muzikore	- 6 shkallë minore ose maxhore nga Radionov. - 1-2 shkallë me 2 oktava/ - Danesh fl2 (shkallë për violinë). - Shevcik, shkallët fillestare.	- realizon nëpërmjet lojës në instrument intonacion sa më të pastër.
Ushtrime dhe etyde	- 8 ushtrime (etyde). - Mësimet fillestare të violinës (në vazhdim).	- realizon nëpërmjet materialit teknik, hap pas hapi, teknikat figura të ndryshme; - përvetëson gjysmëtonin ndërmjet gishtit 0-1, 2-3, si dhe 3-4.
Koncertino ose vepra ciklike	- Riding koncertino Si-pozicioni I, koha I-II-III. - Sit koncertino poz.I/ - Seitz koncertino re+ koha I.	- organizon njohuritë e marra gjatë luajtjes në instrument.

Kompozime të vogla të shoqëruara me piano	- 5-6 kompozime me piano - F.Hoxha- Repertor pedagogjik (permbledhje pjesësh) - B.Barber – repertor përmbledhës. - Suzuki FL I-II.	- ushtrohet në realizimin e frazës, ngjyrës, dinamikës.

Klasa II		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik: - 1 shkallë + ose – me forma të ndryshme harkatash. - 2 ushtrime me karaktere të ndryshme.	**Programi në saxho 1:** - Koncertino, koha I ose kohët II – III. - Pjesë sipas nivelit te nxënësve.	**Programi në saxho 2:** - Koncertino, koha I ose kohët II – III. - Pjesë sipas nivelit të nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **III**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 3-të, nxënësi:

- zhvillon më tej impostimin e të dy duarve, bazuar tek ndjeshmëria dhe natyrshmëria;
- zhvillon një disiplinë të studimit në instrument për arritjen tingullore, intonative dhe ritmike;
- realizon vendosjen e dorës në pozicionin e tretë;
- realizon gjatë luajtjes në instrument, termat e dinamikës (shenjat e ngjyrimit, theksat, portato, stakato, detashe, legato);
- ushtrohet me vibraton;
- imposton saktë pozicionin III;
- përvetëson konceptet e dinamikës dhe të teknikave të përdorura.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Radionov, ushtrime gishtash. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Shradik: ushtrime fillestare gishtash.	**Nxënësi:** - realizon çdo ditë ushtrime me qëllim formimin e tingullit dhe artikulacionit të dorës së majtë.
Shkallë muzikore	- 4-5 shkallë me 2 oktava pozicioni I dhe III me arpezhe dhe legatura të ndryshme. - Shevcik: shkallët fillestare FL III Op. 6. - L.Danesh: FL.II (shkallë për violinë).	- fiton reflekse për shkathtësimin e aparatit dhe për intonacion të pastër.
Etyde	- 8 etyde të ndryshme nga: - Volfard: 60 etyde (1-10). - Gorlicki: etyde të zgjedhura. - Radionov: etyde të zgjedhura.	- realizon etyd, duke pasuruar teknika të reja.
Koncertino	- Koha I ose II-III nga koncertinot: - Riding: koncertino, Si- koha II-III. - Kuchler: koncertino LA-(ne stilin e Vivaldit). - Seitz: koncertino Sol+ Koha I-II-III. - Seitz: koncertino Re+ koha I. - Kamarovski: koncertino sol+. - Kuchler: kocertino sol – koha II-III.	- realizon teknikat e fituara gjatë luajtjes në instrument; - gërsheton kërkesën e mësuesit me instiktin muzikal individual.

	- Jan Shinov: koncertino La -.	
Kompozime të vogla të shoqëruara me piano	- Suzuki: FL II-III. - B.Barber: repertor përmbledhës. - Bach: minuete. - Moxart: kompozime fillestare.	- realizon vibraton si një element bazë për të shprehur muzikalitetin.

Klasa III		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik - 1 shkallë + ose – me 2 oktava pozicioni I dhe III, me arpezhe e forma të ndryshme harkatash. - 2 etyde me teknika te ndryshme.	**Programi në saxho 1** - Koncertino, koha I ose kohët II – III. - Pjesë sipas nivelit te nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Koncertino, koha I ose kohët II – III. - 2 pjesë sipas nivelit te nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **IV**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 4-ërt, nxënësi:

- Realizon gjatë luajtjes me instrument kërkesat për frazën dhe dinamikën.
- Realizon elementet fillestare të vibratos si pasuri teknike dhe emocionale në raport me dinamikën.
- Realizon kërkesat për zëra të qëndrueshmë në dopio korde.
- Me dinamikë dhe teknika të përcaktuara në zona te harkut.
- Të vibrojë në mënyrë të lirshme.
- Të arrijë një axhilitet dhe artikulacion të mire dhe të organizojë veprën që luan.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Radionov: ushtrime gishtash. - Shradik: ushtrime gishtash. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Polo: ushtrime me dy zëra. - Shevçik: opus.9, 6,1.	**Nxënësi:** - mban duart në formë me ushtrime gishtash dhe përgatitet për bashkëtingellim të pastër intonativ.
Shkallë muzikore	- 6 shkallë minore ose maxhore me pozicion I-II-III, me arpezhe përkatëse të luajtura me harkata të ndryshme. - Galamian – shkallë. - Danesh-shkallë. - Alard-shkallë.	- ushtrohet në shkallë për të fituar reflekse manuale.
Etyde	- 8 etyde me teknika të ndryshme nga: - Volfard: 60 etyde. - H.Sit: etyde op.32, fl.II-III. - Kajzer: etyde (1-10).	- realizon artistikisht etydet.
Koncerte ose vepra ciklike	- Janshinov: koncertino La-. - Hubber: koncertino Fa+. - Bakllanova: koncertino La-. - Bakllanova: sonatina Sib+. - Koreli folia: për fëmijët. - Kuchler: koncertino La- (stili i	- vibron dhe organizon gjatë luajtjes në instrument, frazën muzikore.

	Vivaldit). - Kuchler: koncertino Re+. - RidingK koncertino Sol+.	
Kompozime te vogla të shoqëruara me piano	- 4 pjesë nga autorë të ndryshëm. - Rubinshtain: Flutura. - P.Gaci: Vogëlushja. - P.Gaci: Nina-nana. - P.Gaci: Valle (repertor për fëmijë). - B.Barber: repertor përmbledhës Vol II. - Suzuki: Vol III.	

Klasa IV		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me pozicionet I-II-III me arpezhet përkatëse me harkata të ndryshme. - 2 etyde me teknika të ndryshme.	**Programi në saxho 1** - Koncert, koha I ose kohet II-III. - 2 pjesë bravura sipas nivelit të nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Koncert, koha I ose kohët II- III. - 2 pjesë bravura sipas nivelit të nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **V**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Materiale teknike ndihmëse	- Shradik: ushtrime gishtash. - Iftinki: ushtrime gishtash. - Shevçik: opus.8,9,6,1. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Polo: ushtrime me dy zëra.	**Nxënësi:** - studion sistematikisht të tilla ushtrime për formimin sa më të mirë te axhilitetit, tingullit, kalimit të pozicioneve.
Shkallë muzikore	- 4 shkallë minore ose maxhore me pozicione të variuara, me arpezhe përkatëse të luajtura me harkata të ndryshme nga: - Alard- shkallë. - Galamian – shkallë. - Danesh-shkallë. - Flesh-shkallë (fillestare).	- realizon shkallët për formimin e të dyja duarve.
Etyde	- 8 etyde me teknika te ndryshme nga: - Volfard: Pjesa e dytë. - Kajzer: 36 etyde. - Sit: etyde op. 32. - Mazas: fl. I.	- realizon saktë zonat e harkut përmes realizimit të teknikave të ndryshme. - realizon vibrato sa më afër natyrales.
Koncerte ose vepra ciklike	- Vivaldi: koncert ne La-. - Vivaldi: koncert ne Sol +. - Vivaldi: koncert ne Re+ (koha e parë). - Riding: koncert Sol +, op. 24. - Riding: koncert La – (stil hungarez). - Seitz: koncert Sol – koha I. - Acolay: koncertino La –. - Kamarovski: koncert La +. - P.Gaci: koncertino. - Teleman: sonatina La+, Re+, Sib+.	- realizon frazën dhe dinamikën, si dhe pasurimin e tonit dhe ngjyrës së tingullit me vibrato.
Kompozime të vogla të	- 2-3 kompozime të shoqeruara me piano nga:	

shoqëruara me piano	- B.Barber: repertor përmbledhës. - Suzuki: Vol III-IV. - Moxart: pjesë të vogla.	

Klasa V		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi ne kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me arpezhe, septakorde, me pozicione I-III-IV-V, të ekzekutuara me harkata të ndryshme. - 2 etyde me teknika të ndryshme.	**Programi në saxho 1** - Sonatinë - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 2 Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Sonatinë - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 2 pjesë bravura sipas nivelit te nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqerohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 6-të, nxënësi:

- saktëson elementet bazë të teknikave kryesore, si: *Detashe*, *Stakato*, *Martelato*, si dhe elementet e kalimit të pozicioneve;
- stabilizon tingullin gjatë luajtjes në instrument;
- realizon teknika të reja në funksion të realizimit të veprave muzikore;
- realizon ndërtimin e frazës nëpërmjet elementeve të dinamikës dhe vibratos;
- realizon ekzekutimin e dopio kordeve si elemente bazë të lojës për repertorin violinistik.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Materiale teknike ndihmëse	- Shradik: ushtrime gishtash. - Iftinki: ushtrime gishtash - Shevçik: opus.8, 9, 6, 2. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Polo: ushtrime me dy zëra. - Dancla:ushtrime gishtash.	**Nxënësi:** - realizon materiale mbi kriteret e vendosura.
Shkallë muzikore	- 4 – 6 shkallë minore ose maxhore me pozicione të variuara me arpezhe dhe forma harkatash të ndryshme, si tercat, sekstat dhe oktavat me forma të thjeshta: - Alard - shkallë. - Galamian – shkallë. - Flesh, sistemi i shkallëve.	- realizon shkallët në pozicione të ndryshme; - njihet më mirë me kapotastin. - imposton drejt dy zërat (terca, seksta dhe oktava).
Etyde	- 8 etyde me teknika të ndryshme nga: - Volfard: etyde pozicionet I-II-III. - Kajzer: 36 etyde. - Mazas: etyd fl. I.	- realizon elementet bazë të teknikave: *stakato*, *legato*, *martelato* gërshëtuar me punën për kalimet e pozicioneve.
Koncerte ose vepra	- Vivaldi: koncert ne La- koha	- zhvillon teknika të reja në funksion

ciklike	II-III. - Vivaldi: koncert ne Sol + koha I-II-III. - Riding: koncert Sol +. - Riding: koncert La –. - Acolay: koncertino La –. - P.Gaci: koncertino. - Koncert: Bach La- koha I. - Moxart: petit koncert. - Viotti: koncert nr 23 koha I - Nardini: koncert Mi+.	të realizimit të veprave; - realizon fraza nëpërmjet elementeve të dinamikes dhe të vibratos.
Sonata 2 kohë kontrastuese	- Koreli: Sonata në La+, Mi-. - Senaye: sonata Sol+. - Teleman: sonatina Sol-, Do-, Mi+, Fa+, Sib+.	
Kompozime të vogla të shoqëruara me piano	- Boçerini: minuet. - Fioco: allegro. - B.Barber: repertor përmbledhës, Vol. II-III. - Suzuki: Vol. III-IV.	

Klasa VI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me 3 oktava, 5 arpezhe (terca, sesta, oktava) në forma të ndryshme harkatash. - 2 etyde me karaktere të ndryshme.	**Programi në saxho 1** - Sonatë (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 2 pjesë bravura, sipas nivelit të nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Sonatë (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 2 pjesë bravura sipas nivelit të nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 7-të, nxënësi:

- krijon personalitetin e tij gjatë luajtjes në instrument;
- realizon në mënyrë të dukshme sensibilitetin gjatë luajtjes;
- realizon nga ana tekniko muzikore programin;
- zhvillon formimin tekniko muzikor në lojën në instrument;
- krijon aftësi të teknikave më të avancuara në funksion të realizimit të veprave.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Shradik: ushtrime gishtash. - Iftinki: ushtrime gishtash. - Shevçik: opus.2, 6, 8, 9. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Polo: ushtrime me dy zëra. - Dancla:ushtrime gishtash.	**Nxënësi:** - realizon materialin ndihmës teknik dhe shkallët në dopio korde për formimin teknik të të dyja duarve.
Shkallë muzikore	- 4 – 5 shkallë minore ose maxhore me 3 oktava me 5 arpezhe (terca, sesta, oktava) të luajtura me harkata të ndryshme progresive . - Alard - shkallë. - Galamian – shkallë. - Flesh, sistemi i shkallëve.	
Etyde	- 8 etyde me karaktere dhe problematika të ndryshme dhe teknika të shumëllojshme nga: - Kajzer: 36 etyde. - Mazas: etyd fl. I. - Dont i vogël: (etyde përgatitore për Rode dhe Krojzer).	- ushtrohet për zonat e harkut të përcaktuara me teknikat përkatëse.

Koncerte ose vepra ciklike	- Vivaldi: koncert në Do- o. - Viott:koncert nr. 23. - Viott: koncert nr. 20. - Viott: koncert nr. 22. - Bach: koncert La-. - Bach:koncert Mi+. - Rode: koncert nr .7, nr. 8. - Beriot: koncert nr. 1, 9,7. - P.Gaci: koncert, koha III. - Moxart: Re+ (koncerto grosso)/ - Shpor: koncert nr. 2, koha I.	- kryen me cilesi të larte arritjen formuese të tingullit si element bazë i shprehjes emocionale.
Sonata 2 kohë kontrastuese	- Hendel: sonata. - Vivaldi: sonata. - Koreli: sonata. - Teleman: sonata. - Tartini: sonata.	- luan sonatën për të krijuar stabilitetin e tingullit të pastër, frazës dhe vibratos sipas karakterit të veprës.
Pjesë bravura të shoqëruara me piano	- Moxart: Fioço. - Paganini: sonatina. - Barber: repertor përmbledhës, Vol, III-IV etj.	- realizon karakterin e pjesëve; - realizon dinamikën; - ka nja tingull të pastër gjatë lojës.

Klasa VII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me 3 oktava, 5 arpezhe (terca, sesta, oktava) në forma të ndryshme harkatash. - 2 etyde me karaktere dhe problematika të ndryshme.	**Programi në saxho 1** - Sonata paraklasike (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - Pjesë bravura sipas nivelit te nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Sonata paraklasike (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Materiale teknike ndihmëse	- Shradik: ushtrime gishtash. - Iftinki: ushtrime gishtash. - Shevçik: opus.2, 6, 8, 9. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Dancla: ushtrime gishtash.	***Nxënësi:*** - realizon nëpërmjet materialeve ndihmëse, shkallë etyde të teknikave të ndryshme; - zhvillon një disiplinë pune dhe është në gjendje të bëjë kontrollin e vetvetes; - kryen leximin e partiturës.
Shkallë muzikore	- 4 – 5 shkallë minore ose maxhore. - 5 - 7 arpezhe të luajtura me harkata. dhe forma ritmike të ndryshme e progresive (terca, sesta, oktava). - Alard - sistemi i shkallëve. - Galamian – sistemi i shkallëve. - Flesh - sistemi i shkallëve.	
Etyde	- 8 etyde me karaktere dhe teknika të ndryshme të përzgjedhura sipas problematikës së **ç**do nxënësi. - Kajzer: 36 etyde. - Mazas: etyd fl. I. - Dont i vogël (etyde përgatitore për Rode dhe Krojzer). - Krojzer: 42 etyde (pjesa I).	
Koncerte ose vepra ciklike	- Bach- koncert La-. - Bach- koncert Mi+. - Rode- koncert nr 6,7 dhe nr. 8. - Beriot koncert nr 1, 9,7. - Moxart - Sol+ koha I. - Moxart - koncert Adelajde. - Hajden – koncert Do+. - Hajden – koncert Sol+. - Kreutzer – koncert nr. 13, 19. - Lipinski – koncert. - Shpor - koncert nr. 2 koha I.	- bën diferencimin e lojës në veprat e autorëve paraklasikë, klasikë e romantikë; - kupton si punohet me tingullin për ta bërë këtë diferencë.

Sonata 2 kohë kontrastuese	- Hendel – sonata. - Vivaldi – sonata. - Koreli – sonata. - Tartini – sonata.	
Bravura (2) pjesë nga autorë të huaj dhe shqiptarë	- Moxart – Rondo. - Paganini – sonatina. - B.Barber- repertor përmbledhës Vol IV-V- VI etj. - Bloch – Niguni. - Kreisler – vepra të ndryshme. - Bela – Bartok- valle rumune. - Sarasate – Andaluza. - Sarasate – Xingareska. - P.Gaci – Balada. - Paparisto – Romanca.	- ekzekeuton duke bërë një lojë të gjallë e dinamike dhe me nuancë; - luan në stilin dhe në karakteristikat që ka vepra.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi në kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me 5 - 7 arpezhe e dopio kordet përkatëse të shkallës (terca, sesta, oktava) në forma të ndryshme harkatash. - 2 etyde me teknika të ndryshme të përzgjedhura sipas problematikes së çdo nxënësi.	**Programi në saxho 1** - Sonata (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 1 pjesë bravure sipas nivelit të nxënësve.	**Programi në saxho 2** - Sonata (2 kohë kontrastuese) - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 1 pjesë bravure, sipas nivelit të nxënësve.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **VIOLINË**
Lënda: **VIOLINË**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 9-të, nxënësi:

- realizon materialet tekniko – muzikore, bazë për përgatitjen dhe lidhjen e ngushtë me programin e shkollës së mesme;
- studion në mënyrë sistematike programin muzikor;
- interpreton lojën muzikore sipas veprave të paracaktuara, duke shpalosur edhe individualitetin artistik.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	- Shradik: ushtrime gishtash. - Iftinki: ushtrime gishtash. - Shevçik: opus.2,6,8,9. - Konjus: ushtrime me 2 zëra. - Dancla: ushtrime gishtash.	***Nxënësi:*** - realizon teknika më të avancuara; - deshifron vetë materialet teknike; - konsultohet me mësuesin; - realizon teknikisht materialet muzikore të programit që luan.
Shkallë muzikore	- 4 – 5 shkallë maxhore ose minore. - 5 - 7 arpezhe të luajtura me forma të ndryshme harkatash dhe forma ritmike të ndryshme e progresive (terca, sesta,oktava). - Alard - sistemi i shkallëve. - Galamian – sistemi i shkallëve. - Flesh - sistemi i shkallëve.	
Etyde	- 8 etyde me karaktere dhe teknika të ndryshme të përzgjedhura. - Mazas: etyd fl. I-II. - Dont i vogël (etyde përgatitore për Rode dhe Krojzer). - Rode – 24 kaprico. - Fjorillo – etyde. - Krojzer – 42 etyde (pjesa I).	

Koncerte ose vepra ciklike	- Rode- koncert nr. 6 dhe nr. 8. - Beriot- koncert nr. 1. - Moxart - Sol+ koha I. - Moxart - koncert Adelajde. - Hajden – koncert Do+, Sol+. - Kreutzer – koncert nr. 13, 19. - Lipinski – koncert. - Viotti – koncert nr. 22 3 kohë me kadencë. - Mendelson – koncert Mi-. - E.Lalo- Sinfonia spanjolle koha I. - M. Bruch – koncert Sol- koha I.	- realizon gjatë lojës në instrument një tingull të formuar dhe së bashku me mjetet shprehëse (dinamikën, vibraton); - luan në instrument duke arritur të bëjë lojën emocionale duke justifikuar materialin që luan.
Sonata, ose tema me variacione	- Hendel – sonata. - Vivaldi – sonata. - Moxart – sonata. - Tartini – sonata.	
Bravura (2) pjesë nga autorë të huaj dhe shqiptarë	- Paganini sonatina – variacione në telin Sol. - B.Barber- repertor përmbledhës, Vol IV-V- VI etj. - Kreisler – vepra të ndryshme. - Bela – Bartok- valle rumune. - Sarasate – Andaluza. - Sarasate – Xingareska. - Pugnani- krajsler (andante allegro). - Navaçek – Motto- perpetto. - P.Gaci – Balada. - Paparisto – Romanca.	

Klasa IX		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
Programi ne kontroll teknik (2) - 1 shkallë + ose – me 5 - 7 arpezhe e dopio kordet përkatëse të shkallës (terca, sesta, oktava) të luajtura ne forma të ndryshme harkatash dhe tempe progresive. - 2 etyde me teknika të ndryshme të perzgjedhura sipas problematikës së **ç**do nxënësi.	**Programi në saxho 1** - Koncert, koha I ose kohët II – III ose sonatë e plotë. - 1 pjesë bravure nga autorë shqiptarë ose të huaj sipas nivelit të nxënësve.	**Programi në saxho 2** - 1 sonatë (2 kohë kontrastuese). - Koncert, koha I ose kohët II – III. - 1 pjesë bravure nga kompozitorë të huaj. - Kompozime nga autorë shqiptarë.
Shënim: Programi luhet përmendësh dhe pjesët e saxhos shoqërohen me piano.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FIZARMONIKË**
Lënda: **FIZARMONIKË**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 6-të, nxënësi:

- zhvillon një impostimin të drejtë të instrumentit në raport me trupin dhe duart;
- përvetëson shprehitë ekzekutive, bazë për zhvilimmin e aparatit lëvizor dhe aftësitë gjykuese në këtë moshë;
- zhvillon tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë, ritmin dhe gradualisht në të gjithë elementet e teknikës së lojës në fizarmonikë;
- respekton në mënyrë korrekte frazat duke përdorur lëvizjet e kacekut (hapjet dhe mbylljet);
- luan programin e përcaktuar duke respektuar të gjitha kërkesat bazë teknike dhe interpretative.
- zhvillon aftësitë teknike dhe interpretuese.
- luan materialet muzikore me ndjenjë dhe emocion.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Ushtrime për dorën e djathtë	- Ushtrime të thjeshta për dorën e djathtë (shtrirja nga do-sol oktava e I). - Ushtrime të thjeshta për njohjen më të zgjeruar të tastierës. - Kalimi i gishtit të madh, zëvendesimi i gishtave. *Metoda: Farfisa, Anzaghi etj.*	***Nxënësi:*** - luan me impostim të saktë të dorës së djathtë; - përdor korrekt kacekun; - respekton korrekt ritmin dhe vlerat e notave.
Ushtrime për dorën e majtë	- Ushtrime elementare për njohjen e basit, bazuar në notat (do-fa-sol). - Ushtrime për akordet maxhore, minore, kapërcimet e tyre etj. - Ndërtimi i basit. *Metoda: Farfisa, Anzaghi*	- luan me impostim të saktë të dorës së majtë. - përdor korrekt kacekun.

	etj.	
Ushtrime me dy duar Etyde	- Ushtrime, etyde të ndryshme. *Metoda: Farfisa, Anzaghi, Cerni etj.*	- unifikon lojën ne dy duar; - zhvillon tingullin; - realizon frazën dhe përdorimin korrekt të kacekut.
Pjesë shqiptare dhe të huaja	- Valle të thjeshta, pjesë të vogla nga autorët: A.Kareco, G.Avrazi etj. - Pjesë te vogla, transkiptime të kompozitorëve të huaj.	- unifikon lojën me dy duar; - luan pastër teknikisht, muzikalisht programin; - luan në karakterin e duhur pjesët.

Kontrolle teknike	**Saxho 1**	**Saxho 2**
Programi në kontrollet teknike - 2 kontrolle teknike në vit. - Luhen 2 etyde.	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë të huaja.	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë të huaja (2-3).

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FIZARMONIKË**
Lënda: **FIZARMONIKË**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	- Shkallë maxhore dhe minore me dy oktava me shoqërim të thjeshtë basi. - Arpezhe, akorde me shoqerim të thjeshtë basi.	- luan shkallët saktë teknikisht; - përdor korrekt kacekun; - zhvillon tingullin.
Ushtrime dhe etyde	- Ushtrime me vlera 1/16. - Ushtrime me pikën e vlerës me nota 1/8. - Ushtrime mbi trioletin - Ushtrime për kontrabasin në dorën e majtë. *Ushtrimet nga metodat: Farfisa, Anzaghi, Cerni, Fugazza etj.*	- unifikon lojën me dy duar; - zhvillon tingullin; - luan me fraza dhe përdor korrekt kacekun.
Pjesë të vogla polifonike	**Minuete** - Bach, Moxart, Hendel etj.	- njeh polifoninë dhe stilin e saj; - luan minuetet në karakter; - zhvillon aftësitë interpretative.
Pjesë shqiptare	**Valle të ndryshme te punuara** për fizarmonike, muzike filmash etj.	- luan duke unifikuar lojën e dy duarve; - luan vallet në karakterin e tyre.
Pjesë të huaja	- Vals, romanca, tango etj. - 2 pjesë ëe punuara për fizarmonikë ose transkiptime nga kompozitorët : Bethoven, Moxart etj.	- unifikon lojën; - realizon saktë dinamikat e kërkuara; - zhvillon aftësinë interpretative.

Kontrolle teknike	**Saxho 1**	**Saxho 2**
Programi në kontrollet teknike - 4 kontrolle teknike në vit. - Luhen shkallë maxhore dhe minore. - Luhen 2 etyde.	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë polifonike. - Pjesë të huaja (2-3 pjesë).	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë polifonike. - Pjesë klasike. - Pjesë variete.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FIZARMONIKË**
Lënda: **FIZARMONIKË**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	- Shkallë maxhore, minore (në tri forma) paralel me dy duar, në dy oktava. - Linja të kundërta në bas. - Terce në bas. - Arpezhe, akorde, përmbysjet e tyre paralel në dy duar.	**Nxënësi:** - luan saktë teknikisht; - përdor korrekt kacekun; - zhvillon tingullin.
Ushtrime unison	- Ushtrime unison: Hanon	- artikulon mirë gishtat në të dy duart; - unifikon lojën e dy duarve dhe tingullin**;**
Etyde dhe ushtrime teknike	Metodat: - Farfisa; - Anzaghi; - Heler. - Cerni etj.	- zhvillon tingullin dhe organizimin e tyre në temp të shpejtë; - realizon lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore; - luan duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative.
Pjesë polifonike	- Prelude, Minuete etj. - Bach - Moxart - Hendel etj.	- luan në stil polifoninë; - zhvillon shprehitë ekzekutive; - luan frazat të qarta.
Pjesë shqiptare	**Pjesë shqiptare nga kompozitorët:** - A. Krajka - F.Deda - A.Peci	- luan saktë teknikisht dhe muzikalisht; - luan pjesët në karakterin e duhur; - zhvillon më tej aftësitë interpretative individuale.

Pjesë të huaja	**Klasike:** - Moxart - Haydn - Clementi etj. **(Transkiptime për fizarmonikë)** **Variete:** - R.Galliano - A.Piazzolla - J.Colombo - A.Astier etj. **Kontemporane:** - B.Doëlasz - B.Precz - R.Poterov etj.	- realizon saktë teknikisht dhe muzikalisht; - luan me tingull duke realizuar dinamikat e caktuara, akcentet etj. - interpreton duke nxjerrë në pah aftësitë individuale.

Kontrolle teknike	**Saxho 1**	**Saxho 2**
Programi në kontrollet teknike - 4 kontrolle teknike në vit. - Luhen shkallë maxhore dhe minore. - Luhet një ushtrim Hanon. - Luhen 2 etyde.	**Programi në saxho** - Pjesë klasike. - Pjesë variete. - Pjesë shqiptare. - Pjesë kontemporane.	**Programi në saxho** - Pjesë shqiptare. - Pjesë kontemporane. - Pjesë klasike. - Pjesë variete.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FIZARMONIKË**
Lënda: **FIZARMONIKË**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 9-të, në programin e fizarmonikës, nxënësi:

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Program i detyrueshëm**
Shkallë muzikore	- Shkallë maxhore, minore me diezis e bemola deri në 7 shenja: - paralel në dy duar. - me linja të kundërta në bas. - me tercë në bas - Arpezhe, akorde, paralel në dy duar. - Shkalla kromatike.	***Nxënësi:*** - unifikon tingullin dhe lojën në dy duar; - përdor korrekt kacekun duke realizuar frymëmarrjet.
Ushtrime unison	**Ushtrime unison** – Hanon	- artikulon saktë gishtat në dy duart; - unifikon tingullin në dy duar.
Etyde dhe ushtrime teknike	**Metodat:** - Farfisa - Heler - Cerni - Kramer etj.	- realizon lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore; - zhvillon tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë; - luan duke zhvilluar interpretimin individual.
Pjesë polifonike	- Prelude, Toçata, Invencione etj. - Bach, Hendel, Farfisa etj.	- zhvillon shprehitë interpretative; - luan veprat në stilin e duhur; - përdor korrekt kacekun për të realizuar frazat.
Pjesë shqiptare	**Kompozitorët :** - A.Peci - A.Krajka - F.Deda - A.Ballici etj	- luan pjesët në karakterin e duhur të tyre; - respekton dinamikat në partiture; - zhvillon aftësitë teknike e interpretative.
Pjesë të huaja	**Pjesë klasike:** - Moxart - Haydn - Vivaldi etj.	- realizon gjatë lojës në instrument të gjitha elementet teknike-muzikale; - luan veprat në stilin e duhur. - evidenton kontrastet, akcentet,

	Pjesë variete : - Valse (Duleu, Colombo, Galliano, Astier, Shtrauss etj.) - Polka (Frossini, Astier etj.) - Tango (Piazzolla, Rodriguez etj.)	temat kryesore etj.; - zbaton ndërrimin e regjistrave të tingullit në momentet e kërkuara; - zhvillon më tej aftësite interpretative dhe individualitetin e tij artistik.

Kontrolle teknike	**Saxho 1**	**Saxho 2**
Programi në kontrollet teknike - 3 kontrolle teknike në vit. - Luhen shkallë maxhore dhe minore. - Luhet një ushtrim Hanon - Luhen 2 etyde.	**Programi në saxho** - Pjesë klasike. - Pjesë variete. - Pjesë shqiptare. - Pjesë kontemporane.	**Programi në saxho** - Pjesë shqiptare. - Pjesë kontemporane. - Pjesë klasike. - Pjesë variete.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT**
Lënda: **FLAUT**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të klasës së 9-të, nxënësi:

- njeh instrumentin, historikun e lindjes dhe të zhvillimit të instrumentit të flautit;
- koncepton tërësinë e instrumentit, duke u njohur fillimisht me pjesët përbërëse të tij, si: trupi, bokina, tastiera dhe pastaj, me lidhjen unike të tyre.;
- krijon një impostim të rregullt, duke qenë veçanërisht i vëmendshëm në lirshmërinë e tingullit, mbajtjen lirshëm të instrumentit, lirshmërinë e krahëve e të gishtave, si edhe përdorimin e diafragmës në frymëmarrje;
- fiton njohuri të mira për regjistrat e instrumentit dhe pozicionet bazë të tij;
- përvetëson elementet teknike dhe artistike të lojës në instrument;
- përdor nuanca interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik, por edhe në shkallët e të gjitha llojeve e në etydet teknike;
- imposton në mënyrë të sigurt goditjen legato, portato, detashe;
- fiton njohuri të mira për solfezhin;
- luan shkallët deri në katër shenja # (diezis) dhe b (bemola);
- zhvillon një formim teorik dhe edukim muzikor për njohjen sa më të gjerë të periudhave të ndryshme ihistorike, stileve krijuese, interpretative nga periudha e barokutderi tek muzika e shekullit XX;
- luan ushtrimet e etydet dhe pjesët në tempet reale, duke zhvilluar aftësitë krijues të tij brenda kërkesave teknike artistike;
- respekton dinamikën (pp, p, mf, f, ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj.;
- jep idenë e shprehjeve të unifikuara e të pandara nga njëra- tjetra;
- luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë, duke u përpjekur të shmangëtingujt e përciptë dhe rrëshqitjet aksidentore të intonacionit;
- krijon shprehi mbi leximin e partiturës me agogjike, dinamike dhe artikulim;
- zhvillon memorien muzikore, leximi (aprimavista);
- harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos;
- kontrollon intonacionin në marrëdhënie të dyanshme.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Flaut"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Reazultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë të thjeshta** - Instrumenti dhe pjesët përbërëse të tij. - Ushtrime për impostimin e instrumentit të flautit dhe elementet	***Nxënësi:*** - realizon në mënyrë të veçantë impostimin (bokaturën); - praktikon frymëmarrjen dhe

	e tij. - Ushtrime në formën e shkallëve dhe arpezheve për pozicionet e dorës së majtë dhe të djathtë në Oktavën I dhe ll. - Vendosje e bokinës - Mësimi i tastierës (Notat) - Shkallët deri në 2 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar. - Shkallët deri në 2 shenja b (Bemol) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar deri në një oktavë.	frymënxjerrjen e rregullt (diafragmën); - mban trupin drejt dhe përdor lirshëm duart dhe gishtat; - përdor lirshëm atakun (goditjen) dhe nxjerrjen e tingullit; - përvetëson pozicionet neokatava e parë; - luan shkallët e arpezhet, intervalet me ritëm të ngadaltë e mesatar: legato e stakato; - ushtrohet në mënyrë sistematike me ushtrime gishtash.
Ushtrime dhe etyde	**4-5 ushtrime në muaj** - Metoda E. Prill. - P. F. Artaud. - E. Kohler (fillestarë). - Ëastall. - Simon Hunt. - H. Pllatonov për fillestarët. - Metoda A. C. Petersen. - Harris ushtrime teknike.	- luan saktë aplikaturat; - përvetëson elementet teknike, si: tingullin, goditjen, frymëmarrjen; - respekton aplikaturat dhe dinamikën; - interpeton me kualitet timbrik intonativ; - zhvillon ushtrime për diafragmën.;

Programi artistik	**3-4 duete për flaut** - Aria -Moxart. - Flauti magjik - Ë. A. Moxart. - Gavotte - J. S. Bach. - Minuet - J. S. Bach. - Minuet -Moxart. - Polonaise - J. S. Bach. - Sarabanda: J. S. Bach. - Andantino - F. Rust. - Minuetto - J. Hajden. - Rondo - J. F. Dandrieu. - Andante, Espressivo - F. Mendelson. - Melodi- Bethoven - Melodi- **Ç**ajkovski. - Melodi- Shuman. - Romance – Shubert. - Aria - J. Andersen. - Polonaise - Th. Oesten. - Nina- Nana - P. Gaci. - "Malësori i vogël" - T. Harapi. - Melodi - Ç. Zadeja.	- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës; - përvetëson pjesët në klasë, nga ana ritmike dhe kohë pas kohe nga ana e lojës melodike dhe interpretative; - punon me prioritet dhe përballet me vështirësitë që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike dhe emocionale; - kërkon elementet e para të interpretimit artistik, duke zbuluar karakteristikat e secilit autor; - realizon lojë me ngjyra dhe emocionalitet; - praktikon mësimin e pjesëve përmendsh.

Klasa VI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2 shkallë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. - 2 ushtrime nga materialet e zhvilluara gjatë semestrit.	**Programi në saxho:** - 3 pjesë të huaja të përzgjedhura nga repertori. - 1 pjesë shqiptare.	**Programi në saxho:** - 4 pjesë të huaja të përzgjedhura nga repertori. - 2 kohë sonatë. - 1 pjesë shqiptare.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT**
Lënda: **FLAUT**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtja tematike e lëndës "Flaut"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallë muzikore	- Shkallët maxhore e minore me tre shenja me # (Diezis) dhe b (Bemola) me (dy oktava) ngadalë dhe me ritëm mesatar. - Shkallë kromatike në metrin 2/4 e 1/4 në tempe mesatare.	***Nxënësi:*** - luan shkallët me tingull të plotë e pa gabime; - luan shkallët detashe në format stakato e legato; - luan pa gabime arpezhet dhe përmbysjet e tyre; - realizon shkallët muzikore në të gjitha mënyrat.
Ushtrime dhe etyde	**5-6 ushtrime në muaj** - E. Prill. - E. Kohler: Fashikulli i parë. - F. Caratge: 12 etyde. - Harris: Ushtrime teknike. - L. Moyse- Ushtrime për Flaut: Fashikulli i parë. - Etyde Gali. - Metoda P. Tafanel.	- realizon gjatë lojës aplikaturat, frymëmarrjen, ritmikën e ushtrimit etj.; - respekton dinamikën e ushtrimeve; - realizon frymëmarjen mbi bazën e logjikës muzikore dhe teknike; - luan etydet me ndjenjë, pastër e pa gabime; - i kushton vëmendje të veçantë tingullit dhe intonacionit të pastër.
Program artistik	**3-4 duete** për flaut nga: - Zhiga nga Sonata në Fa Maxhor, Moxart. - Moxart- Sonatë. - Minuetto nga J. S. Bach: I, II, III dhe Gavote Bach. - Brams: Vals op. 39, Nr. 15. - Shubert: Vals. - Bethoven: Pjesë vocale. - B. Marcello: Alegro. - N. R. Korsakoff: Tema nga Sheherazade.	- praktikon duetet, në fillim me mësuesin dhe, në një fazë të dytë, luan me nxënës të tjerë bashkëmoshatarë; - ushtron fillimisht kuptimin ritmik të pjesëve dhe, më pas, tërësinë e tyre melodike; - respekton dinamikën e pjesëve; - ushtrohet në mënyra të ndryshme për vështirësitë teknike që shfaqen në materialin muzikor; - evidenton karakteristikat e autorëve

	- H. Bokerini: Minuetto. - Hendel: Zhiga F. Dur. - Hendel: Sonata 2-3. - Teleman: Sonata Nr. 2. - Teleman: Suite La minor. - Teleman: Minuete. - Vivaldi Sonatë Fa maxhor. - Vivald- Koncert Nr. 4. 5. - Blavet- Vol. I Sonata Flaut. - Pjesë shqiptare.	të veçantë.

Klasa VII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2 shkallë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. - 2 ushtrime nga materialet e zhvilluara gjatë semestrit.	**Programi në saxho:** - 1duet. - 2 kohë sonatë. - 1 kohë koncert. - 1 pjesë shqiptare.	**Programi në saxho:** - 2 – 4 kohë sonatë. - 1 kohë koncert - 1 pjesë shqiptare.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT**
Lënda: **FLAUT**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1.Përmbajtja tematike e lëndës "Flaut"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultate të pritshme
Shkallë muzikore	**Të gjitha shkallët me 4 shenja:** - me diezis e bemola; - minoret përkatëse; - arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato me temp mesatar dhe të shpejtë. **Loja e shkallëve** plotësohet nga: - dominant septakordi; - septakordi i zvogëluar për minorenë; - shkallët kromatike me dy oktava, ***Metodat Tafanel - Goubert*** dhe ushtrime të përditshme nga Soussman, op. 43.	***Nxënësi:*** - luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit; - luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato; - luan saktë dominant septakordin dhe septakordin e zvogëluar i minorit; - ka një organizim të mirë e të qartë të shkallëve e arpezheve.
Ushtrime dhe etyde	**3 etyde** në muaj si më poshtë: - Kohler: Fash. II. - Sousman: Fashikulli II. - V. Pllatonov. - Moyse: Ushtrime për flaut – Fashikulli I. - Berbiguer - 18 etyde. - Etyde- Gali. - Etyde - F. Caratge .	- është i përpiktë në zbatimin e aplikaturave; - i kushtohet një vëmendje të veçantë nuancave shprehëse; - respekton dinamikën e ushtrimeve dhe të etydeve; - kërkon vazhdimisht unifikimin e regjistrave; - zbaton kërkesat për një frymëmarrje të lirshme e të natyrshme.
Programi artistik	**4-5 duete për flaut:** - 2- 4 kohë sonatë. - 1 kohë koncerti. - Minuete. - Pjesë solo për flaut. - Pjesë nga autorë të huaj. - Pjesë nga autorë shqiptarë. - Sonata Teleman në Fa maxhor dhe Si b maxhor. - Bach: Sonatat 4.	- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës; - luan pjesët për flaut e piano , duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve; - luan mirë nga ana ritmike e melodike, si dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument; - praktikon mësimin e pjesëve përmendsh;

	- F. Hendel: Sonata 2,3, 5. - Moxart: Sonata. - Vivaldi: Nga volumi i gjashtë koncerteve. - Teleman- Sonatë Nr. 1, 2. - Stamitz: Koncert G- Dur. - M. Blavet, Vol. I, Sonata Flaut. - Fils: Koncert. - Shopen – Variacione. - M. Clement- Sonatina, op. 36, Nr. 1. - Pop: Pjesë Nr. 2 Flaut- Piano, op. 371. - Pjesë shqiptare.	- shpreh në mënyrë të konsoliduar elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit; - evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë të pjesëve; - zbërthen veçoritë e formës muzikore.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2-3 shkallë të praktikuara - 2- 3 ushtrime nga materialet e zhvilluara.	**Programi në saxho:** - 2- 4 kohë sonatë e plotë. - 1 kohë koncert. - 1 pjesë shqiptare ose e huaj.	**Programi në saxho:** - 1 sonatë e plotë. - 1- 3 kohë koncert - 1 pjesë bravurë, shqiptare ose e huaj.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **FLAUT**
Lënda: **FLAUT**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtja tematike e lëndës "Flaut"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallë muzikore	**Të gjitha shkallët:** - me diezis e bemola; - minoret përkatëse; - arpezhet e tyre, në mënyrat stakato e legato. **Loja e shkallëve** plotësohet nga: - dominant septakordi; - septakordi i zvogëluar për minoren. - shkallë dhe arpezhe nga R. Desmet *Metodat Tafanel - Goubert dhe ushtrime të përditshme nga Soussman, op. 43*.	- luan shkallët në mënyrë të saktë, pastër e përmendsh, duke prekur gjithë tastierën e flautit; - luan përmbysjet, si: kuartola, triola e septola me legato e stakato; - luan saktë dominant septakordin dhe septakordin e zvogëluar i minorit; - ka një organizim të mirë e të qartë të shkallëve e arpezheve.
Ushtrime dhe etyde	**3 etyde** në muaj si më poshtë: - E. Kohler: Fash. II, po. 33. - F. Caradge. - V. Pllatonov. - L. Moyse: 1-2-3. - Berbiguer - 18 etyde. - Th. Bochm: Op. 15. - J. Andersen: Op. 21. - Gali- Etyde. - Eisenhauer - Etyde.	- është i përpiktë në zbatimin e aplikaturave; - i kushtohet një vëmendje të veçantë nuancave shprehëse; - respekton dinamikën e ushtrimeve dhe të etydeve; - kërkon vazhdimisht unifikimin e regjistrave; - zbaton kërkesat për një frymëmarrje të lirshme e të natyrshme.
Programi artistik	**4-5 duete për flaut** - 4 kohë sonatë. - 1-3 kohë koncert. - Minuete. - Suita. - Pjesë solo për flaut. - Pjesë nga autorë të huaj. - Pjesë nga autorë shqiptarë. - Sonata Teleman në fa maxhor dhe	- luan duetet në klasë së bashku me mësuesen ose me shokët e klasës; - luan pjesët për flaut e piano , duke krijuar një harmonizim të plotë të dy instrumenteve; - luan mirë nga ana ritmike e melodike, si dhe shpreh natyrën koncertale të lojës në instrument; - praktikon mësimin e pjesëve

	Si bemol maxhor. - Bach: Sonatat 4. - Hendel: Sonata 3, 4, 5, 7. - C. Ph. E. Bach: Sonata solo. - Moxart: Sonata. - Moxart : Seranate Nr. 1 - Vivaldi: Nga volumi i gjashtë koncerteve. - F. Gosek -Tamburini - J.S. Bach: Siciliana. - Melodi Gluk nga opera "Orfey". - Tema me variacione nga F. Shopen - J. Quantz: Koncert në sol maxhor. - Stamitz: Koncert G- Dur. - G. P. Teleman: Sonatë F. Dur, Vivace. - Pjesë shqiptare nga Nikolla Zoraqi: "Gezim Feminor"; Feim Ibrahimi dhe nga Paparisto - Romancë.	përmendsh; - shpreh në mënyrë të konsoliduar elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat e interpretimit; - evidenton karakteristikat e autorëve të veçantë të pjesëve; - zbërthen veçoritë e formës muzikore.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2-3 shkallë të praktikuara - 2- 3 ushtrime nga materialet e zhvilluara.	**Programi në saxho:** - 1 sonatë e plotë. - Kohë e parë koncerti me kadencë. - 1 pjesë shqiptare ose e huaj.	**Programi në saxho:** - 1 sonatë e plotë. - 1- 3 kohë koncert - 1 pjesë bravurë, shqiptare ose e huaj.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psiko-emocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u

përgjigjen grupmoshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

3. Vlerësimi

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale.
Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset vlerësimi i nxënësit

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan:
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.
-

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan mirë:
- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion,
- pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- *luan shumë mirë në të gjitha elementet e mësipërme.*

Shënim: *Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.*

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KITARË**
Lënda: **KITARË**
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Kitarë", nxënësi:

- realizon programin e përzgjedhur nga mësuesi (bazuar në programin e lëndës);
- ka një impostim të saktë të duarve;
- luan shkallët me një dhe dy oktavë;
- njeh telat e kitares dhe notat në pozicionin e parëdhe të dytë;
- pickon saktë telat dhe të ketë rrdhjeshmëri në arpezhet;
- realizon materialet për teknikat përkatëse të materialeve që luan;
- punon për të zhvilluar tingullin dhe organizimin e tij në temp më të shpejtë, duke futur gradualisht të gjitha elementet e teknikës së kitares;
- interpreton saktë tirando;
- luan rrjedhshëm apojando;
- luan me nota të lidhura;
- njeh figurat e ndryshme ritmike;
- mëson të bllokojë baset;
- luan me tingull të qartë dhe me nota të mbajtura.
- forcon teknikën e zbarrës;
- luan saktë legatot;
- luan me një tingull të qartë dhe të bukur.

1. Përmbajtja tematike e lëndës "Kitarë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultate të pritshme
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	- **8 shkallë muzikore** të metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). - Ushtrime teknike. - **Metoda:** - Mauro Giuliani, - Ruggero Chiesa, - Abel Carlevaro, - Mauro Storti, - Julio Sagreras etj.	***Nxënësi:*** - ka impostim të mirë të duarve; - realizon teknikisht shkallët maxhore dhe minore; - realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë në metodat përkatëse; - luan me progresion ritmik dhe figurativ.

Etyde	- Metoda M.Storti. - Metoda Sor dhe Coste (Chiesa). - Metoda Aguado. - Metoda Julio Sagreras - Metoda Carulli (Arr. Chiesa). - Metoda Giuliani (Arr.Chiesa) - Metoda H.Tauchert etj E	- realizon teknikisht etydet; - luan në tempin e duhur; - luan përmendsh materialin; - luan figurat ritmike; - luan tingull të lidhur; - njeh pozicionet në kitare.
Kohë nga suitat paraklasike	**1-2 Kohë** nga suitat: - Bach, - Sanz - De visee - Milan etj.	- luan në tempin dhe stilin e duhur; - ndjen zërat dhe linjat polifonike; - kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit; - luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira.
Vepër ciklike (klasike)	**Temë me variacion, Rondo, Capriçio** - F.Sor, - F.Carrulli, - M.Giuliani, - A.Diabelli, - M. Carcassi, - A.Vivaldi, - Gragranji etj.	- realizon tempet e pjesëve muzikore; - njeh figurat ritmike dhe luan me interpretim; - ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi.
Bravura romantike ose kontemporane	**2 bravura** nga autorë, si: - F.Tarrega, - J.Ferrer, - C.Henze, - J.Mertz, - J.Duarte, - J.Sagreras, - M.Linnemann, - H.Tauchert etj. *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th. Assimakopulos*	- luan në stilet dhe tempet e duhura; - realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo bravure; - luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze; - zhvillon personalitetin e tij në lojë.

Klasa VI		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**

Programi në kontroll teknik: - 2 kontrolle teknike përgjatë vitit: - 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. - 2 etyde.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1-Variacione, rondo, capriçio. - 1 bravurë.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio. - 1 bravurë.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KITARË**
Lënda: **KITARË**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	- **8 shkallë muzikore** të metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). - **Metoda:** - Mauro Giuliani, - Ruggero Chiesa, - Abel Carlevaro - Mauro Storti - Julio Sagreras etj.	***Nxënësi:*** - luan shkallët me apojando dhe tirando dhe me tingull të qartë; - realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e Barres dhe të legatos; - realizon kalimet deri në pozicionin e 2-të.
Etyde	- Metoda Sor dhe Coste (Chiesa) - Metoda Aguado. - Metoda Julio Sagreras - Metoda Carulli (Arr. Chiesa). - Metoda Giuliani(Arr.Chiesa) - Metoda H.Taucher etj.	- realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet; - ndjen gjatë lojës në instrument frazimet; - luan në tempin e duhur; - luan figurat ritmike; - luan me një tingull të pastër dhe të qartë.
Kohë nga suitat paraklasike	**1-2 kohë** (kontrastuese) nga suitat: - Bach, - Sen Sanz, - Roncall, - R.De Vise etj.	- luan në stilin e duhur; - dallon tempet e kohëve të ndryshme të suitave; - luan duke mbajtur notat të lidhura; - dallon qartë linjat e zërave dhe muzikën polifonike.
Vepër ciklike (klasike): variacione, rondo, capriçio.	**2 vepra të plota ciklike:** - M.Giuliani, - F.Carulli , - F. Sor - M.Carcassi etj.	- njeh formën dhe ndërtimin të veprës që luan; - njeh mirë stilin e autorit; - dallon tempet e ndryshme brenda veprës; - luan me rrjedhshmëri në kalimet; - luan me një tingull qartë dhe t'i përshtatet lojës dinamike të veprës.
Bravura romantike	**2-3 bravura** nga autorë, si:	- luan rrjedhshëm dhe me

ose kontemporane.	F.Tarrega, J.Ferrer, J.Sagreras, K.Henze, D.Fortea, H.Tauchert M.Linnemann etj. *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th. Assimakopulos*	interpretim; - luan saktë për sa i përket dinamikës kontrastuese sidomos te bravurat; - luan duke i përcjellë publikut (në saxho) emocionet e tij të brendshme.

Klasa VII		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2 kontrolle teknike përgjatë vitit: - 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. - 2 etyde.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio. - 1 bravurë.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio etj. - 1 bravurë.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KITARË**
Lënda: **KITARË**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Materiale ndihmëse Teknike	- **4 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). - Ushtrime teknike. - **Metoda:** - Mauro Giuliani, - Ruggero Chiesa, - Abel Carlevaro, - Mauro Storti, - F.Tarrega etj.	***Nxënësi:*** - luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi; - njeh tri pozicionet e para të kitares; - pickon qartë mbi tela dhe të ketë rrjedhshmëri në arpezhet.
Etyde	- F.Carrulli. - M.Carcassi. - F.Sor. - M.Giuliani. - D.Aguado.	- realizon teknikisht etydet; - luan në ritmet dhe tempet e duhura; - luan me kontrastet dinamike.
Kohë nga suitat paraklasike	**2 kohë** nga suitat: - J.S. Bach. - G. Sanz. - R. de Visse etj.	- luan në stilin e Barokut; - ka njohuri mbi ndërtimin e strukturës polifonike të kohëve të suitës; - luan me nota dhe tinguj të zgjatur; - luan ndryshimin e tempeve për secilën kohë të suitës.
Vepër ciklike, si: **- Temë me variacione** **- Rondo** **- Capriçio**	**2 vepra ciklike të plota** nga: - F. Sor, - M.Carcassi, - F. Carrulli, - M.Giuliani, - L.Legniani, - N.Paganini.	- interpreton stilin e autorit që do të luajë; - performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.
Bravura klasike	**2 bravura** nga autorë, si:	- njeh epokat dhe stilet e autorëve

romantike apo kontemporane	- J.Sagreras, - J.Ferrer, - K.Henze, - D.Fortea, - F.Tarrega, - H.Tauchert, - M.Linnemann. *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th. Assimakopulos.*	që do të luajë; - luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato; - performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale; - transmeton emocione; - ndjen individualitetin e tij në lojë.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 4 kontrolle teknike përgjatë vitit: - 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. - 2 etyde.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio. - 1 bravurë.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio etj. - 1 bravurë.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KITARË**
Lënda: **KITARË**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Materiale ndihmëse teknike	- **4 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). - Ushtrime teknike. - **Metoda:** - Mauro Giuliani, - Ruggero Chiesa, - Abel Carlevaro, - Mauro Storti, - F.Tarrega	***Nxënësi:*** - luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi; - njeh tri pozicionet e para të kitares; - pickon qartë mbi tela dhe të ketë rrjedhshmëri në arpezhet.
Etyde	**Etyde** : - F.Carrulli, - M.Carcassi, - F.Sor, - M.Giuliani, - D.Aguado, - A.Diabelli.	- realizon teknikisht etydet; - luan në ritmet dhe tempet e duhura; - luan me kontrastet dinamike.
Kohë nga suitat paraklasike	**2 kohë** nga suitat: - J.S.Bach, - G.Sanz, - R.de Visse.	- luan në stilin e Barokut; - ka njohuri mbi ndërtimin e strukturës polifonike të kohëve të suitës; - luan me nota dhe tinguj të zgjatur; - luan ndryshimin e tempeve për secilën kohë të suitës.
Vepër ciklike, si: **-temë me variacione,** **- rondo** **- capriçio**	**2 vepra ciklike të plota** nga: - F.Sor, - M.Carcassi, - F.Carrulli, - M.Giuliani, - L.Legniani, - A.Diabelli,	- interpreton stilin e autorit që do të luajë; - performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.
Bravura klasike	**2- bravura** nga autorë, si:	- njeh epokat dhe stilet e autorëve

romantike apo kontemporane	- J.Sagreras, - J.Ferrer, - K.Henze, - D.Fortea, - F.Tarrega etj. *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th. Assimakopulos*	që do të luajë; - luan me tingull të lidhur dhe me pak rubato; - performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale; - transmeton emocione; - ndjen individualitetin e tij në lojë.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2 kontrolle teknike përgjatë vitit: - 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. - 2 etyde.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio. - 1 bravurë.	**Programi në saxho:** - 1-2 kohë suite. - 1 variacione, rondo, capriçio etj. - 1 bravurë.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Nxënësit e **klasës së 6** janë fillestarë dhe duhet të tregohet një kujdes i vecantë nga mësuesi në impostimin sa më të saktë të duarve. Mësuesi duhet të ketë parasysh që për një formim sa më të saktë të dorës së djathtë duhet të punojë me arpezhet dhe për këtë arsye këshillohet të punojë me metodën M.Giuliani. Duke praktikuar shkallët nga metoda e R.Chiesa, nxënësi do të krijojë një tingull të qartë dhe të pastër në dorën e majtë. Mësuesi duhet të përzgjedhë një program të përshtatshëm për nxënësin duke patur parasysh mundësitë fizike dhe intelektin e nxënësit.

Programi do të ndahet në 2 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi nuk merr pjesë në dy kontrollet teknikë të parë, kjo shërben për ti dhënë më shumë kohë për të krijuar një impostim të saktë të duarve.

Për nxënësit e **klasës së 7-të,** mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit. Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale. Nxënësi duhet të njohë figurat ritmike dhe të pickojë qartë telat e kitarës; duhet të njohë pozicionin e parë dhe të dytë të kitarës; duhet të luajë rrjedhshëm shkallët dhe me tingull të lidhur; duhet të njohë zërat në pjesë dhe të interpretojë me shenjat e ngjyrimit, sipas stilit muzikor që luan. Këshillohen të luhen variacione dhe rondo nga metoda e F.Carrullit.

Nxënësit e **klasës së 8-të** duhet të luajnë me program që përfshin tri periudhat stilistike si: barok, klasik dhe romantik. Nxënësi: duhet të ketë të qartë zërat në pjesë dhe të interpretojë bukur stilin barrok; duhet të respektojë shenjat e ngjyrimit dhe interpretimin ne stilin klasik; duhet të ketë lojë të pastër dhe të interpretojë me tinguj të lidhur dhe me rubato, kur e kërkon pjesa romantike; duhet të kuptojë stilin muzikor që luan dhe duhe të krijojë individualitet.

Në **klasën e 9-të** nxënësi nuk luan dy kontrolle teknike, për t'i dhënë kohë në përgatitjen e programit të saxhos dhe atij të konkursit. I caktohet një program individual në varësi të teknikës që zotëron dhe të

mundësive interpretuese që ka. Është e këshillueshmë që programi të jetë i përbërë nga një kohë J.S.Bach, një temë me variacione M.Carcassi dhe nga nje romancë.

Rekomandime për kontrollet teknike

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike (klasa VI nuk luan dy kontrollet e para dhe klasa IX luan 1 kontroll **ç**do semestër). Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar 2 shkallë (maxhore-minore, terca, oktava) me të gjitha mënyrat, si dhe 2 etyde.
I gjithë programi luhet përmendsh.

Rekomandime për saxhot

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho . Në çdo saxho luhet në mënyrë të detyruar:

- 1-2 kohë suite Bah, Sanz, De visee etj. (paraklasikë).
- 1 vepër ciklike, si: Temë me variacione,Rondo ose capriçio (klasike).
- 1 bravurë (klasike, romantike, kontemporane).

I gjithë programi luhet përmendsh.

3. Vlerësimi

- Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).
- Vlerësimi do të jetë nga notat e vendosura për materialet që luan nxënësi.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi i nxënësit në saxhot do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta).
- I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.
- Vlerësimet e nxënësve do të diskutohen nga anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe i përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur :

- ka lëvizje me ritmin;
- ka pickim të dobët dhe tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- nuk ka qartësi në lojë;
- luan me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan mirë ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion;
- luan pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan shumë mirë ritmikisht;
- luan me tingull te qartë dhe të lidhur;

- luan përmëndësh dhe pa gabime;
- interpreton dhe luan me ndjeshmëri pjesët.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KLARINETË**
Lënda: KLARINETË
Klasa: **VI**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të lëndës "Klarinetë" ,nxënësi:

- arrin impostim korrekt bazuar me metodikat bashkëkohore;
- njeh mirë mënyrën korrekte të interpretimit;
- ka njohuri optimale në njohjen e regjistrave në instrument;
- luan shkallën deri me katër shenja, #, b (bemol);
- luan shkallën deri me dy oktava;
- realizon pozicionet bazë dhe sidomos notat lart, ne oktaven 2, 3 në instrumentin e klarinetës;
- zhvillon vazhdimisht për perfeksionimin e aparatit të frymëmarrjes (diafragmë);
- imposton mirë legaton (goditjen), portato, detashe, stakato;
- ka të mira deshifruese me instrument;
- luan me tingull dhe intonacion të kontrolluar (korrekt).

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Klarinetë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallët në instrument	- Shkallë deri me katër shenja # (diezis) dhe relativet e tyre, në ritëm të përmbajtur. - Shkallë deri me katër shenja b (bemol) dhe relativet e tyre, në ritëm të përmbajtur. - Ushtrime dhe etyde për nivelin fillestar.	**Nxënësi:** - luan pastër e pa gabime shkallët; - luan intervalet e sekondës, terce, legato e detashe; - luan arpezhin, me përmbysje dhe dominant septakordin, me përmbysje; - luan shkallën minore, septakordin e zvogëluar, me përmbysje.
Ushtrime dhe etyde	**Katër ushtrime ne muaj.** - Jozeph Marchi- metodë moderne për fillestarë. - Demnitz- ushtrime për nxënës të avancuar.	- interpreton me korrektesi aplikaturat e ushtrimit, etydit; - respekton dinamikën; - respekton frymëmarrjen e vendosur në vepra.

Programi artistik	- Moxart – Pjesë per Kl dhe Piano. - C.Gervaise – Allemande. - J.S.Bach – Suite, musete, suite Anglaise Nr.3. - Moxart – Romance. - P.Gaci – Nina Nana. - P.Dungu - Pjesë per Kl dhe Piano. - R.Shuman - Pjesë per Kl dhe Piano nr.1, 2, 3.	- punon me prioritet dhe mënyra (forma), vështirësitë teknike që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike, emocionale.

Klasa VI		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Shkallët e punuara. - 1-2 ushtrime të përzgjedhura nga materialet e punuara.	**Programi në saxho:** - Moxart – Pjesë per Kl dhe Piano. - C.Gervaise – Allemande. - Bach – Suite, musete, suite anglaise nr.3.	**Programi në saxho:** - P.Dungu - Pjesë për Kl dhe Piano. - Moxart – Romancë. - P.Gaci – Nina Nana - Çajkovsky - Pjesë për Kl dhe piano.
Shënim: Për nxënësit fillestarë, mësuesi përzgjedh nga repertori i lartpërmendur pjesë për klarinetë e piano, me shtrirje 1 oktavë. Mësuesi mund të ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi duke parë gjendjen e vazhdueshme teknike që shfaq nxënësi.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KLARINETË**
Lënda: **KLARINETË**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Klarinetë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallët në instrument	- Shkallë me dy oktavë, me katër shenja # (diezis) dhe relativet e tyre, në ritëm te përmbajtur . - Shkallë me dy oktavë me katër shenja b (bemol) dhe relativet e tyre, në ritëm të përmbajtur. - Ushtrime dhe etyde për nivelin fillestarë dhe të avancuar.	**Nxënësi:** - luan pastër e pa gabime shkallët; - luan intervalet e sekondës, terce, legato e detashe; - luan arpezhin, me përmbysje dhe dominant septakordin, me përmbysje; - luan shkallën minore, septakordin e zvogëluar, me përmbysje.
Ushtrime dhe etyde	- 4 ushtrime në muaj. - Demnitz: ushtrime.	- interpreton me korrektësi aplikaturat e ushtrimit, etydit; - respekton dinamikën; - respekton frymëmarrjen e vendosur në vepra.
Programi artistik	- Moxart – Romancë. - P.Gaci – Nina nana. - P.Gaci – Vogëlushja. - L.Dizdari – Fjalët e qiririt. - Hayden – Adagio. - Moxart – Romancë Kv Opendice 229. - J.Ph.Rameau – Menuet. - P.Gaci – Valle. - L.Bassi - Lamento, Nocturne. - Moxart – Valle fshatare.	- punon me prioritet dhe mënyra (forma), është rësitë teknike që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike, emocionale.

Klasa VII		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Shkallët e punuara.	**Programi në saxho:** - Moxart – Romancë.	**Programi në saxho:** - L. Dizdari – Fjalët e

- 1-2 ushtrime të përzgjedhura nga etydet ose ushtrimet e bëra.	- P.Gaci – Nina Nana. - P.Gaci – Vogëlushja. - Hayden – Adagio. - Moxart – Romancë Kv Opendice 229. - J.Ph.Rameau – Menuet.	qiririt. - P.Gaci – Valle. - Moxart – Valle fshatare. - L.Bassi - Lamento, Nocturne.
Shënim:. Mësuesi mund të ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi duke parë gjendjen e vazhdueshme teknike që shfaq nxënësi.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KLARINETË**
Lënda: **KLARINETË**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Klarinetë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallët në instrument	- Shkallë me dy oktavë, me katër shenja # (diezis) dhe relativet e tyre, në ritëm te përmbajtur . - Shkallë me dy oktavë me katër shenja b (bemol) dhe relativet e tyre, në ritëm të përmbajtur. - Ushtrime dhe etyde për nivelin fillestarë dhe të avancuar.	**Nxënësi:** - luan pastër e pa gabime shkallët; - luan intervalet e sekondës, terce, legato e detashe; - luan arpezhin, me përmbysje dhe dominant septakordin, me përmbysje; - luan shkallën minore, septakordin e zvogëluar, me përmbysje.
Ushtrime dhe etyde	- 4 ushtrime në muaj. - Demnitz: ushtrime.	- interpreton me korrektësi aplikaturat e ushtrimit, etydit; - respekton dinamikën; - respekton frymëmarrjen e vendosur në vepra.
Programi artistik	- T.Harapi – Valle. - L.Dizdari – Romance. - Agim Kola – Romance. - Pollodino – Barkarola. - Moxart –Divertimento nr.3 koha I. - X.Lefevre – Sonatë nr.3. - J.Vanhal – Sonatë koha I.	- punon me prioritet dhe mënyra (forma), është rësitë teknike që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike, emocionale.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Shkallët e punuara. - 1-2 ushtrime të përzgjedhura nga etydet ose ushtrimet e bëra.	**Programi në saxho:** - T.Harapi – Valle - L.Dizdari – Romancë - X.Lefevre – Sonata Nr.1 - J.Vanhal – Sonatë koha I	**Programi në saxho:** - Agim Kola – Romancë. - Pollodino – Barkarola. - Moxart – Divertimento nr.3 koha I.

		- X.Lefevre – Sonatë nr.3.
Shënim:. Mësuesi mund të ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi duke parë gjendjen e vazhdueshme teknike që shfaq nxënësi.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **KLARINETË**
Lënda: **KLARINETË**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 2 orë/javë = 70 orë**

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Klarinetë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallët në instrument	- Shkallë me dy oktavë, me katër shenja # (diezis) dhe relativet e tyre, në ritëm te përmbajtur . - Shkallë me dy oktavë me katër shenja b (bemol) dhe relativet e tyre, në ritëm të përmbajtur. Ushtrime dhe etyde për nivelin fillestarë dhe të avancuar.	**Nxënësi:** - luan pastër e pa gabime shkallët; - luan intervalet e sekondës, terce, legato e detashe; - luan arpezhin, me përmbysje dhe dominant septakordin, me përmbysje; - luan shkallën minore, septakordin e zvogëluar, me përmbysje.
Ushtrime dhe etyde	- 4 ushtrime në muaj. - Demnitz: ushtrime - Rose – Etydet e para. - Close – Volumi , etydet e para.	- interpreton me korrektësi aplikaturat e ushtrimit, etydit; - respekton dinamikën; - respekton frymëmarrjen e vendosur në vepra.
Programi artistik	- Agim Kola – Romancë. - Pollodino – Barkarola. - Moxart –Divertimento nr.3. - X.Lefevre – Sonatë nr.1. - X.Lefevre – Sonatë nr.3. - J.Vanhal – Sonatë (tri kohë). - C.Stamitzz – Koncert nr. 3, koha I. - F.Krommer – Koncert, koha I	- punon me prioritet dhe mënyra (forma), është rësitë teknike që shfaqen në materialin artistik; - zbërthen me korrektësi materialin muzikor nga ana ndërtimore, teknike, emocionale.

Klasa IX		
Kontrolle teknike		
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - Shkallët e punuara. - Një ose dy ushtrime të	**Programi në saxho:** - Agim Kola – Romancë. - Pollodino –Barkarol.	**Programi në saxho:** - J.Vanhal – Sonatë. - X. Lefevre - Sonatë nr. 3.

perzgjedhura nga etydet ose ushtrimet e bëra.	- Moxart- Divertimento nr.3. - X.Lefevre – Sonatë nr.1.	- C.Stamitzz - Koncert nr. 3, koha I. - F.Krommer- Koncert, koha I.
Shenim: Mësuesi mund të ndryshojë repertorin me pjesë të tjera te së njëjtës vështirësi duke parë gjendjen e vazhdueshme teknike që shfaq nxënësi.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **të gjitha specialitetet (Instrumentist dhe këngëtarë)**
Lënda: **PIANO SEKONDARE**
Klasa: **VII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në fund të përvetësimit të lëndës nxënësi:

- ✓ përvetëson tastierën e pianos dhe notat e zeza dhe të bardha;
- ✓ realizon me dorën e djathtë veç, të majtën veç, ushtrimet fillestare duke ecur paralelisht me solfezhin;
- ✓ koordinon notat që mëson teorikisht në solfezh, me notat në tastierë, duke njohur si fillim dy regjistrat bazë: soprani dhe basi, d.m.th. notat me çelës soli dhe notat me çelës basi;
- ✓ luan në piano ushtrime fillestare me dy duar, vlerat e notave 4/4 , 2/4, 3/4, ¼;
- ✓ luan deri në fund të vitit, *etyd, minuete, sonatinë, pjesë shqiptare*.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano sekondare"

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Ushtrime	) Ushtrime me dorën e majtë.) Ushtrime me dorën e djathtë.) Tri ushtrime me dy duar.) Ushtrime me 2 duar: Bayer Cherni. **Metoda:** Tomson Lemoir , Bayer, Gnesina	***Nxënësi:*** ➢ njihet me tastierën; ➢ kupton lirshmërinë e krahëve; ➢ mëson pozicionet e duarve në piano; ➢ luan pastër me duar veç.
Minuet dhe Etyde	) Dy Bach - Minuet me dy zëra, maxhor ose minor.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në dy zëra.
Pjesë të vogla të huaja	) Dy sonatina - Haslinger, - Pleyel, - Klementi etj.	➢ Organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.
Pjesa të vogla nga autorë shqiptarë	) Dy pjesë nga autorët tanë: - G. Avrazi - T. Harapi - F. Ibrahimi - Ç. Zadeja.	➢ Luan pastër ritmet e thyera; ➢ punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit.

Klasa VII

Kontrolle teknike	Saxho	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.
Shënim. Programi përdoret edhe për semestrin e dytë duke zgjedhur veprat sipas nivelit individual të nxënësit. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

3. Udhëzime për zbatimin e programit

Për zhvillimin e kësaj lënde mësuesi duhet të impostojë me saktësi pozicionin e duarve si dhe të punojë për lirshmërinë në interpretim. Njohja e tastierës, zbërthimi i pjesëve saktë si solfezh, puna me duar të veçanta, dhe bashkimi i tyre në interpretim, është çelsi i mbarvajtjes së kësaj lënde.Përsa i përket materialeve që duhet të përdorë mësuesi, kështillohen ushtrime Bayer, Çerni, Gnesina, minuete nga Harapi, Bach,Moxart, pjesë të ndryshme të vogla etj.

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **të gjitha specialitetet (Instrumentist dhe këngëtarë)**
Lënda: **PIANO SEKONDARE**
Klasa: **VIII**
Kohëzgjatja: **35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

1. Përmbajtja tematike e lëndës "Piano Sekondare", klasa e VIII

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore maxhore dhe minore	⌡ Shkalla Do+ ⌡ Arpezhe dhe akorde ⌡ Shkalla Sol + ⌡ Arpezhe dhe akorde ⌡ Shkalla La- ⌡ Arpezhe dhe akorde ⌡ Shkalla Mi - ⌡ Arpezhe dhe akorde	***Nxënësi:*** ➢ realizon pjesët me lirshmëri; ➢ respekton gjatë lojës pozicionet e duarve në piano; ➢ luan pastër. ➢ Luan shkallët pastër dhe me axhilitet shkallë maxhor edhe minore.
Minuet dhe Etyde	⌡ Etyde në shkallët e mësuara ⌡ Etyde Çerni, Lemoi. ⌡ Minuete Bach, Moxart.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në dy zëra.
Sonatinë	⌡ Sonatina Klementi- koha e 1-2 etj.	➢ Organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.
Pjesa të vogla nga autorë shqiptarë	⌡ Dy pjesë nga autorët tanë: - R. Sokoli - T. Harapi - F. Ibrahimi - Ç. Zadeja.	➢ Luan pastër ritmet të ndryshme; ➢ punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit.

Klasa VIII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.
Shënim. Programi përdoret edhe për semestrin e dytë duke zgjedhur veprat sipas nivelit individual të nxënësit. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **MUZIKË**
Specialiteti: **të gjitha specialitetet (Instrumentist dhe këngëtarë)**
Lënda: **PIANO SEKONDARE**
Klasa: **IX**
Kohëzgjatja: **35 javë x 1 orë/javë = 35 orë**

1.Përmbajtja tematike e lëndës "Piano Sekondare"

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore maxhore dhe minore	) Shkalla Re+) Arpezhe dhe akorde) Shkalla Fa +) Arpezhe dhe akorde) Shkalla Si-) Arpezhe dhe akorde) Shkalla Re -) Arpezhe dhe akorde	***Nxënësi:*** ➢ realizon pjesët me lirshmëri; ➢ respekton gjatë lojës pozicionet e duarve në piano; ➢ luan pastër. ➢ Luan shkallët pastër dhe me axhilitet shkallë maxhor edhe minore.
Minuet dhe Etyde	) Etyde në shkallët e mësuara.) Etyde Çerni, Lemoi.) Minuete - Bach, Moxart.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në dy zëra.
Sonatinë	) Sonatina Beethoven Sol+etj.	➢ Organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.
Pjesa të vogla nga autorë shqiptarë	) Dy pjesë nga autorët tanë: - L.Dizdari - T. Harapi - F. Ibrahimi - Ç. Zadeja.	➢ Luan pastër ritmet të ndryshme; ➢ punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit.

8. Programet e përgjithshme të lëndëve *teorike-artistike.*

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Histori muzike**
Klasa: **X**
Sistemi: Arsimi i mesëm i lartë
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

- ✓ **Teori muzikore 68 orë**
- ✓ **Literatura muzikore 34 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Histori muzike", nxënësi:

- analizon lindjen dhe zhvillimin e *muzikës paraklasike*, *klasike* dhe përfaqësuesit e tyre;
- shpjegon *karakteristikat* e *artit klasik* nëpërmjet njohjes së veprave muzikore;
- shpjegon lindjen dhe *reformat* në *opera*, si dhe përfaqësuesit e saj;
- kultivon shijet artistike nëpërmjet literaturës muzikore sipas veprave në periudha të caktuara muzikore;
- dallon *stilet muzikore* dhe *llojet e veprave muzikore* sipas epokave dhe përfaqësuesve;
- analizon veçoritë e periudhës, kompozitorët dhe veprat kryesore të periudhave historike - muzikore duke përcaktuar saktë *tiparet e përgjithshme* dhe të *veçanta* të zhvillimit të muzikës në Mesjetë, Rilindje, paraklasikët dhe klasikët;
- vlerëson *tiparet e veçanta* të kompozitorëve dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik;
- njeh periudhën e Romantizmit dhe përfaqësuesit e saj;
- shpjegon karakteristikat e artit romantik nëpërmjet njohjes së veprave muzikore;
- përdor një terminologji të saktë muzikore, duke krijuar një fjalor të pasur artistik.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Histori muzike"**

Tematika	Temat mësimore	Orët
Muzika në Antikitet	***Origjina e muzikës*** dhe kultura muzikore në popujt e lashtë në: ➢ *Lindjen e Mesme dhe të Largët;* ➢ *Greqinë dhe Romën e vjetër.*	**4 orë**
Muzika në Mesjetë	Kultura muzikore në periudhën e ***Mesjetës.*** Muzika ***kishtare mesjetare.*** ***Korali Gregorian.*** ***Muzika Bizantine***	**6 orë**
Muzika në Rilindje	***Rilindja*** dhe kushtet historike, sociale e kulturore të kësaj periudhe: - Arritja më e rëndësishme e artit muzikor të Rilindjes ***Opera***. - Opera në Itali.	**2 orë**

	⟩ Opera në Francë. ⟩ Opera në Angli. ⟩ Opera në Gjermani.	
Muzika instrumentale	Muzika instrumentale në shekullin XVII. Muzika për organo, klaviçembalo.	**2 orë**
	Muzika instrumentale ⟩ Muzika për violinë. ⟩ Ansambli instrumental.	**2 orë**
Përfaqësuesit e muzikës instrumentale	***Vivaldi – Koreli*** ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tyre. ⟩ Karakteristikat e krijimtarisë së tyre.	**6 orë**
Muzika paraklasike	Përfaqësuesit më të mëdhenj të ***stilit polifonik.*** ***J. S. Bach*** ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. ⟩ Karakteristikat e krijimtarisë së tij. ⟩ Veprat vokale, orkestrale dhe instrumentale.	**6 orë**
	Hendel ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. ⟩ Karakteristikat e krijimtarisë së tij.	**4 orë**
Muzika vokale	***Zhvillimi i mëtejshëm i muzikës vokale.*** ⟩ Opera Bufa dhe seria italiane. ⟩ Opera balet në Francë.	**4 orë**
Reforma në opera	⟩ Reforma në opera - ***K.V. Gluk***	**2 orë**
Muzika në klasicizëm	⟩ Klasicizmi vjenez. ***F. J. Hajden*** ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. ⟩ Krijimtaria simfonike. ⟩ Përgatitja dhe lindja e sonatës dhe simfonisë klasike.	**4 orë**
	V. A. Moxart ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. ⟩ Karakteristikat dhe risitë e tij në *opera.* ⟩ Karakteristikat dhe risitë e tij në muzikën instrumentale dhe simfonike.	**6 orë**
	L. V. Bethoven ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. ⟩ Novatorizmi në gjinitë e kultivuara prej tij, si: - *sonata;* - *Simfonia;* - *uvertura* etj.	**8 orë**
Muzika në romantizëm **Përfaqësuesit**	Kultura muzikoren gjysmën e parë të shekullit XIX. Romantizmi dhe veçoritë e tij.	**2 orë**
	K.M.Veber. ⟩ Opera romantike gjermane	**2 orë**
	F.Shubert. ⟩ Roli i tij në muzikën romantike, veçoritë e	**4 orë**

	krijimtarisë	
	F.Shopen. ⟩ Aktiviteti artistik. ⟩ Drejtimet e krijimtarisë dhe veçoritë e saj.	**4 orë**
Literatura	***Në çdo javë 1 orë është literature muzikore,dëgjim i veprave më të rëndësishme të autorëve të cilët do të studiohen.*** **Literatura e sugjeruar** ➢ Muzika kishtare mesjetare. ➢ Vivaldi – Koreli ➢ Bach ➢ Hendel ➢ K. V. Gluk ➢ F. J. Hajden ➢ V. A. Moxart ➢ L.V. Bethoven Shubert Shopen Shuman	**34 orë**

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Histori muzike**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**
-Teori muzikore 68 orë
- Literatura muzikore 34 orë

1.Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të mësimit të lëndës "Histori muzike", nxënësi:

- njeh karakteristikat e artit romantik, verizmit dhe muzikën neoklasike nëpërmjet njohjes së veprave muzikore;
- shpjegon lindjen dhe zhvillimin e operas;
- kultivon shijet artistike nëpërmjet literaturës muzikore;
- vlerëson dhe të mbajë qëndrim ndaj veprave muzikore të kësaj periudhe;
- dallon *stilet muzikore* dhe *llojet e veprave muzikore* sipas epokave dhe përfaqësuesve;
- vlerëson *tiparet e veçanta* të kompozitorëve dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik;
- analizon veçoritë e periudhës, kompozitorët dhe veprat kryesore të periudhave historike – muzikore, duke përcaktuar saktë *tiparet e përgjithshme* dhe të *veçanta* të zhvillimit të muzikës;
- përdor një terminologji të saktë muzikore, duke krijuar një fjalor të pasur artistik.

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Histori muzike", klasa XI /XII (102 orë)**

Tematika	Temat mësimore	Orët
Muzika vokale dhe instrumentale në Romantizëm	***F. Mendelson*** - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. Karakteristikat e krijimtarisë së tij.	**2 orë**
	V.Belini, Xh. Rosini, Donixeti - Përfaqësues të operas italiane.	**4 orë**
	N.Paganini - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Novatorizmi ne instrumentin e violinës, veprat.	**2 orë**
	Programatika, një ndër tiparet e muzikës romantike të shek. XIX. ***Hektor Berlioz*** - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Karakteristikat e krijimtarisë së tij.	**2 orë**
	Franc List - Tiparet novatore në krijimtarinë e tij. - Përfaqësues i Shkollës Nacionale Hungareze.	**4 orë**
	J. Brams - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Karakteristikat e krijimtarisë së tij.	**2 orë**

Muzika vokale dhe instrumentale në Romantizëm **Tema 11** **Tema 12** **Tema 13**	***Opera italiane*** në gjysmën e dytë të shekullit XIX. ***Xh. Verdi*** - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Veprat kryesore të tij.	**4 orë**
	Sh. Guno dhe ***Zh. Bize*** - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tyre. - Veprat kryesore të tyre.	**4 orë**
	R. Vagner - Reforma në muzikën operistike. - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Veprat kryesore të tij.	**4 orë**
	E. Grig - Përfaqësues i shkollës norvegjeze. - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Veprat kryesore të tij.	**4 orë**
	B. Smetana dhe ***A. Dvorzhak*** - Shkolla Nacionale. - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tyre. - Veprat kryesore të tyre.	**4 orë**
	Vëllezërit ***Anton*** e ***Nikollai Rubinshtain*** - Krijimi i Shkollës Nacionale Ruse në shekullin XIX. - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tyre. - Veprat kryesore të tyre.	**2 orë**
	M. Glinka - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Veprat kryesore të tij.	**2 orë**
	Grupi i të pestëve - Zhvillimi i mëtejshëm i muzikës ruse në gjysmën e dytë të shekullit XIX.	**2 orë**
	Musorgski, Borodin, Korsakov, Alexandr Skriabin - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tyre. - Veprat kryesore të tyre.	**8 orë**
	P. Çajkovski - Jeta, krijmtaria simfonike, baletet, operat, muzika instrumentale.	**4 orë**
Verizmi	***Opera italiane*** në fund të shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX. - Verizmi, karakteristikat e rrymës dhe përfaqësuesit e saj. ***Xh. Pucini*** - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. Operat kryesore të tij.	**6 orë**
Muzika finlandeze	***Jan Sibelius*** - Muzika finlandeze në gjysmën e parë të shekullit XX. - Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij. - Veprat kryesore të tij.	**2 orë**
Muzika	***B. Bartok***	

hungareze	) Kompozitorë të shquar hungarezë në gjysmën e parë të shekullit XX.) Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij.) Veprat kryesore të tij.	**2 orë**
Neoklasicizmi në muzikë	***Igor Stravinski***) Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së tij.) Veprat kryesore të tij.	**4 orë**
Literatura	**Literatura e sugjeruar** Në përfundim të dëgjimit të literaturës muzikore nxënësi/ja duhet të dëgjojë veprat kryesore të përfaqësuesve të periudhave të marra në studim:) ***Hektor Berlioz***) ***Franc List***) ***J. Brams***) ***Sh.Guno*** dhe ***Zh.Bize***) ***R. Vagner***) ***E. Grig***) ***B. Smetana*** dhe ***A. Dvorzhak***) ***Anton*** e ***Nikollai Rubinshtain.***) ***M. Glinka***) ***Musorgski, Borodin, Korsakov, Aleksandër Skriabin.***) ***Xh. Pucini***) ***Igor Stravinski***) ***B. Bartok***) ***Jan Sibelius***	**34 orë**
Gjithsej:		**102 orë**

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Histori muzike**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**
Teori muzikore 68 orë
Literatura muzikore 34 orë

1.Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të mësimit të lëndës "Histori muzike", nxënësi:

- ✓ njeh lindjen dhe zhvillimin e muzikës shqiptare, karakteristikat dhe përfaqësuesit kryesorë të saj;
- ✓ Shpjegon lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit, simfonisë dhe gjinive të tjera instrumentale muzikore nga krijimtaria e kompozitorëve shqiptarë;
- ✓ vlerëson dhe mban qëndrim krahasues ndaj veprave muzikore që ai/ajo dëgjon;
- ✓ kultivon shijet artistike nëpërmjet literaturës muzikore;
- ✓ dallon *stilet muzikore* dhe *llojet e veprave muzikore* sipas epokave dhe përfaqësuesve shqiptarë dhe të huaj;
- ✓ vlerëson *tiparet e veçanta* të kompozitorëve shqiptarë dhe të huaj dhe të stileve që ata kanë përdorur, duke krijuar një qëndrim artistik;
- ✓ analizon veçoritë e periudhës, kompozitorët dhe veprat kryesore të tyre;
- ✓ përdor një terminologji të saktë muzikore, duke krijuar një fjalor të pasur artistik.

2. Përmbajtjet tematike së lëndës "Histori muzike"

	Temat mësimore	**Orët**
Tema 1	***Kultura muzikore shqiptare*** në periudhën e: ⟩ Mesjetës, ⟩ Rilindjes.	**2 orë**
Tema 2	***Kultura muzikore shqiptare***: ⟩ Në periudhën e Pavarësisë. ⟩ Kënga Himn (partizane).	**2 orë**
Tema 3	***Kënga*** dhe ***romanca shqiptare***	**4 orë**
Tema 4	***Gjinitë e mëdha të muzikës vokale shqiptare:*** ⟩ opera e parë shqiptare "Mrika"; ⟩ "Lulja e Kujtimit"; ⟩ "Skënderbeu" .	**7 orë**
Tema 5	***Muzika e baleteve shqiptare:*** ⟩ baleti i parë shqiptar - "Halili dhe Hajria"; ⟩ baletet "Delina"; ⟩ "Cuca e maleve".	**5 orë**
Tema 6	***Muzika instrumentale shqiptare -*** zhvillimi dhe karakteristikat e përgjithshme të saj. ⟩ Miniatura. ⟩ Balada. ⟩ Sonata.	**8 orë**

	⟩ Muzika e dhomës. ⟩ Koncertet instrumentale.	
Tema 7	***Muzika simfonike shqiptare:*** ⟩ Rapsoditë. ⟩ Uvertura. ⟩ Suita. ⟩ Vallja simfonike.	**6 orë**
Tema 8	***Poemi simfonik .Simfonitë shqiptare.***	**4 orë**
Tema 9	***Muzika e filmit*** ⟩ Përfaqësuesit e saj	**2 orë**
Tema 10	***Muzika kosovare*** ⟩ Jeta dhe drejtimet kryesore të krijimtarisë së autorëve kosovarë. ⟩ Veprat kryesore të tyre.	**2 orë**
Tema 11	***Kultura muzikore angleze në fund të shek. XX.*** ⟩ Benjamin Britten	**2 orë**
Tema 12	***Kultura muzikore në Austri në fund të shek. XX.*** ⟩ Gustav Maler	**2 orë**
Tema 13	***Impresionizmi në Austri në shek. XX.*** ⟩ Alban Berg ⟩ Arnold Schoneberg (Shenberg)	**3 orë**
Tema	***Kultura muzikore gjermane në fillim të shek. XX*** ⟩ Richard Shtraus ⟩ Paul Hindmith	**4 orë**
Tema	***Kultura muzikore ruse në shek. XX*** ⟩ Sergei Rakhmaninov ⟩ Dimitri Sciostakoviç ⟩ Sergei Prokofiev	**5 orë**
Tema	***Kultura muzikore amerikane në shek. XX*** ⟩ George Gershvin	**5 orë**
Tema	***Kultura muzikore franceze*** ⟩ Maurice Ravel ⟩ Camille Saint-Saens ⟩ Claude Debussy	**5 orë**
Literatura	**Literatura e sugjeruar** Në përfundim të dëgjimit të literaturës muzikore nxënësi/ja duhet të dëgjojë veprat kryesore të përfaqësuesve të periudhave të marra në studim: ✓ *himni "Të deum" – Niket Dardani;* ✓ kënga himn (partizane); ✓ këngë dhe romanca shqiptare; ✓ opera "Mrika" ; ✓ opera "Lulja e Kujtimit" ; ✓ opera "Skënderbeu"; ✓ baleti "Halili dhe Hajria" ; ✓ baleti "Delina"; ✓ baleti "Cuca e maleve"; ✓ miniatura – kompozitorë shqiptarë;	**34 orë** **33 orë**

	✓ balada – kompozitorë shqiptarë; ✓ sonata – kompozitorë shqiptarë; ✓ muzika e dhomës – kompozitorë shqiptarë; ✓ koncertet instrumentale – kompozitorë shqiptarë; ✓ simfonia e parë shqiptare; ✓ rapsodi – kompozitorë shqiptarë; ✓ uvertura – kompozitorë shqiptarë; ✓ suita – kompozitorë shqiptarë; ✓ vallja simfonike – kompozitorë shqiptarë; ✓ muzika e filmit; ✓ muzika kosovare ; ✓ Benjamin Britten; ✓ Gustav Maler; ✓ Alban Berg ; ✓ Arnold Schoneberg (Shenberg); ✓ Sergei Rakhmaninov ; ✓ Dimitri Shiostakoviç ; ✓ Serghei Prokofiev; ✓ Richard Shtraus ; ✓ Paul Hindmith; ✓ George Gershvin; ✓ Maurice Ravel ; ✓ Camille Saint-Saens ; ✓ Claude Debussy.	

3. VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- dallon *shumë mirë* muzikën që studion sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- përcakton *saktë* karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;
- shpjegon *qartë dhe natyrshëm* lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe të gjinive të tjera instrumentale;
- shpreh *qartë dhe natyrshëm* shijet artistike nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore;
- vlerëson duke mbajtur një qëndrim *të drejtë* ndaj veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- ✓ dallon *mirë* muzikën sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- ✓ përcakton karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;
- ✓ shpjegon lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe gjinive të tjera instrumentale;
- ✓ shpreh shijet artistike nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore;
- ✓ vlerëson duke mbajtur një qëndrim ndaj veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- arrin të flasë për muzikën sipas periudhave historike muzikore dhe përfaqësuesit e saj;
- arrin të përcaktojë, me ndihmën e mësuesit, karakteristikat e veprave muzikore sipas periudhave historike muzikore;

- përshkruan, me ndihmën e mësuesit, lindjen dhe zhvillimin e operës, baletit dhe gjinive të tjera instrumentale sipas periudhave historike muzikore;
- flet për veprat muzikore nëpërmjet dëgjimit të literaturës muzikore.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Folklor muzikor**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Folklor muzikor", nxënësi:

- ✓ lexon *ritmet e përziera* folklorike;
- ✓ njeh elementët ritmikë që karakterizojnë folklorin tonë muzikor ;
- ✓ dallon instrumentet popullore muzikore, ndërtimin e tyre dhe krahinën së cilës i përkasin;
- ✓ analizon zhvillimin e folklorit muzikor në tërësinë e tij në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse sipas trevave;
- ✓ luan në instrumentat tonë popullorë sipas veçorive që ata kanë;
- ✓ shpjegon elemntët lirikë të folklorit tonë muzikor ;
- ✓ ekzkeuton me melodi dhe instrument strukturën e melodikës tonë popullore;
- ✓ shpjegon elementët përbëres të saj .

2.Përmbajtje tematike e lëndës "Folklori muzikor".

Tematika	**Tema mësimore**	**Orët**
Ritmika jonë popullore	Folklori ynë muzikor. Mjetet shprehëse të muzikës , *ritmika.*	**2 orë**
	Ritmet e përziera: -masat e përziera 5 pjestuese; -masat e përziera 7 pjestuese; -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4orë**
	-masat e përziera 8 pjestuese; -masat e përziera 9 pjestuese; -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4 orë**
	-masat e përziera 10 pjestuese. -masat e përziera 11 pjestuese. -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4 orë**
	-masat e përziera 12 pjestuese; -masat e përziera 14 pjestuese; -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4 orë**
	-masat e përziera 16 pjestuese dhe masat me përmasa të mëdha ; -masat e çrregullta dhe ritmet e lira ; -apologjia e muzikës tonë popullore; -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4 orë**
Organografia popullore	Organografia: -veglat muzikore të popullit tonë ; -klasifikimi i tyre .	**2 orë**

	Mjetet trupore të kumbimit. Veglat Idiofone.	**4 orë**
	Veglat membranofone	**4 orë**
	Veglat aerofone: -mjetet paramuzikore; -veglat e mirfillta: *Fyelli, bicula, zurmaja dhe curleja.*	**4 orë**
	Veglat kordofone: -mjetet paramuzikore; -familja e tamburave; -çiftelia , bakllamaja, sharkija dhe sazeja .	**2 orë**
	Veglat kordofone me hark: -lahuta dhe lauria.	**2 orë**
Lirika popullore	Lirika popullore : -këngët e djepit; -këngët e punës; -këngët e dasmës; -shembuj muzikore nga folklori popullor	**4 orë**
Këngët e kurbetit, epikës dhe baladat	-Këngët e kurbetit . -Këngët e epikës legjendare -Cikli i kreshnikëve. -Shembuj muzikore nga folklori popullor	**4 orë**
	Baladat: -balada e besës dhe e rinjohjes; -këngët e epikës historike; -shembuj muzikore nga folklori popullor.	**4 orë**
Pavarësia	Këngët e rilindjes kombëtare, periudha e pavarësisë .	**2 orë**

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Folklor muzikor**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Folklor muzikor", nxënësi:

- ✓ kupton *modet* dhe *jonet, shkallët* që përbëjnë folklorin tonë muzikor;
- ✓ ekzekuton me zë dhe instrument *mënyrat e modulimit* në muzikën instrumentale dhe vokale që përbëjnë folklorin tonë muzikor;
- ✓ gjen shembuj nga folklori të *ritmeve, modeve apo shkallëve* të ndryshme, duke shpjeguar ndërtimin e tyre;
- ✓ shpjegon karakteristikat dhe vlerat e muzikës *homofonike* dhe *polifonike* dhe vendin që zë ajo në muzikën tonë popullore folklorike;
- ✓ argumenton shembuj konkretë të folklorit muzikor nga treva të ndryshme.

2. Përmbajtje tematike e lëndës "Folklori muzikor".

Tematika	Tema mësimore	Orët
Melodika e muzikës tonë popullore **Jonet dhe modet**	Melodika e muzikës tonë popullore dhe elementët përbëres të saj.	**2 orë**
	Shtirja e joneve të muzikës tonë popullore: ✓ jonet bikortale; ✓ jonet trikordale; ✓ tetrakordale ; ✓ pentakordale;	**6 orë**
	✓ jonet hegzakordale. ✓ strukturat tonalo-modale;	**4 orë**
	✓ shkallët tetratonike; ✓ shkallët pentatonike;	**5 orë**
	✓ shkallët hegzatonike; ✓ modet e lashta diatonike;	**5 orë**
	✓ modi jonian; ✓ modi dorian ;	**4 orë**
	✓ modi frigjan ; ✓ modi lidian ;	**4 orë**
	✓ modi miksolidian ; ✓ modi euljan ;	**4 orë**
	✓ modi lokrian; ✓ shkalla kromatike tërthori i dytë.	**4 orë**

Perdet e muzikës popullore	Perdet e ahengut qytetar (muzikës popullore) Perdet: - *dyqah;* - *zir;* - *gjyse.*	**6 orë**
	Perdet: - *raas ;* - *sergjah ;* - *huzam .*	**4 orë**
	Perdet: - nervish ; - divan ; - sabahi.	**4 orë**
	Perdet: - leva ; - nihaved; - divan.	**4 orë**
Modulacionet në muzikën tonë popullore dhe polifonia	Modulacionet në muzikën tonë popullore. Vështrim i përgjithshëm rreth drejtshkrimit dhe transkiptimit të muzikës sonë popullore.	**4 orë**
	Veshtrim i pergjithshëm rreth polifonisë sonë popullore .	**6 orë**
	Përsëritje e lëndës	**2 orë**

3.VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- gjen *saktë* në shembujt e ndryshëm muzikorë: *ritmet (5,6,7,8,9,10,11,12,13,16 pjesëtuese), si* dhe të *krahinën* së cilës i përkasin;
- analizon *qartë dhe saktë* zhvillimin e folklorit muzikor në tërësinë e tij në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si:
  - *instrumentet,*
  - *mënyrat e të kënduarit sipas zonave,*
  - *modet dhe jonet,*
  - *shkallët dhe modulacionet* që përbëjnë folklorin tonë muzikor;
- gjen në mënyrë të *saktë* shembuj muzikorë folklorikë përmes ritmeve, melodive, modeve apo shkallëve të ndryshme, duke shpjeguar *qartë* rrugët e krijimit;
- zhvillon aftësi të *sakta,* duke rritur interesin në dëgjimin e muzikës folklorike, si dhe duke shpjeguar *saktë* tiparet e këngëve dhe të instrumenteve folklorike etj.;
- trajton *saktë* vlerat e muzikës polifonike;
- jep shpjegime të *sakta*, duke sjellë shembuj konkretë të folklorit muzikor nga treva të ndryshme.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- gjen te shembujt muzikorë e folklorikë: - *ritmet (5,6,7,8,9,10,11,12,13,16 pjesëtuese)*.
- analizon zhvillimin e folklorit muzikor në tërësinë e tij në periudha të ndryshme, duke nxjerrë veçoritë përkatëse, si:

- *instrumentet,*
- *mënyrat e të këndduarit sipas zonave,*
- *modet dhe jonet,*
- *shkallët dhe modulacionet* që përbëjnë folklorin tonë muzikor;

- gjen shembuj muzikorë folklorikë përmes ritmeve, melodive, modeve apo shkallëve të ndryshme, duke shpjeguar *mirë* rrugët e krijimit;
- zhvillon aftësitë duke rritur interesin në dëgjimin e muzikës folklorike, si dhe duke shpjeguar tiparet e këngëve, instrumenteve folklorike etj.;
- trajton *shpesh* vlerat e muzikës polifonike;
- jep shpjegime, duke sjellë shembuj konkretë të folklorit muzikor nga treva të ndryshme.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- gjen *ndonjëherë* në shembujt muzikorë e folklorikë:- *ritmet (5,6,7,8,9,10,11,12,13,16 pjesëtuese)*;
- analizon *rrallë* zhvillimin e folklorit muzikor në tërësinë e tij në periudha të ndryshme, duke nxjerrë disa nga veçoritë përkatëse, si:
  - *instrumentet;*
  - *mënyrat e të këndduarit sipas zonave;*
  - *modet dhe jonet;*
  - *shkallët dhe modulacionet* që përbëjnë folklorin tonë muzikor;
- gjen *rrallëherë* shembuj muzikorë folklorikë përmes ritmeve, melodive, modeve apo shkallëve të ndryshme, duke shpjeguar *mirë* rrugët e krijimit;
- zhvillon aftësitë për të rritur interesin në dëgjimin e muzikës folklorike, si dhe duke shpjeguar tiparet e këngëve, instrumenteve folklorike etj.;
- trajton *rrallëherë* vlerat e muzikës polifonike;
- jep *rrallëherë* shpjegime, duke sjellë shembuj konkretë të folklorit muzikor nga treva të ndryshme.

9. Programet e lëndëve *teorike-praktike-artistike.*

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Harmoni**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të lëndës " Harmoni", nxënësi:

- ✓ përvetëson *elementet teorike* dhe praktike për këtë grupmoshë (vit shkollor);
- ✓ zhvillon shprehitë intelektuale dhe gjykuese mbi ushtrimet e temat dhe të analizojë drejt veprat muzikore në planin harmonik;
- ✓ harmonizon një melodi ose një bas të dhënë;
- ✓ luan në piano një skemë të dhënë;
- ✓ kryen një analizë harmonike të fragmenteve të veprave muzikore nga krijimtaria botërore dhe ajo shqiptare.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Harmoni"

Nr	Orë teorike	Temat mësimore	Orë praktike
1	2 orë	ZHarmonia si mjet i rëndësishëm shprehës dhe shkenca e harmonisë. ZKuintakordi kryesor dhe vendosja e tij në formacionin koral 4-zanor. ZVendosja e ngushtë dhe e gjerë.	1 orë
2	4 orë	ZSpostimi i kuintakordit.	2 orë
3	4 orë	ZLidhja e kuintakordeve kryesore. ZLidhja harmonike. ZLidhja melodike.	2 orë
4	2 orë	ZTonaliteti dhe funksionet. ZTri funksionet kryesore/tonika. ZSubdominanta. ZDominanta dhe logjika e zhvillimit harmonik.	1 orë
5	6 orë	ZHarmonizimi i melodisë. ZPërdorimi i tri funksioneve kryesore.	3 orë
6	2 orë	ZKapërcimi i tercave.	1 orë
7	6 orë	ZHarmonizimi i basit.	3 orë
8	4 orë	ZKadencat. ZKuartseksakordi i kadencës.	2 orë
9	6 orë	ZSekstakordet e funksioneve kryesore.	3 orë
10	4 orë	ZKuartseksakordet kalues dhe ndihmës.	2 orë
11	6 orë	ZSeptakordi i dominantës dhe përmbysjet e tij.	3 orë
12	4 orë	ZSistemi i plotë funksional i tonalitetit maxhor dhe minor	2 orë

		(harmonik). Z Kuintakordi dhe seksakordi i gradit të dytë.	
13	6 orë	Z Septakordi i gradit të dytë dhe përmbysjet e tij.	3 orë
14	4 orë	Z Kuintakordi i gradit të gjashtë. Z Kadenca e ndërprerë.	2 orë
15	4 orë	Z Kuintakordi i gradit të tretë.	2 orë
16	**4 orë**	Z Kuintakordi dhe sekstakordi i gradit të shtatë.	2 orë

Shënim. Temat teorike bëhet në 2 orë mësimore teorike. Në orët praktike mësimore korrigjohen detyrat e dhëna, të cilat përmbajnë ushtrime, skema harmonike në piano dhe analiza nga vepra muzikore.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Të gjitha**
Lënda: **Harmoni**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të lëndës " Harmoni", nxënësi:

- përvetëson *elementet teorike* dhe praktike për këtë grupmoshë (vit shkollor);
- zhvillon shprehitë intelektuale dhe gjykuese mbi ushtrimet e temat dhe të analizojë drejt veprat muzikore në planin harmonik;
- harmonizon një melodi ose një bas të dhënë;
- luan në piano një skemë të dhënë;
- kryen një analizë harmonike nga fragmente të veprave muzikore nga krijimtaria botërore dhe ajo shqiptare.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Harmoni"

Nr	Orë teorike	Temat mësimore	Orë praktike
1	6 orë	Septakordi i gradit të shtatë dhe përmbysjet e tij.	3 orë
2	2 orë	Nonakordi i dominantes.	1 orë
3	2 orë	Dominanta me sekstë.	1 orë
4	4 orë	Tonaliteti minor natyral, kthesa frigjane.	2 orë
5	4 orë	Sekuenca tonale diatonike.	2 orë
6	10 orë	Tingujt joakordikë kalues, ndihmës, përshpejtues dhe vonues. Tipat e marrëdhënieve tonale - sistemi kromatik.	5 orë
7	6 orë	Shmangiet dhe mënyra e realizimit të tyre.	3 orë
8	6 orë	Dubëldominanta në kadencë dhe në brendësi të ndërtimit muzikor.	3 orë
9	4 orë	Sekuencat kromatike. Mënyra e realizimit të tyre.	2 orë
10	10 orë	Modulacioni dhe llojet e tij. Modulacioni në tonalitetet e afërta të grupit subdominant (S). Modulacioni në tonalitetet e afërta të grupit dominant (D).	5 orë
11	14 orë	Veçoritë e harmonizimit në modet e muzikës popullore shqiptare. Modet: dorian; frigjan; lidian; eolian;	7 orë

		||| jonik; |||miksolidian; ||modet me sekondë të zmadhuar (kromatikë).	
Gj.	**68 orë**		**34 orë**
Shënim. Temat teorike bëhet në 2 orë mësimore teorike. Në orët praktike mësimore korrigjohen detyrat e dhëna, të cilat përmbajnë ushtrime, skema harmonike në piano dhe analiza nga vepra muzikore.			

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat me të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teoriko-praktike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e mësuesit në aspektin teorik dhe atë praktik me çdo nxënës duhet të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit mësuesi/ja mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, gjithmonë duke iu përmbajtur atij.

Ushtrimet, skemat dhe analizat harmonike duhet t'i përgjigjen nivelit që kërkon grupmosha dhe niveli i shkollimit, po ashtu edhe programi artistik. Për këtë arsye, bëhet zbërthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe miratohet nga drejtuesi specialist i shkollës.

Një kërkesë tjetër në funksion të drejtpërdrejtë të rritjes së nivelit formues të nxënësve është dhe kërkesa nga ana e mësuesit si një kriter bazë për nxënësin për pajisje me bazën e plotë materiale, si: libër, fletore, laps dhe gomë.

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

1. zgjidhjen e saktë të detyrave që jepen për çdo temë mësimore, të cilat janë:
- harmonizime basi dhe melodie,
- zgjidhje skemash harmonike që duhet të luhen dhe në piano,
- analizë harmonike nga vepra të ndryshme muzikore nga autorë të ndryshëm të huaj dhe shqiptarë;
2. çdo fund semestri bëhet një testim me një përmbledhje të temave që janë shpjeguar gjatë vitit mësimor.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Instrumentistë harqesh: violinë, violë, violonçel, kontrabas**
Lënda: **Analizë muzikore e veprave**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

1.Rezultatet e pritshme:

Në përfundim të lëndës "Analizë muzikore e veprave", nxënësi:

- ✓ njeh ndërtimin e formave të thjeshta muzikore;
- ✓ kupton parimet e zhvillimit të mendimit muzikor;
- ✓ analizon formën dhe ndërtimin muzikor, etapat që kalon mendimi muzikor në rrugën e tij të zhvillimit e të konkretizimit artistik;
- ✓ analizon ndërtimin e formave të thjeshta muzikore;
- ✓ njeh elementet kryesore të muzikës dhe ndërthurjen artistike të tyre në krijimin e një forme muzikore;
- ✓ kupton funksionet e pjesëve të një ndërtimi muzikor;
- ✓ analizon funksionet e pjesëve të një ndërtimi muzikor, duke shpjeguar vendin që zë secila prej tyre në vepër;
- ✓ analizon ndërtimin e një periudhe muzikore si 2- e 3-pjesëshi, apo dhe ndërtime të tjera që formohen me bashkimin dhe zhvillimin e këtyre formave.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Analizë muzikore e veprave"

Tema mësimore	Përmbajtja e temave mësimore	Orët
Tema 1	) Objekti i lëndës: - Arti muzikor dhe specifika e tij. - Konceptet *formë muzikore, stil, gjini.*	2 orë
Tema 2	) Elementet kryesore të muzikës: - *melodia,* - *harmonia,* - *ritmi.*	4 orë
Tema 3	) Funksionet e pjesëve në formën muzikore: - *hyrja,* - *tema,* - *pjesa lidhëse,* - *pjesa e mesit,* - *repriza,* - *koda.*	2 orë
Tema 4	) Periudha: - *fjalia,* - *motivi,* - *fraza.*) Llojet e ndryshme të periudhave.) Periudha si formë më vete.	8 orë
Tema 5	) Forma dypjesëshe e thjeshtë.	

	) Midisi.	10 orë
Tema 6	) Forma tripjesëshe e thjeshtë.) Llojet e midisit.	10 orë
Tema 7	) Forma tripjesëshe e përbërë.) Llojet e tripjesëshit të përbërë.) Midisi episod dhe trio.	12 orë
Tema 8	) Tema me variacione.) Variacionet zbukuruese.) Variacionet e tjera.	12 orë
Tema 9	) Format muzikore në gjinitë vokale, si: - Kënga solo. - Kënga korale. etj.	8 orë

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për zbatimin e këtij programi është shumë i rëndësishëm gërshetimi i teorisë me praktikën, që do të thotë se çdo mësues duhet të ketë materiale muzikore në klasë dhe t'i analizojë ato hap pas hapi. Më pas mësuesi jep detyrë për orën e praktikës. Gjithashtu, duhet përcaktuar qartë metoda e zbërthimit dhe e analizës së një vepre muzikore.

Literaturë rekomanduese rreth materialeve që do të analizojnë nxënësit:

- ✓ periudha të ndryshme si forma më vete;
- ✓ periudha të ndryshme si forma të shkëputura nga ndërtime më të mëdha;
- ✓ Bach: Minuete dy e tripjesëshe
- ✓ T. Harapi: Vals, si "Një dhimbje e vogël", "Ja gëzimi kthen" etj.
- ✓ P. Çajkovski: "Album për fëmijë".
- ✓ pema kryesore të sonatave që luajnë vetë nxënësit.
- ✓ materiale të propozuara nga vetë nxënësit.

4. VLERËSIMI

Nxënësi do të vlerësohet për:

-) analizën e ndërtimit të formave muzikore;
-) analizën konkrete në orën e praktikës;
-) kontrollin e dijeve në orën e leksionit me anë të testimeve me shkrim e gojë;
-) orën e praktikës që shoqëron çdo temë të re në lëndën e analizës, që e bën të lehtë njohjen e nivelit të përgatitjeve të çdo nxënësi.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Instrumentistë harqesh: violinë, violë, violonçel, kontrabas**
Lënda: **Analizë muzikore e veprave**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 2 orë/javë = 68 orë

1.Rezultatet e pritshme:
Në përfundim të lëndës "Analizë muzikore e veprave", nxënësi:

- analizon ndërtimin e formave të thjeshta dhe të përbëra muzikore;
- analizon format e sonatës, rondo-sonatës, kohës së parë të koncertit etj;
- analizon pjesët përbërëse të formës së sonatës, si: *hyrja, ekspozicioni, përpunimi, repriza, koda;*
- analizon veprat e rëndësishme që luan, si: sonata, koncerti, suita etj.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Analizë muzikore e veprave"

Tema mësimore	**Përmbajtja e temave mësimore**	**Orët**
Tema 1	⎫ Forma e sonatës dhe zhvillimi historik i saj. ⎫ Sonata klasike. ⎫ Llojshmëria dhe ndërtimi.	10 orë
Tema 2	⎫ Pjesët përbërëse të sonatës: - *hyrja,* - *ekspozicioni,* - *përpunimi,* - *repriza,* - *koda.*	10 orë
Tema 3	⎫ Llojet e ndryshme të sonatës. ⎫ Përpunimi - fazë e rëndësishme e zhvillimit të mjeteve shprehëse.	8 orë
Tema 4	⎫ Sonata pa përpunim. ⎫ Sonata me episod në vend të përpunimit.	6 orë
Tema 5	⎫ Format klasike. ⎫ Suita e vjetër. ⎫ Suita e re.	8 orë
Tema 6	⎫ Cikli sonato – sinfonike: - Sonata, - Simfonia, - koha e parë e koncertit, - muzika e dhomës.	8 orë
Tema 7	⎫ Format e lira njëkohëshe: - fantazia; - balada; - rapsodia; - poema sinfonike.	4 orë
Tema 8	⎫ Format muzikore në gjinitë e mëdha vokale dhe muzikore skenike.	4 orë

Tema 9	) Njohuri të përgjithshme mbi operën dhe dramaturgjinë e saj.	4 orë
Tema 10	) Format vokale në opera: - Aria, - Recitativi, - Ansamblet, - Kori, - baleti.	6 orë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për zbatimin e këtij programi është shumë i rëndësishëm gërshetimi i teorisë me praktikën, që do të thotë se çdo mësues duhet të ketë materiale muzikore në klasë dhe t'i analizojë ato hap pas hapi. Më pas mësuesi jep detyrë për orën e praktikës. Gjithashtu, duhet përcaktuar qartë metoda e zbërthimit dhe e analizës së një vepre muzikore.

Literaturë rekomanduese rreth materialeve që do të analizojnë nxënësit:

- L. V. Bethoven: Sonata Nr. 1, koha e parë.
- L. V. Bethoven: Sonata patetike, koha e parë.
- Ç. Zadeja: Sonata Nr. 1 në La-, koha e parë.
- Bach: Suita.
- P. Jakova: Opera "Mrika".
- Sonata.
- Koncerte.
- Suita apo edhe vepra të tjera që luajnë vetë nxënësit.
- Materiale të propozuara nga vetë nxënësit.

4.VLERËSIMI

Nxënësit duhet të dinë të analizojnë ndërtimet e formave muzikore. Kjo është e rëndësishme në caktimin e sasisë dhe cilësisë së dijeve të tij përmes analizave konkrete të bëra në orën e praktikës, si dhe të kontrollit të dijeve në orën e leksionit me anë të testimeve me shkrim e me gojë.

Ora e praktikës, që shoqëron çdo temë të re në lëndën e analizës, e bën të lehtë njohjen e nivelit të përgatitjeve të çdo nxënësi.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violonçel, violë, vegla të frymës, kitarë**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- ndërton dhe intonohet në gradin V II_7 bashkë me përmbysjet duke bërë zgjidhjet përkatëse në T;
- ndërton dhe intonohet vertikalisht dhe horizontalisht skema harmonie në përdorimin e funksioneve T-5, D_7, II_7, VII_7 etj.;
- realizon diktime melodike dhe ritmike.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Tematika	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
Akordet	Përsëritje e përgjithshme e A_5 , A_6 , A_{65} , D_7 , D_{65} , D_{43} , D_2.	1 orë	3 orë	2 orë
Septakordet	Gradi II_7, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T.	1 orë	1 orë	2 orë
	Gradi II_{65}, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T.	1 orë	2 orë	1 orë
	Gradi II_{43}, ndërtimi, kalimi në D për t'u zgjidhur me T.	1 orë	2 orë	1 orë
	Gradi II_2 kalimi në D për t'u zgjidhur në T.	1 orë	1 orë	1 orë
	Septakordi i gradi të VII_7 ndërtimi dhe zgjidhje në T.	1 orë	1 orë	1 orë
	Gradi VII_{65} ndërtimi dhe zgjidhja në T.	1 orë	1 orë	1 orë
	Gradi VII_{43} ndërtimi dhe zgjidhja në T.	1 orë	1 orë	1 orë
	Gradi VII_2 ndërtimi dhe zgjidhja ne T_6.	1 orë	1 orë	1 orë
Përsëritje		1 orë	1 orë	1 orë
Gjithsej		10 orë	14 orë	12 orë
Shënim: Lënda do të zhvillohet në grupe deri në 15 nxënës.				

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

a. Rekomandime për perzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lëndën Teori solfezhi, klasa X:
   - Pozzoli nr. 2
   - Ushtrime melodike e ritmike
   - Lladuhin: 1000 diktate melodike 1-2 zëra
   - Pozzoli: diktate melodike
b. T'i jepet rëndësi aspektit melodik për edukimin e veshit muzikor përmes dëgjimit intonimit të akordeve përfshirë gradin II_7 dhe gradin VII_7
c. T'i jepet rëndësi intonimit të ushtrimeve melodike aprimavista
d. Të këmbëngulet me perceptimin e saktë intonativ për realizimin e diktimit melodik.

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- ✓ përvetësimin sa më të thellë e të qëndrueshem të koncepteve kryesore të njohurive teorike-praktike për cdo kapitull;
- ✓ nivelin e përvetësimit të ushtimeve melodike e ritmike;
- ✓ realizimin me cilësi të diktatit melodik.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë, korno, trombë, trombone, perkusion, fagot, kitare dhe kanto**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 5 orë/javë = 170 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- ✓ zbërthen dhe lexon rrjedhshem ushtrime ritmike me përdorimin e ritmeve të thjeshta;
- ✓ intonohet në tonalitetet + - në tre forma me 0 deri në 2 shenja;
- ✓ realizon diktatin melodik me një zë me tonalitetet;
- ✓ realizon diktatin ritmik në ritmet e thjeshta.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Nr	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
1	Ç'është muzika, ç'është pentagrami dhe çelësi i solit?	1 orë	-	-
2	Notat në vija dhe fusha sipër dhe poshtë pentagramit.	2 orë	4 orë	2 orë
3	Çelësi basit, notat në çelësin e basit.	1 orë	4 orë	2 orë
4	Koha 4/4. Nota e plotë dhe pushimi. Masa-përkufizimi teorik-praktik.	1 orë	1 orë	1 orë
5	Koha 2/4. Nota gjysëm dhe pushimi.	1 orë	1 orë	1 orë
6	Koha ¾.	1 orë	1 orë	1 orë
7	Koha ¼ dhe pushimi.	2 orë	2 orë	2 orë
8	Nota 1/8 dhe pushimi 1/8.	2 orë	2 orë	2 orë
9	Nota 1/16 dhe pushimi 1/16.	2 orë	2 orë	2 orë
10	Pika dhe lidhja e vlerës dhe lidhja e shpresës.	2 orë	2 orë	2 orë
11	Metri-masa.	1 orë	1 orë	-
12	Toni dhe ½ toni, shenjat e shartimit.	1 orë	4 orë	-
13	Çelësi i përbashkët e IB (do-së).	1 orë	4 orë	-
14	Shkalla Do+ në 3 forma, natyral, melodik, ritmik.	2 orë	2 orë	2 orë
15	Shkalla La- në 3 forma, natyral, melodik, ritmik.	2 orë	2 orë	2 orë
16	Shkalla Sol+ në 3 forma, natyral, melodik, ritmik.	1 orë	1 orë	2 orë
17	Shkalla Mi- në 3 forma, natyral, melodik, ritmik.	1 orë	1 orë	2 orë
18	Shkalla Fa+ dhe Re në 3 forma.	1 orë	2 orë	1 orë
19	Shkalla Re+ dhe Si me 3 forma.	1 orë	2 orë	1 orë
20	Shkalla Sib+ dhe Sol- në 3 forma.	1 orë	3 orë	1 orë
21	Shenjat e ngjyrimit.	1 orë	1 orë	1 orë
22	Shenjat dinamike.	1 orë	2 orë	-
23	Shenjat e shkurtimit.	1 orë	2 orë	2 orë
24	Intervalet e thjeshta, karakteristikat e tyre, prima.	2 orë	2 orë	2 orë
25	Intervali i sekonds në 4 lloje.	1 orë	2 orë	1 orë
26	Intervali i tercës në 4 lloje.	1 orë	2 orë	2 orë
27	Intervali kuartës, llojet e tij.	1 orë	2 orë	2 orë
28	Intervali kuintës.	1 orë	2 orë	2 orë
29	Intervali sekstës.	1 orë	2 orë	2 orë

30	Intervali octaves.	1 orë	1 orë	1 orë
31	Percaktimi i diktimeve.	1 orë	-	1 orë
32	Stakato, stakatisimo.	1 orë	-	-
33	Emrat e gradëve të shkallës dhe karakteristikat e tyre.	1 orë	-	-
34	Përgatitja teorike-praktike e lëndës.	2 orë	-	-
	Gjithsej	43+ 12 orë	59+12 orë	42+ 12 orë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

a) Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lëndën Teori solfezhi, klasa X:

- Pozzoli, ushtrime leximi dhe këndimi.
- Dema Ilirjana "Teoria dhe praktika e solfezhit ritmik".
- Lladuhin: 1000 diktate melodike 1-2 zëra.
- Pozzoli: diktate melodike.

b) Të këmbëngulet në formimin e shprehive të dëgjimit muzikor nëpërmjet dëgjimeve melodike të notave dhe intervaleve.

c) Të zhvillohen shprehitë e dëgjimit ritmik të 9 figurave bazë ritmike.

d) Të punohet hap pas hapi për realizimin e diktimit melodik deri 8 masa pa ndërprerje.

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- përvetësimin cilësor të 9 figurave bazë ritmike si dhe zbatimin e tyre në ushtrimet e leximit dhe të këndimit,
- ndërtimin, dëgjimin si dhe riprodhimin intonativ të intervaleve të thjeshta;
- leximin aprimavista të ushtrimeve të leximit dhe këndimit sipas shkallës së vështirësisë që janë parashikuar në program.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violonçel, violë, vegla të frymës, kitarë**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1.Rezultatet e pritshme
Në përfundim të këtij programi, nxënësi:
- lexon rrjedhshem ushtrime me 5 çelësat e IB (Do-së);
- realizon diktim melodik me 1-2 zëra.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Tematika	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
Kromatizmi	Përsëritje teorike-praktike e D_7, II_7 dhe VII_7.	1 orë	-	-
	Shkalla kromatike maxhore.	1 orë	1 orë	1 orë
	Shkalla kromatike minore.	1 orë	1 orë	1 orë
Sistemi i përgjithshëm i çelësave	Çelësi sopranit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi mexosopranit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi altit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi tenorit.	1 orë	1 orë	2 orë
	Çelësi baritonit.	1 orë	1 orë	2 orë
	Shtrirja instrumentave të ndyshëm sipas çelësave me të cilat shkruhen.	2 orë	-	-
Gjithsej		10 orë	12 orë	12 orë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT
a)Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lëndën Teori solfezhi, klasa XI:
- ✓ Pozzoli nr. 1-2.
- ✓ Poltronieri.
- ✓ Lladuhin: 1000 diktate melodike 1-2 zëra.
- ✓ Pozzoli: diktate melodike.

b)të përvetësohen karakteristikat e ndertimit te shkalles kromatike mazhore dhe minore;
c)të punohet me metodën "të nxënit duke bërë" për të siguruar njohuri teoriko-praktike të qëndrueshme.

4.VLERËSIMI
Nxënësit do të vlerësohen për:
-) përvetësimin i koncepteve kryesore të njohurive teorike-praktike për cdo kapitull;
-) nivelin i pergatitjes me testime periodike me shkrim dhe me gojë;
-) aftësinë e perceptimit intonativ e ritmik te diktimeve melodike e ritmike.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë, korno, trombë, trombone, perkusion, fagot, kitare dhe kanto.**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Rezultatet e pritshme:
Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- zbërthen dhe lexon rrjedhshem ushtrimet ritmike me përdorimin e ritmeve të thjeshta, të përbëra dhe të përziera;
- intonohet tonalitetet +, - në 3 forma me 0 dhe 7 shenja;
- intonohet ushtrime melodike aprimavista;
- realizon diktimin melodik me 0-2 shenja.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Tematika	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
Ritmika	Përsëritje e lëndës së vitit të kaluar	2 orë	2 orë	2 orë
	Ritmet e përziera 6/2, 6/4, 6/8, 6/16, 9/2, 9/4, 9/8, 9/16, 12/2, 12/4, 12/8, 12/16 .	4 orë	4 orë	4 orë
	Ritmet e përziera 5/4, 5/8, 5/16, 7/4, 7/8, 7/6, 9/4, 9/8, 9/16, 12/4, 12/8, 12/16.	4 orë	4 orë	4 orë
	Vlera e notës 1/32 dhe pushimi.	1 orë	2 orë	2 orë
	Sinkopa dhe llojet e saj.	1 orë	2 orë	2 orë
Intervalet	Intervale e përbëra.	1 orë	2 orë	2 orë
	Përmbajtja e intervaleve.	1 orë	2 orë	2 orë
	Zgjidhja e intervaleve.	1 orë	2 orë	2 orë
Shkallet muzikore	Rrethi kuintave.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla La+ dhe Fa#- ne 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Mib+ dhe Do- ne 3 forma.	2 orë	2 orë	1 orë
	Shkalla Si+, Sol#- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Reb+, Sib- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Fa#+, Re#- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Solb+, Mib- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Do#+, La#- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla Dob+, Lab- në 3 forma.	2 orë	2 orë	2 orë
Akordet	Akordi, kuitakordi dhe llojet e tij.	2 orë	4 orë	4 orë
	Sektakordi dhe llojet e tij.	2 orë	4 orë	4 orë
	Kuartsektakordi dhe llojet e tij.	2 orë	4 orë	4 orë
	Modelet popullore.	1 orë	2 orë	2 orë
	Përsëritje .	1 orë	-	-
Gjithsej		41 orë	52 orë	51 orë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

a)Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lëndën Teori solfezhi, klasa XI:

- Pozzoli nr. 2.
- Poltronieri.
- Dema Ilirjana, Teoria dhe praktika e solfezhit ritmik.
- Pozzoli: diktime melodike;

b)t'i jepet përparësi formimit të shprehive të qarta ritmike në metrat e thjeshta, të përbëra dhe të përziera përmes përsëritjeve të vazhdueshme paralele;

c)të punohet për të siguruar njohuritë teoriko-praktike të qëndrueshme të 30 tonaliteteve të sistemit diatonik;

d)të përdoret metoda e "Të nxënit duke bërë" në intonimin e ushtrimeve të këndimit aprimavista si edhe në diktimet melodike.

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- njohuritë e tre kapitujve kryesore të ritmeve ku në mënyrë të pavarur, të evidentojë të përbashkëtat dhe të vecantat e tyre;
- formimin teorik-praktik me anë të testimeve me shkrim dhe me gojë duke vënë theksin tek A_5 A_6 A_{64}.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violonçel, violë, vegla të frymës, kitarë.**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- zbërthen në mënyrë të pavarur strukturat melodike;
- realizon transportin e një pjesë muzikore me të tre mënyrat;
- realizon diktim melodik dhe ritmik me ritme te thjeshta dhe të përbëra.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Tematika	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
Akordet	Përsëritje e përgjithshme: -shkallët muzikore; -akordet; -septakordet.	2 orë	2 orë	2 orë
Transporti muzikor	Transporti me anën e semitonit kromatik.	2 orë	2 orë	2 orë
	Transporti me shkrim me anën e intervalit.	2 orë	2 orë	2 orë
	Transporti me anën e çelesave.	2 orë	2 orë	2 orë
Modulacioni	Modulacioni i grupit pare.	2 orë	2 orë	2 orë
Përsëritje	Diktim melodik me 1 dhe 2 zëra. Diktim ritmik me 2 lëvizje njëherësh.	2 orë	2 orë	-
Gjithsej		12 orë	12 orë	10 orë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

a)Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lënden "Teori solfezhi", klasa XII:

- Pozzoli numër 3, ushtrime leximi dhe këndimi.
- Lladuhin: 1000 diktime melodike.

b)të bëhet kujdes në drejtim të aspektit të dëgjimeve në funksion ku të intonohen skema harmonie në grup;

c)të punohet për të rritur nivelin e njohurive për të formuar kulturen e lëndës si dhe anën funksionale të saj.

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- formimin e përgjithshëm teorik-praktik përmes testimeve periodike me shkrim dhe me gojë sipas kapitujve të caktuar;
- nivelin e dijeve të drejtimit melodik të lëndes përfshire këtu; dëgjime të ndryshme, ushtrime këndimi aprimavista dhe diktat melodik;
- realizimin e transportit muzikor në tre menyra.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë, korno, trombë, trombone, perkusion, fagot, kitare dhe kanto**
Lënda: **Teori solfezhi**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- ✓ lexon rrjedhshëm ushtrime melodike me çelësin e IB (do-së) me ritme të thjeshta, të përziera;
- ✓ kryen transportin e një pjese muzikore në të tre mënyrat;
- ✓ realizon diktate melodike në ritme të thjeshta dhe të përbëra;
- ✓ lexon ushtrime melodike aprimavista.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Teori solfezhi"

Tematika	Temat mësimore	Teori	Praktikë	Diktim
Ritmike	Përsëritje .	1 orë	1 orë	1 orë
	Grupet e çrregullta.	2 orë	4 orë	4 orë
	Shenjat e zbukurimit.	2 orë	4 orë	4 orë
Septakordet	D_7 zgjidhja e tij.	2 orë	4 orë	4 orë
	Gradi II_7.	2 orë	4 orë	4 orë
	Gradi VII_7.	2 orë	4 orë	4 orë
Enharmonizimi	Tingujt enharmonik.	1 orë	2 orë	2 orë
	Intervalet enharmonik.	1 orë	2 orë	2 orë
	Akordet enharmonik.	1 orë	2 orë	2 orë
	Tonalitete enharmonik.	1 orë	2 orë	2 orë
Sistemi i përgjithshëm i çelësave	Çelësi do-së. Çelësi sopranit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi mexosopranit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi altit.	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi tenorit .	1 orë	2 orë	2 orë
	Çelësi baritonit.	1 orë	2 orë	2 orë
Transporti muzikor	Transport me semitonin kromatik.	2 orë	2 orë	2 orë
	Transport me shkrim dhe me anën e intervalit.	2 orë	2 orë	2 orë
	Transport me anën e çelësave.	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla kromatike. +	2 orë	2 orë	2 orë
	Shkalla kromatike. -	2 orë	-	-
	Modulacioni i grupit parë me një shenjë.	2 orë	2 orë	2 orë
	Përsëritje.	1 orë	2 orë	2 orë
Gjithsej		34 orë	51 orë	51 rë

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

a)Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të përdoren për lënden “Teori solfezhi”, klasa XII:

- Pozzoli nr. 3, ushtrime leximi dhe këndimi
- Lladuhin: 1000 diktime melodike.

b) të bëhet kujdes në drejtimtë aspektit të dëgjimeve në funksion ku të intonohen skema harmonie në grup;

c) të punohet për të rritur nivelin e njohurive për të formuar kulturën e lëndës si dhe anën funksionale të saj;

d) t’i jepet përparësi leximit rrjedhshëm të ushtrimeve me 5 çelësat e IB (do-së).

4.VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- formimin e përgjithshëm teoriko-praktik përmes testimeve periodike me shkrim dhe me gojë sipas kapitujve të caktuar;
- nivelin e dijeve të drejtimit melodik të lëndës përfshirë këtu; dëgjime të ndryshme, ushtrime këndimi aprimavista dhe diktat melodik.
- leximin e ushtrimeve të leximit me përdorimin e 5 çelësave të IB (do-së).

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Instrumentistë harqesh: violinë, violë, violonçel, kontrabas**
Lënda: **Orkestër harqesh**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të këtij programi, nxënësi:

- ✓ zbërthen partet orkestrale me saktësi ritmike dhe pastërti intonative;
- ✓ zbërthen partet orkestrale të secilit pult në veçanti, si edhe të të gjitha grupeve të orkestrës së harqeve, harkatat me një intonacion gjithmonë korrekt;
- ✓ krijon raporte të drejta të tingëllimit në grupin e tij/saj dhe midis grupeve të tjera të orkestrës;
- ✓ luan në ansambël, duke ruajtur balancat e tingëllimit, si edhe veçoritë stilistike të secilës vepër;
- ✓ krijon bashkëpunimin dhe pavarësinë në lojën në orkestër;
- ✓ zotëron karakteristikat e orkestrantit i cili/e cila duhet të luajë e të dëgjojë njëkohësisht instrumentet rrotull tij/saj;
- ✓ luan në orekestër veçoritë e muzikës që luan, duke u dhënë veprave orkestrale karakterin e duhur.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Orkestër harqesh"

	Tema mësimore	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Tema 1	W.A. Mozart - serenatë për harqe, 4 kohë.	***Nxënësi:*** ➢ luan pastër në intonacion; ➢ ekzekuton saktë partin orkestral; ➢ unifikohet me grupin.	**24 orë**
Tema 2	T. Harapi - miniatura të përshtatura për harqe.	➢ vendos harkata e t'i respektojë ato; ➢ luan në karakter të veprës.	**12 orë**
Tema 3	F. Shubert - moment muzikor.	➢ Realizon gjatë lojës rrymën e kompozitorit; ➢ është i saktë e muzikal.	**8 orë**
Tema 4	Ç. Zadeja - suitë "Delina", në 3 kohë.	➢ punon individualisht për zbërthimin me saktësi të partit orkestral.	**24 orë**
Gjithsej:			**68 orë**

3.**UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

a. Përzgjedhja e programit që do të luajë orkestra e harqeve.
b. Sigurimi i partiturës dhe parteve të veprave.
c. Zbërthimi i partiturave.
d. Punimi i parteve të grupeve të veçanta në orkestrën e harqeve, duke përcaktuar harkatat.

e. Puna me grupet, duke kërkuar pastërti në intonacion, e, më pas, lidhja e të gjitha grupeve.
f. Puna me orkestrën e harqeve për lojën e saktë dhe për evidentimin e karakterit të veprave.

4.VLERËSIMI

- ✓ Njohja mirë dhe loja e saktë e çdo parti orkestral.
- ✓ Ruajtja e balancave në tingëllim.
- ✓ Theksimi i karakterit të veprave dhe i muzikalitetit të pjesëve të veçanta.
- ✓ Kontrolli i njohjes së parteve orkestrale me anë të kontrolleve teknike pas
- ✓ përfundimit të çdo vepre.
- ✓ Loja e grupeve orkestrale ku nxënësi bën pjesë, duke kontrolluar grupin dhe
- ✓ çdo instrumentist më vete.
- ✓ Njohja me partet orkestrale të punuara gjatë vitit.
- ✓ Ruajtja e raportit të tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve të
- ✓ tjera orkestrale.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Instrumentistë fryme:** ***flaut, oboe, klarinetë, fagot, trombë, trombon etj.***
Lënda: **Orkestër frymore**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Orkestër frymore", nxënësi:

- zbërthen partet orkestrale me saktësi ritmike dhe pastërti intonative;
- krijon raporte të drejta të tingëllimit në grupin e tij/saj dhe midis grupeve të tjera të orkestrës;
- zotëron karakteristikat e orkestrantit, i cili/e cila duhet të luajë e të dëgjojë njëkohësisht instrumentet rrotull tij.

2.Përmbajtja tematike e lëndës "Orkestër frymore"

	Tema mësimore	**Rezultatet e pritshme**	**Orët**
Tema 1	Titta – "Marsh".	***Nxënësi:*** ➢ zbërthen me saktësi partet; ➢ luan pastër në intonacion.	18 orë
Tema 2	P. Jakova – "Marshi i fizkulturistëve".	➢ interpreton bukur e në karakter veprën; ➢ luan saktë ritmikisht.	18 orë
Tema 3	XH. Verdi - "Libiamo", nga opera "Traviata".	➢ luan qartë melodikisht e me tingull të ngrohtë e melodioz.	18 orë
Tema 4	J.Hayden – "Marsh".	➢ ekzekuton rrymën në të cilën bën pjesë autori; ➢ luan veprën në karakter.	14 orë
Gjithsej:			**68 orë**

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

- Punimi i parteve të grupeve të veçanta në orkestrën frymore.
- Puna në grupe të veçanta për pastërti në intonacion.
- Puna në grupe për saktësi në vlerat ritmike e pasazhet melodike.
- Puna në grupe e, më pas, lidhja e të gjitha grupeve.
- Puna me orkestrën frymore për evidentimin e timbrikave të veçanta të çdo grupi në veçanti, si dhe për bashkëtingëllimin e gjithë orkestrës frymore.
- Sigurimi i partiturës dhe parteve të veprave të mësipërme, si:

  - Titta: "Marsh".
  - P. Jakova - "Marshi i fiskulturistëve".

- XH.Verdi - “Libiamo”.
- Hajdn - “Marsh”.

4.VLERËSIMI

Njohja mirë dhe loja e saktë e çdo parti orkestral është një kërkesë e domosdoshme për vlerësimin e nxënësit, ndërsa ruajtja e balancave në tingëllim dhe theksimi i karakterit të veprave dhe i muzikalitetit të pjesëve të veçanta bën diferencën në vlerësimin e nxënësit. Vlerësimi mbështetet në:

- kontrollin e njohjes së parteve orkestrale me anë të kontrolleve teknike pas përfundimit të çdo vepre;
- lojën e grupeve orkestrale ku nxënësi bën pjesë, duke kontrolluar grupin dhe çdo instrumentist më vete;
- njohjen me partet orkestrale të punuara gjatë vitit;
- ruajtjen e raportit të tingëllimit midis tij/saj, grupit të tij/të saj dhe grupeve të tjera orkestrale.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Instrumentist fillestar dhe këngëtarë**
Lënda: **Kor**
Klasat: X-XII
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Kor", nxënësi:

- ✓ zbaton rregullat e të kënduarit në kor, përmes njohjes së teorisë dhe praktikës më elementare të zhvillimit të aparatit vokal, të përpunimit të tij, si dhe të zhvillimit të diapazonit, të artikulacionit, mimikes, diksionit etj., në veçanti;
- ✓ zbaton elementet muzikore dhe elementet e melodisë, si: *motivi, fraza, fjalia, forma, harmonia dhe interpretimi*;
- ✓ këndon repertor nga më të thjeshtat deri te më të vështirat, duke zbatuar të gjitha kërkesat e mësuara;
- ✓ këndon saktë solo, duet, ansambël dhe në kor;
- ✓ kupton rëndësinë e të kënduarit në kor;
- ✓ realizon pjesë nga vepra të autorëve të vendit dhe të huaj;
- ✓ interpreton veprat muzikore, duke zbatuar të gjitha njohuritë muzikore, si: *termat dinamike, shenjat e ngjyrimit* etj.;
- ✓ vlerëson pjesët muzikore që këndon.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kor"**

Tematika	**Tema mësimore**
Pjesa teorike	) Kriteret bazë të krijimit të një kori dhe tipat e ndryshëm të ansambleve korale, si dhe partet që e përbëjnë atë: a. llojet e sopranove, altove, tenoreve dhe baseve; **b.** mënyra e vendosjes së një kori; formacioni **Bach,** formacioni **Modern.**
	) Karakteri teoriko-praktik i formave të punës me koret **accapella** gjatë procesit të zbërthimit dhe përvetësimit të një pjese apo vepre korale.
	) Krijimtaria korale **accapello** dhe **me shoqërim** e autorëve botërorë dhe atyre kombëtarë, bazë e rëndësishme për edukimin e shijeve artistike dhe profesionale të koristëve.
	) **Ansambël dhe fuzion** - shprehje e një uniteti absolut, elemente të rëndësishme për vlerësimin e një kori.
	) Pozicioni i koristit në mënyrën e vendosjes në kor dhe të qëndruarit, si dhe ushtrimet vokale në parte të veçanta dhe në përgjithësi.) Roli i vokalicave për zhvillimin e diapazonit, dinamikës, artikulacionit, mimikës dhe diksionit.) Perfeksionimi i frymëmarrjes si bazë dhe element kryesor mbas vokalit të një koristi.
	) Të kënduarit "Voce Biancha", si dhe "Cuppo" që bën të dallohet

	profesionisti nga amatori, si dhe një kor apo shkollë vokale nga një shkollë tjetër.
	) Tingëllimi suonor i parteve në veçanti dhe shmangia e vibratove për sigurimin e një intonacioni të pastër.
	) Analiza poetiko-harmonike e formës dhe e përmbajtjes, faktor për një interpretim dhe realizim sa më të mirë.
	) Roli i shenjave dinamike në kor, si dhe të mësuarit e të kënduarit **vertikal,** harmonik në kor, që aplikohet sidomos në shkollat e lindjes.
	) Dirigjentët më tipikë në botë, historia e zhvillimit të kulturës vokale-korale në lashtësi, në mesjetë dhe sot. Kapelmaestrot dhe kush i themeloi ato.
	) Duo, trio, kuartetet, sekstetet, dubël sekstetet etj., dhe ç'ndryshim kanë nga **kameral** dhe nga formacioni i plotë.

Literaturë muzikore korale paraklasike dhe klasike[G]	**Literaturë Muzikore Kombëtare**
) Monteverdi - "Vala e Heshtur". "Do të jetoj".) O. Lasso - "Desha të them". "Vjelja e rrushit". "Tik-tak". "Eho".) J. S. Bach - "Gjithmonë përpara", Kantatat 101, 107 etj.) Bach-Gounod – "Ave Maria".) Ë. A. Mozart - "Këngë djepi". "Pranvera erdhi" "Përsëri". Koralet nga Opera "Dasma e Figaros". "Mesha Requiem" etj.) Beethoven - "Thirrje pranverore". "Muzeu i mbrëmjes". Koralet nga Opera "Fidelio".) Pergolessi - "Stabat Matter".) Bartjakovski - "Shenjt Perëndi". " Kurorëzimi".) Glinka - "O ti dritë Ljudmilla"	) A. Mula - Agime shqiptare. Marshimet partizane. Koralet e Operetës "Karnavalet e Korçës". Korale nga Opera "Borana". Korale nga Opera "Nëna e trimave". Kantata "Shqipëri, moj famëmadhe". Korale nga Poema vokalo-simfonike "Nënë Shqipëri".) P. Jakova - Koralet nga Opera "Mrika" dhe "Skënderbeu".) Ç. Zadeja - "O ju male". "N'at zaman t'asaj furie". "Shkon djali termale". Koralet e Suitës Nr. 1, 2, 3.) K. Trako - "Baresha". "Pare kush të preu fustane".) K. Kono - Rapsodi Nr. 1, 2.) P. Gaci - "Lutari". "Për ty Atdhe".) T. Daija - "Dy zana vlonjate". "Si dukat i vogël le". "Oj Oç".

[B] Kjo literaturë është e sugjeruar dhe orientuese. Ajo mund të ndryshojë sipas ecurisë dhe nivelit artistik të nxënësve.

nga opera “Rullan- Ljudmilla”.

“Këngë djepi”.

“Natë veneciane”.

- Smetana - Koret nga Opera “Nuse e shitur”.
- Ëagner - Nga Opera “Marinari endacak” (Kor vajzash).
- Gounod - “Natë e qetë”.
- Çajkovski - “Qëndrimi”.
  “ Vetmia”.

  “Bilbili”.

Koret nga Opera “Evgeni Onjegin”.

- Schubert - “Barkarola”.
  “Blini”.

  “Qetësia e natës”.

  “Nata”.
- Schumann - “Ciganet”.
  “Lotusi”.

  “Shtëpia buzë detit”.

  “Nina-nana”.

  “Fantazi”.

  “Ëndërrime”.

  “Shpërthimi”.

  “Ylli i mbrëmjes”.
- Brahms - “Në qetësinë e natës”.
  “Nina-nana”.

  “Gëzimi”.

  Numra korale nga “Mesha”.
- Verdi - Mesha Tedeum (Numra)

Korale nga Operat, si: “Nabuko (Va Pensiero), Bataglia di Legnano.

- Rahmaninov - “Ave Maria”.
  Kambanat, (Cikël koral).
- Borodin - “Vallet Polltave” nga
- S. Gjoni - “Lule borë”.
- L. Antoni - “Çorapet e burrit”.
  “Kënga e Rexhës”.
- R. Dhomi - “Poradeci”.
  “Zemra e liqenit”.

  “O moj e bukura

  More”.
- M. Kaçinari – “Bijtë e shqipes”.
  “Ani, moj Hatixhe”.
- R. Rudi - “Xhike-Xhike”.
- M. Vako - “Bjen lodra”.
  “Janinës ç’i panë sytë”.

  “Broj një pëllumb”.

  “Delja rude”.

  “Ç’bën ti moj atje përposh”.

  “Erdhi prilli, ç’u shkri bora”.

  “Ti më je si gonxhe”.

Opera “Princi Igor”. - Mendelhson - Koralet nga “Ëndrra e një nate vere” “Pylli”. - Tanjejev - Johan Domaskin. Kantatë (Numra). “Nata”. - Çesmakov - “Zhurma e erës së luleve”. - Kalinikov - “Elegjia”. - Ivanov - “Mëshirë paqeje”.	

Shënim.

- Ky repertor është i përzier (për kor vajzash, burrash dhe miks). Çdo pjesë korale mund të përshtatet nga mësuesi, dirigjenti ose nga specialistë të tjerë për formacione të ndryshme, si nga kor miks, në kor vajzash dhe anasjellas etj.
- Mësuesi i lëndës korale, krahas punës praktike, zhvillon anën teorike të kësaj lënde. Kështu, një temë mësimore mund të zgjasë 5-6 orë mësimore.

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Mësimi teoriko-praktik*:* Ngarkesa 68 orë të ndahet në dy semestra për nga 34 orë secila. Kjo ngarkesë vlen për të gjitha klasat nga X deri te klasa XIII.

Procesi mësimor zhvillohet dy herë në javë nga një orë për çdo mësim, për degën e kantos, ndërsa për instrumentistë (pianist kryesisht) vetëm një herë në javë (dy orë). Mësuesi i lëndës korale, krahas punës praktike, e zhvillon këtë lëndë edhe në teori.Procesi mësimor i kësaj lënde është i vlefshëm si për nxënësit e degës të kantos, ashtu edhe për nxënësit e degës së instrumentistëve.

Në këtë lëndë, gjatë procesit mësimor nxënësit njihen me teorinë dhe praktikën më elementare të zhvillimit të aparatit vokal, të përpunimit të tij, si dhe të zhvillimit të diapazonit, të artikulacionit, mimikës, diksionit etj., në veçanti të frymëmarrjes, si një ndër elementet më kryesore të mënyrës së të kënduarit në kor.

Gjithashtu, mësohen elementet muzikore dhe elementet e melodisë, si: *motivi, fraza, fjalia, forma, harmonia dhe interpretimi*, elemente këto që luajnë një rol shumë të rëndësishëm jo vetëm te nxënësit e degës së kantos, por edhe tek ata të instrumentistëve, pasi i pajis ata me sensibilitetin dhe mënyrën e interpretimit që reflektohet edhe gjatë ushtrimit të tyre në instrument dhe aplikohet në shkollat muzikore, konservatore apo akademitë më të zhvilluara në Europë dhe në botë.

Një rol tjetër i rëndësishëm për formimin e nxënësve nëpërmjet klasave korale luan edhe repertori i zgjedhur. Për këtë arsye, repertori zgjidhet duke filluar nga veprat më të thjeshta e deri ato madhore nga muzika paraklasike, klasike e moderne bashkëkohore dhe deri tek të gjitha

llojet e stileve të ndryshme. Gjithashtu, përveç veprave të kompozitorëve botërorë, këtu përdoren edhe vepra të kompozitorëve kombëtarë, sidomos të përpunimit të këngës sonë popullore.

Ky repertor i klasës së interpretimit koral është i vendosur në shtojcën e programit mësimor, i cili pasurohet për çdo vit sipas zhvillimit të muzikës.

Për përzgjedhjen e këtij materiali (repertori), është marrë parasysh kriteri pedagogjik i shkallëzimit së vështirësive profesionale nga një vit në tjetrin. Programi, i cili zhvillohet për katër vite, është i detyrueshëm për nxënësit këngëtarë dhe ata instrumentistë. Lënda zhvillohet kryesisht me anë të mësimeve teoriko-praktike e orëve kolektive me klasa, ku secili individ i inkuadruar sipas karakterit të zërit të tij në kor, nën drejtimit e mësuesit (dirigjent) këndon partin koral të veprës që dirigjohet.

Theksojmë se njohuritë e domosdoshme teoriko-praktike për mjeshtërinë dhe artin e të kënduarit në formacion koral jepen lidhur ngushtë me shkallëzimin e vështirësive të repertorit që përdoret në procesin mësimor, si edhe me ndonjë leksion për çështjet më themelore që zhvillohen gjatë këtij procesi.

Diferencimi i lëndës në klasa të ndryshme nga klasa X deri në klasën XII, bëhet në forma nga më të ndryshmet nëpërmjet shkallëzimit të ushtrimeve dhe vështirësive të repertorit, si dhe të kërkesave të karakterit profesional. Këtu duhet të kemi parasysh që ky repertor të jetë i mundshëm për të katër vitet. Në përmbajtjen e programit mësimor të klasës së interpretimit koral, brenda normës së procesit mësimor, zhvillohet edhe praktika e nxënësve të klasës XIII të udhëhequr nga mësuesi dirigjent. Ky proces ka për qëllim të pajisë nxënësit profesionalisht në rastin e ndërrimit të degës muzikore, si dhe t'i bëjë të aftë të drejtojnë grupe korale në rast se u paraqitet e nevojshme.

Përgatitja artistike e nxënësve për të qenë të aftë në kor, lidhet ngushtë edhe me zotërimin nga ana e tyre e lëndëve formuese të veçanta apo lëndëve teorike dhe praktike, si: pianoja, solfexhi, harmonia, polifonia etj. Në fund të vitit shkollor, kori merr pjesë në një koncert të përbashkët, i cili është edhe dëshmia kryesore për vlerësimin përfundimtar, pa të cilin asnjë nxënës nuk mund të hyjë në asnjë provim (kjo sipas përvojës edhe të shkollave muzikore të përparuara në botë).

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violonçel, kontrabas**
Lënda: **Orkestracion**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Orkestracion", nxënësi:

- njeh të gjitha grupet orkestrale dhe veçoritë timbrike të tyre;
- njeh çelësat e instrumenteve me transport dhe partiturat orkestrale;
- orkestron duke ruajtur balancat e tingëllimit për grupin e harqeve;
- orkestron për grupin e të drunjtave;
- orkestron pjesë të ndryshme për grupe e formacione orkestrale;
- orkestron për grupin e tunxhit, si dhe për gjithë formacionin orkestral.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Orkestracion"**

Tematika	**Tema mësimore**	**Orët**
Llojet e orkestrave	Orkestra e harqeve. Orkestra e vogël sinfonike. Orkestra e madhe sinfonike. Partitura e orkestrës. Çelësat. Instrumentet me transport.	8 orë
Grupi i harqeve	Violina. Viola. Violonçeli. Kontrabasi.	4 orë
Mënyrat e orkestrimit në orkestrën e harqeve	Melodia në harqet. Harmonia në përgjithësi. Harmonia në orkestrën e harqeve.	6 orë
Grupi i instrumenteve frymore dhe të drunjta	Flauti. Flauti i vogël. Oboe. Kornoja angleze. Klarineta. Llojet e klarinetave. Fagoti. Kontrafagoti.	8 orë

Bashkimi i grupeve	⎫ Bashkimet e grupeve në melodi. ⎫ Bashkimet e grupeve në harmoni. ⎫ Orkestrimi për grupin e harqeve dhe të drunjtave.	6 orë
Grupi i tunxhit	⎫ Korno. ⎫ Tromba. ⎫ Tromboni. ⎫ Basstuba.	6 orë
Bashkimi i grupeve	⎫ Bashkimet e grupeve në melodi. ⎫ Bashkimet e grupeve në harmoni. Orkestrimi për grupin e tunxhit dhe grupeve të tjera.	8 orë
Grupi i instrumenteve me goditje (perkusion)	a) Instrumentet me pickim dhe tastierë. b) Instrumentet e akordueshme. ⎫ Timpanet. ⎫ Ksilofoni. ⎫ Pianoforte. ⎫ harpa etj. c) Instrumentet e paakordueshme: ⎫ Triangolo. ⎫ Kanstanjetat. ⎫ Tamburo. ⎫ Pjatat. ⎫ Grankasa etj.	10 orë
Bashkimi i të gjitha grupeve	⎫ Baraspeshimi i forcës së tingullit në orkestrim. ⎫ Bashkimi i timbreve të grupeve orkestrale. ⎫ Bashkimi i të gjitha grupeve orkestrale.	6 orë
Disa veçori të materialit muzikor në veprat orkestrale	⎫ Dyfishimet. ⎫ Gërshetimi i zërave dhe i linjave. ⎫ Planet melodike. ⎫ Planet harmonike. ⎫ Sfondet orkestrale. ⎫ Mjetet e zhvillimit të tkurrjes orkestrale.	6 orë

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për zbatimin e këtij programi duhet fleksibilitet nga ana e mësuesit, duke punuar dhe demonstruar me nxënësit e instrumenteve të ndryshme veçoritë timbrike të instrumenteve, si dhe përzgjedhjen e detyrave më të mira për t'u luajtur në grupe të vogla.

Kështu, nxënësit dëgjojnë konkretisht gërshetimin dhe bashkëtingëllimin e instrumenteve të grupeve të veçanta për të krijuar një vizion sa më të qartë të materializimit të tingujve dhe timbrikave orkestrale.

Ora e praktikës, që shoqëron çdo temë të re në lëndën e orkestracionit, e bën të lehtë njohjen e nivelit të përgatitjeve të çdo nxënësi.

Rekomandime për përzgjedhjen e materialeve që do të orkestrojnë në klasë:

T. Harapi

- "Valsi".
- "Një dhimbje e vogël".
- "Vallja e xhuxhave".

P. Çajkovski: "Album për fëmijë".
Tema kryesore të sonatave që luajnë vetë nxënësit.
Materiale të propozuara nga nxënësit.

4. VLERËSIMI

Nxënësit do të vlerësohen për:

- njohjen e të gjitha grupeve orkestrale dhe veçorive timbrike të tyre;
- përcaktimin e çelësave e instrumenteve me transport;
- përcaktimin e çelësave përkatës, si te viola, çello, korno etj.;
- njohjen dhe transportet për instrumente, si klarineta e tromba;
- përcaktimin e timbrikës së veçantë të grupeve të ndryshme, gjë që pasqyrohet në detyrat e paraqitura në orët e praktikës;
- njohjen e partiturave orkestrale;
- orkestrimin duke ruajtur balancat e tingëllimit për grupin e harqeve;
- orkestrimin për grupin e të drunjtave;
- orkestrimin e pjesëve të ndryshme për grupe e formacione orkestrale;
- orkestrimin për grupin e tunxhit, si dhe për gjithë formacionin orkestral.

Dega: **Muzikë**
Lënda: **Orkestër simfonike**
Specialiteti: **Instrumentistë harqesh, frymë e perkusion**
Klasat: **XI-XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Orkestër simfonike", nxënësi:

- ✓ njihet dhe zbërthen partet orkestrale me saktësi ritmike dhe pastërti intonative;
- ✓ njihet dhe zbërthen me saktësi partet orkestrale të secilit pult në veçanti;
- ✓ kupton vendosjen e harkatave të njëjta për harqet;
- ✓ zhvillon punë të detajuar me instrumentistët e frymës për një intonacion gjithmonë korrekt;
- ✓ luan në ansambël, duke ruajtur balancat e tingëllimit, si dhe veçoritë stilistike të secilës vepër;
- ✓ njeh veçoritë e secilit grup orkestral në interpretimin e përbashkët, duke ruajtur karakteristikat timbrike e melodike të secilit instrument dhe grup instrumentesh;
- ✓ krijon raporte të drejta të tingëllimit në grupin e tij dhe midis grupeve të tjera të orkestrës;
- ✓ zotëron karakteristikat e orkestrantit, i cili/e cila duhet të luajë e të dëgjojë njëkohësisht instrumentet rrotull tij/saj;
- ✓ njeh veçoritë e muzikës që luan, duke u dhënë veprave orkestrale karakterin e duhur.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Orkestër simfonike"

Tematika	Tema mësimore	Rezultatet e pritshme	Orë
Simfonia klasike	1.1. Hajden - Simfonia Do+	***Nxënësi:*** ➢ luan partet e pulteve duke vendosur harkatat e sakta te harqet dhe duke unifikuar ekzekutimin e të gjitha grupeve.	26 orë
Simfonia romantike	2.1. F. Shubert -"Simfonia e pambaruar" në Si-	➢ Luan që temat e veprës të tingëllojnë bukur melodikisht e intonacioni pastër.	26 orë
Muzika shqiptare	3.1.P. Vorpsi – "Fantazi"	➢ Punon në drejtim të bashkëtingëllimit të grupeve të orkestrës.	16 orë
Programi i lëndës **"Orkestër simfonike"** do të luhet përgjatë klasave XI-XII. Ky program do të jetë i njëjtë për të gjithë instrumentistët. Nisur nga numri i instrumentistëve të ndryshëm që vijnë vit pas viti, si edhe niveli i tyre, mësuesi mund të përzgjedhë literaturë tjetër veç kësaj, të përshtatshme e të vlefshme për formacionin simfonik aktual si p.sh: ❯ Moxart –Divertiment. ❯ Zadeja - Suitë nga baleti "Delina" Bethoven: Uverturë "Egmond".			

- Grig- Suita “Per Gynt” Mozart: “Rëmbimi nga sarajet.
- Bethoven: Romancë F dur për violinë e orkestër..etj.

VLERËSIMI

Për një vlerësim sa më të drejtë duhet pasur parasysh:

- ✓ njohja mirë dhe loja e saktë e çdo parti orkestral;
- ✓ ruajtja e balancave në tingëllim;
- ✓ theksimi i karakterit të veprave dhe e muzikalitetit të pjesëve të veçanta;
- ✓ kontrolli i njohjes së parteve orkestrale me anë të kontrolleve teknike pas përfundimit të çdo vepre;
- ✓ loja e grupeve orkestrale ku nxënësi bën pjesë, duke kontrolluar grupin dhe çdo instrumentist më vete;
- ✓ njohja me partet orkestrale të punuara gjatë vitit;
- ✓ ruajtja e raportit të tingëllimit midis tij, grupit të tij dhe grupeve.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violë, violonçel, frymë, kitarë**
Lënda: **Muzikë dhome**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Muzikë dhome", nxënësi:

- ✓ përvetëson *elementet teknike e muzikore* për këtë grupmoshë;
- ✓ zhvillon shprehitë ekzekutuese dhe interpretuese;
- ✓ luan pjesët muzikore në tempet reale, duke zhvilluar aftësitë krijuese të tij/saj brenda kërkesave teknike artistike;
- ✓ realizon interpretimin në grup dhe të përshtatet me të, kryesisht me instrumente brenda një lloji;
- ✓ ruan ekuilibrin e tingëllimit gjatë interpretimit në grup.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Muzikë dhome"**

Instrumentet	Repertori muzikor	Orë gjithsej
Piano	**W. A. Moxart** - sonata me 4 duar. **Klementi** - sonatina me 4 duar.	**34 orë**
Harqe	**F. Mazas** - dy violina dhe piano. **A.Vivaldi** - koncerto groso; - dy violina dhe piano. **W. A. Moxart -** pjesë për dy violina.	**34 orë**
Fryma dhe kitarë	**J. S. Bach** - trio flaut kitarë. **F. Handel** - flaut kitarë. **J. Brams** - serenatë flaut kitarë Hayden. **H. Klose** - duo klarinetë temë me variacione 15 pjesë. **Bërman** - duo klarinetë temë me variacione.	**34 orë**
Perkusion	**Morris Goldenberg.** **Gianluca Capitani -** pjesë të ndryshme për kselofon, çeleste, vibrafon dhe grup veglash perkusioni.	**34 orë**

3. **UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

Për realizimin e këtij programi punohet në drejtim të njohjes së nxënësve me karakteristikat dhe vlerat e veprave të autorëve përkatës. Ata njihen me elementet teknike të ndërtimit të frazës muzikore, u japin përparësi realizimit cilësor të vlerave ritmike, respektojnë shenjat e ngjyrimit në funksion të cilësisë së tingullit dhe krijojnë një posturë apo një qëndrimi të bukur në skenë.

4. **VLERËSIMI**

Nxënësit vlerësohen për:

- njohjen e elementeve të teknikës së interpretimit në lojën në ansambël;
- unifikimin e tingëllimit duke ruajtur sensin harmonik.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violë, violonçel, frymë, kitarë**
Lënda: **Muzikë dhome**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Muzikë dhome", nxënësi:

- përvetëson *elementet teknike e muzikore* për këtë grupmoshë;
- zhvillon shprehitë ekzekutuese dhe interpretuese;
- ekzekuton veprat që kërkon programi muzikor në funksion të duos ose trios ku bën pjesë;
- realizon interpretimin në grup dhe të përshtatet me të, kryesisht me instrumente brenda një lloji;
- ruan ekuilibrin e tingëllimit gjatë interpretimit në grup.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Muzikë dhome"**

Instrumentet	Repertori muzikor	Orët
Piano	**J. Brams** - vallet hungareze 1, 2,3 , 4, 5 për 4 duar.	**34 orë**
Harqe	**F. Mazas** - Dy violina dhe piano. **A.Vivaldi** - Koncerto grosso. Dy violin dhe piano. **W. A. Moxart -** pjesë për dy violina. **W. A. Moxart -** kuartet për harqe.	**34 orë**
Fryma dhe kitarë	**J. Hayden -** trio londineze. **F. Handel** - flaut kitarë. **R. Schuman** - kuartet për harqe. **Bononcini** - sonate Fl +piano 4 kohë vepër e plotë. **Quantz** - 2 flauta + piano 4 kohë. **H. Klose** - duo klarinetë temë me variacione 15 pjesë. **Bërman** - duo klarinetë temë me variacione. **Përpunime popullore -** për dy violinë dhe kitarë.	**34 orë**

3. **UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

- Të punohet në drejtim të njohjes së nxënësve me karakteristikat dhe vlerat e veprave të autorëve përkatës.
- Të punohet për përvetësimin dhe përsosjen e unifikimit të tingujve gjatë interpretimit në grup.
- Të bëhet kujdes për të siguruar frymëmarrjen në funksion të ndërtimit të frazës muzikore.

4. **VLERËSIMI**

Nxënësit vlerësohen për:

- realizimin e kërkesave tekniko-muzikore në funksion të përmbajtjes;
- realizimin e tingëllimit kualitativ;
- saktësinë e intonacionit.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano, violinë, violë, violonçel, frymë, kitarë**
Lënda: **Muzikë dhome**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 2 orë/javë = 68 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Muzikë dhome", nxënësi:

- ✓ përvetëson *elementet teknike* dhe *artistike* për këtë grupmoshë (vit shkollor);
- ✓ ekzekuton veprat që kërkon programi muzikor në funksion të trios dhe kuartetit ku bën pjesë;
- ✓ interpreton pjesët muzikore në tempet, reale duke zhvilluar aftësitë krijuese të tij brenda kërkesave teknike artistike.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Muzikë dhome"**

Instrumentet	Repertori muzikor	Orë gjithsej
Piano	**J. Brams - v**allet hungareze 6, 7, 8, për 4 duar. **L. W. Bethoven -** sinfonia nr. 1 klavir për 2 piano.	68 orë
Harqe	**W. A. Moxart** - Pjesë për dy violina. **J**. **Hayden -** kuartet. **W. A. Moxart -** kuartet për harqe. **R. Schuman** - kuartet për harqe. **F. Shubert** - serenatë.	68 orë
Fryma dhe Kitarë	**Domeniko Skarlati** - kuartet vepër e plotë 4-kohëshe 3 fl + piano. **F. Handel** - flaut dhe kitarë. **Bononcini** - sonatë Fl +piano 4 kohe vepër e plotë. **Quantz -** 2 flauta + piano 4 kohë. **H. Klose -** duo klarinetë temë me variacione15 pjesë. **Bërman** - duo klarinetë temë me variacione.	68 orë

3. **UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT**

- ❖ Të punohet në drejtim të njohjes së nxënësve me karakteristikat dhe vlerat e veprave të autorëve përkatës.
- ❖ Të bëhet kujdes për të siguruar frymëmarrjen në funksion të ndërtimit të frazës muzikore.
- ❖ Të punohet hap pas hapi për kultivimin e tingullit në funksion të harmonisë gjatë lojës në ansambël.

4. **VLERËSIMI**

Nxënësit vlerësohen për:

- ➢ realizimin e kërkesave tekniko - muzikore në funksion të përmbajtjes;
- ➢ realizimin e tingëllimit profesional me kërkesa cilësore artistike.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kanto, fizarmonikë, fryma etj.**
Lënda: **Piano sekondare**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Piano sekondare", nxënësi:

- ✓ përvetëson tastierën e pianos dhe notat e zeza dhe të bardha;
- ✓ realizon me dorën e djathtë veç, të majtën veç, ushtrimet fillestare duke ecur paralelisht me solfezhin;
- ✓ koordinon notat që mëson teorikisht në solfezh, me notat në tastierë, duke njohur si fillim dy regjistrat bazë: soprani dhe basi, d.m.th. notat me çelës soli dhe notat me çelës basi;
- ✓ luan në piano ushtrime fillestare me dy duar. Vlerat e notave duhet të jenë të thjeshta 4/4 , 2/4, 3/4, ¼;
- ✓ luan deri në fund të vitit, një etyd, një bach, një sonatinë, një pjesë shqiptare.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano sekondare"**

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Ushtrime	) Ushtrime me dorën e majtë.) Ushtrime me dorën e djathtë.) Tri ushtrime me dy duar.) Ushtrime me 2 duar: Bayer Cherni. **Metoda:** Tomson Lemoir Gnesina	***Nxënësi:*** ➢ njihet me tastierën; ➢ kupton lirshmërinë e krahëve; ➢ mëson pozicionet e duarve në piano; ➢ luan pastër me duar veç.
Bach - Minuet	) Dy Bach - Minuet me dy zëra, maxhor ose minor.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në dy zëra.
Sonatinë	) Dy sonatina - Haslinger, - Pleyel, - Klementi etj.	➢ Organizon një mendim muzikor të rrjedhshëm.
Pjesa nga autorë shqiptarë	) Dy pjesë nga autorët tanë: - G. Avrazi - T. Harapi - F. Ibrahimi - Ç. Zadeja.	➢ Luan pastër ritmet e thyera; ➢ punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit.

Klasa X	
Kontrolle	**Saxho**

teknike	Saxho e parë	Saxho e dytë
Programi në kontroll teknik	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.	***Programi në saxho:*** ➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.
Shënim. Programi përdoret edhe për semestrin e dytë duke zgjedhur veprat sipas nivelit individual të nxënësit. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kanto, fizarmonikë, fryma etj.**
Lënda: **Piano sekondare**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 1 orë/javë = 34 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Piano sekondare", nxënësi:

- ✓ perfeksionon lojën me dy duar;
- ✓ lexon veprën me duar veç e veç;
- ✓ luan duke respektuar aplikaturën dhe ngjyrat që janë shënuar në vepër;
- ✓ luan ushtrimet më shpejt se një vit më parë dhe teknikisht më saktë.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano sekondare", klasa XI**

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë	**2 shkallë** Shkallë Do + (maxhor). Shkalla La - (minor). Sol + (maxhor).	**Nxënësi:** ➢ unifikon duart gjatë luajtjes; ➢ luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha ushtrimet.
Etyde	**Etyde – Cherni** Etyd - Cherni Do + Etyde – Cherni, Bayer, Lemoir.	
Prelud dhe minuet	Bach - Prelud (DV) Bach - Minuet ose prelude (DB) Bach - Prelud + ose -	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në dy zëra; ➢ realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok.
Sonatinë dhe romancë	**Dy pjesë nga autorë të huaj:** - Sonatina - Klementi - Bethoven, - Chimaroz.	➢ Lexon saktë dhe pastër partiturën; ➢ punon për frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor.
Pjesa nga autorë shqiptarë	Dy pjesë nga autorët tanë: - G. Avrazi - T. Harapi - F. Ibrahimi - T. Daija - Ç. Zadeja.	➢ Luan pastër ritmet e thyera; ➢ punon me kujdes për impostim të drejtë të materialit.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll	***Programi në saxho:***	***Programi në saxho:***

teknik	➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.	➢ Ushtrim: Cherni, Bayer. ➢ Bach - Minuet me dy ose tre zëra. ➢ Sonatina – Haslinger, Pleyel, Klementi. ➢ Pjesë shqiptare.
Shënim. Programi përdoret edhe për semestrin e dytë duke zgjedhur veprat sipas nivelit individual të nxënësit. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Duke shpjeguar qartë dhe saktë të gjithë hapat që duhen për arritjen e një niveli të caktuar, pra të kërkesave metodike, shpesh duhen përdorur metoda të ndryshme demonstrimi nga mësuesi, pasi nxënësit kanë arritur një zhvillim të dukshëm psikomotor dhe impostimi natyral mbi tastierë.

Për zbatimin e këtij programi duhet fleksibilitet nga ana e mësuesit, duke punuar dhe demonstruar me nxënësit. Kështu, nxënësi dëgjon konkretisht mësuesin dhe krijon një vizion sa më të qartë të materialit muzikor. Përmes studimit dhe zhvillimit të kësaj lënde, nxënësi kupton më mirë bashkëtingëllimet dhe harmoninë. Në të gjitha veprat që ai do të luajë, do të ndërgjegjësohet për bashkëveprimin e duarve.

4. VLERËSIMI

Gjatë një semestri, nxënësi vlerësohet me tri ose katër nota. Nota e saxhos mblidhet me notat e semestrit dhe mesatarja është nota përfundimtare:

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:
luan jo *korrekt*
me ritëm,
me tingull mesatar,
me intonacion jo të këndshëm,
me shkallë shpejtësie të ulët e
me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:
- **luan *mirë***
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:
- luan ***shumë mirë*** në të gjitha elementet e mësipërm.

10. Programet e lëndës s*ë specialitetit.*

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Piano", klasa X nxënësi:

- ✓ përvetëson elementet tekniko-artistike të programit të përcaktuar për klasën X;
- ✓ realizon shprehitë ekzekutuese, bazë për zhvillimin e aftësisë gjykuese në këtë moshë;
- ✓ luan tek etydet , tingullin dhe frazën e qartë në tempin real të tyre duke rritur aftësitë e veta krijuese;
- ✓ punon për të zhvilluar tingullin dhe organizimin e tij në temp më të shpejtë, duke futur gradualisht të gjitha elementet e teknikës pianistike;
- ✓ realizon leximin aprimavista;
- ✓ luan me ndjenjë dhe emocion programin artistik të përcaktuar.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano"**

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**4 shkallë -** përgjatë vitit (2 për çdo semestër) - Shkalla maxhore ose minore. - Arpezh i shkurtër/i gjatë. - Për shkallët maxhore, arpezhi i dominantës. - Oktava të drejta dhe të thyera (në dy drejtime). - Akorde të mbështetura dhe stakato.	- ***Nxënësi*** realizon: ➢ lojë të pastër; ➢ unifikim të duarve; ➢ temp real dhe të njëjtë për të gjitha përmbysjet; ➢ organizim muzikal; ➢ lirshmëri dhe qëndrim të drejtë.
Etyde	**2 etyde** ose **1 etyd Liszt/Chopin** - C. Czerny - Op. 740. - M. Clementi - gradus ad parnassum. - M. Moszkovski - Op. 72. - Moscheles - Op. 70. - F. Liszt – etyde. - F. Chopin - etyde - op. 10/25. <u>*Shënim.*</u> 8 etyde ose 4 gjatë vitit.	➢ Realizon pastër, teknik-temp-frazim-nuanca; ➢ vendos me kujdes *pedalin* për etydet koncertale Liszt/Chopin.

Pjesë polifonike	**2 pjesë polifonike sipas programit** J. S. Bach - klavir i temperuar mirë (48 prelude dhe fuga). J. S. Bach - partita (1-6). J. S. Bach - suita angleze. G. F. Handel - suita E Dur/c moll. J.-P. Ramon - Gavotte me variacione.	➢ Realizon përmes luajtjes një lojë të pastër; ➢ luan në instrument karakteristikat e karakterit polifonik; ➢ ndjek polifoninë; ➢ realizon me kujdes tingëllimin gjatë luajtjes në instrument; ➢ luan pjesët përmendsh.
Sonatë ose koncert	**1 vepër e plotë +** **1 kohë të veprës** D. Scarlatti - sonata. Ë. A. Mozart - sonata. L. V. Beethoven - sonata. L. V. Beethoven - koncerte (1/2). F. Mendelssohn - koncerte (1/2). B. Bartok – Sonatina. J. S. Bach - koncert E dur/A dur. *Shënim*. 1 kohë të veprës, të ndarë në 2 semestra.	➢ Lexon saktë[B] partitura; ➢ realizon tingullin; ➢ realizon gjatë luajtjes në instrument frazimin; ➢ realizon veprën në stil; ➢ përdor saktë pedalin; ➢ luan bukur muzikalisht.
Pjesë shqiptare	**1 vepër në vit, formë e plotë** Ç. Zadeja - humoreska, monologu. T. Harapi - album pianistik. F. Ibrahimi – tokata. A. Paparisto - romancë, humoreska. L. Dizdari - Peizazh, Valle. *Shënim.* Miniaturë jo më pak se 4 prej tyre, nga i njëjti autor.	➢ Realizon veprën në tingëllim dhe në stil; ➢ luan veprën duke nxjerrë në pah karakteristikat e veprës shqiptare.

[B] Për të qënë sa më afër origjinalitetit të veprës, rekomandohen partiturat që përmbajnë shënimet origjinale të kompozitorit (Urtext).

Vepra të huaja	**1 vepër në vit** - F. Schubert - impromtu op. 94. - F. Schubert - momente muzikale. - F. Mendelssohn - rondo. Capriccioso op. 14. - R. Schumann –fantastike, op. 12. - R. Schumann – romancë, op. 28 nr. 2. - R. Schumann - nuvelette op. 21 nr. 1, 4 dhe 7. - R.Schumann - arabesque op. 18. - F. Chopin - mazurka. - F. Chopin – poloneze. - F. Chopin – nokturne, op. 32/35. - F. Chopin – impromptu. - F. Chopin - fantazi-impromptu. - J. Brahms - balada op.10 nr.1/4. - J. Brahms - rapsodi op.79 nr. 2. - J. Brahms - intermezzo op.117. - C. Debussy - Children's Corner. - C. Debussy - Arabesque nr.1-2. - M. Ravel - Minuet Antik. - M. Ravel - pavane pour une infante défunte. - D. Kabalevsky - 24 prelude. - S. Prokofiev - pjesë pianistike op.12. - S. Prokofiev - 2 sonatina, op. 54. - D. Shostakovich - 3 valle fantastike op.1.	➢ Merr njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme etj.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 2 kontrolle teknike në çdo semestër. ➢ 1 shkallë maxhore të plotë (ose minore). ➢ 2 etyde për çdo kontroll. ➢ 1 etyd koncertal nga Liszt/Chopin.	***Programi në saxho:*** ➢ Vepër polifonike. ➢ Sonatë/koncert (kur ka 1 kohë, sonatë Scarlatti). ➢ Pjesë shqiptare. ➢ Pjesë e huaj. *Shënim*. Ndarja semestrale se kur do të luhet sonata e plotë dhe koha e parë e sonatës, bëhet	***Programi në saxho:*** ➢ Bach. ➢ Sonatë/Koncert. ➢ Pjesë shqiptare (jo, nëse luhet semestrin e parë). ➢ Pjesë e huaj (jo, nëse luhet semestrin e parë).

	nga mësuesi i lëndës.	

Shënim. Gjatë vitit shkollor, nxënësi do të luajë:

2 vepra polifonike, të zgjedhura sipas programit,
1 sonatë të plotë dhe
1 kohë I sonate klasike ose romantike ose kontemporane dhe
1 sonatë Scarlatti,
1 vepër e huaj dhe
1 vepër shqiptare.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Piano", klasa XI, nxënësi:

- ✓ realizon *elementet teknike* dhe *artistike* për këtë grupmoshë (vit shkollor);
- ✓ zhvillon shprehitë teknike, ekzekutuese dhe gjykuese mbi etydet dhe pjesët;
- ✓ realizon më tej cilësinë tingëllore;
- ✓ luan ushtrimet, etydet e pjesët në tempet reale, duke zhvilluar aftësitë krijuese të tij, brenda kërkesave teknike artistike;
- ✓ luan me nivel dhe me kërkesa artistike profesionale programin e përcaktuar.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Piano"**

Detyrim i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	⟩ **4 shkallë të plota,** në 4 mënyra: - *oktavë,* - *tercë,* - *sekstë,* - *deçim.* ⟩ *Arpezhet* i shkurtër, i gjatë dhe *arpezh i D7.* ⟩ *Okavat* drejt dhe *tremolo* në dy drejtime. ⟩ *Akordet* të mbështetura dhe stakato. ⟩ Shkallët *dopio terca* dhe *dopio seksta, legato* e *stakato.* <u>*Shënim*</u>*.* 4 në vit; 2 në çdo semestër.	***Nxënësi:*** ➢ luan shkallët pastër; ➢ unifikon duart gjatë luajtjes; ➢ luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha mënyrat; ➢ luan lirshëm, me qëndrim të drejtë në piano; ➢ ka marrëdhënie të drejtë të përgatitjes së gishtit dhe natyrshmërisë e plastikës së pulsit; ➢ luan shkallët në 4 mënyra; ➢ luan shkallën duke realizuar kërkesat muzikale.
Etyde	**1- 2 etyde në muaj** ⟩ Clementi - Gradus ad parnassum. ⟩ Czerny - Op.740, vol. 3 dhe 4. ⟩ Goedicke - nr.50. vol. I (me oktava). ⟩ Moscheles - etyde.	➢ Luan etydet pastër; ➢ realizon drejt teknikisht impostimin. ➢ realizon etydet në tempet reale; ➢ realizon frazën dhe nuancën muzikalisht; ➢ respekton partiturën duke përdorur me kujdes pedalin.

	⟩ Rachmaninov-etyde, tabllo.op.23, nr.1, 2, 3. ⟩ Moszkovski - 15 etyde op.72 ⟩ Chopin - Op.10; op.25. ⟩ Liszt - etyde trashendentale. ⟩ Debussy - 12 etyde ⟩ Skriabin – etyde, op.2 nr 1; op.8 nr.2, 11. <u>*Shënim.*</u> - Luhen *2 etyde në muaj* nga *Czerny, Clementi, Mosche-les* etj. - Luhet *1 etyd në muaj* nga *Liszt, Chopin, Rachmaninov, Skriabin, Moszkoëski, Debussy* etj.	
Pjesë polifonike	**Dy pjesë polifonike** ⟩ J. S. Bach - klavir i temperuar mirë (prelude e fuga),vol.1 dhe vol.2. ⟩ Partita nga 1 deri 6. Koncert italian. ⟩ G. F. Handel - suita nr.5, E dur, nr.7 D moll.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në polifoni; ➢ realizon lojën në polifoni duke punuar veçmas me secilin zë; ➢ realizon lojën në polifoni duke nxjerrë në pah elementet dalluese të veprës; ➢ realizon tingëllimin, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok; ➢ ka njohuri teorike mbi periudhën dhe stilin; ➢ pasuron njohuritë e tij, duke dëgjuar e mësuar nga ekzekutime të pianistëve botërorë.
Sonatë ose koncert	⟩ D. Scarlatti - sonata ⟩ Ë. A. Mozart - sonata ⟩ Ë. A. Mozart - koncerte ⟩ Ë. A. Mozart - fantazi e sonata C moll. ⟩ L. van Beethoven - sonata,- vol.1, 2. ⟩ L. van Beethoven - koncert nr.1, 2, 3. ⟩ L. van Beethoven - 32 variacione C moll. ⟩ F. Mendelssohn - koncert nr.1, nr.2 ⟩ F. Schubert - sonata A dur; A moll. ⟩ E. Grieg - sonata op.7. ⟩ M. Ravel - sonatina. ⟩ D. Shostakovich - koncert F	➢ Lexon saktë dhe pastër partiturën; ➢ punon në vazhdimësi për tingull me cilësi; ➢ punon me kërkesë për organizimin e veprës në *stil e karakter*, duke pasur të qartë mendimin, për periudhat kur janë shkruar veprat; ➢ punon për *frazim* dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor; ➢ ka njohje të plotë mbi formën e sonatës, karakteristikat e strukturës së saj dhe zhvillimeve harmonike; ➢ koncepton sonatën si një vepër unike, pavarësisht nga karakteret e ndryshme të kohëve të saj; ➢ kryen punë të kujdesshme në përdorimin e pedalit (shpjegohen nga mësuesi ushtrime ndihmëse për këtë qëllim).

	dur. *Shënim.* Nxënësi duhet të luajë 1 sonatë/koncert të plotë, 1 kohë e parë sonate/ koncerti dhe një sonatë scarlatti. (Sonata Scarlatti do të luhet në semestrin që nxënësi do të paraqesë një kohë sonate ose koncerti).	
Pjesë shqiptare	**Një pjesë shqiptare** - Ç. Zadeja - Tokata; Humoreska. Monologu i Arbanit, Prelud A moll. - Tema me variacione. - F. Ibrahimi - tokaka. - T. Harapi - tema me variacione. - Sonatina- rapsodi nr.1. - A. Paparisto - skerco. - P. Vorpsi - variacione. *Shënim.* Pjesa shqiptare duhet të jetë *1* formë e plotë muzikore ose cikël miniaturash jo më pak se 4 prej tyre, nga i njëjti autor.	➢ Luan partiturën saktë; ➢ luan pastër ritmet e thyera (në qoftë se ka); ➢ realizon veprën në tingëllim dhe në karakter.
Pjesë e huaj	**Një pjesë e huaj** ❯ F.Schubert - Impromtus op.142, nr.1, 2. ❯ L. van Beethoven - rondo Kapriçoso op.129. fantazi op.77. ❯ F. Mendelssohn - rondo kapriçoso e dur. ❯ R. Schumann - Intermezo Arabeska op.18; novelette op.21,nr.2,3,5,6,7,8. ❯ Papillon op.2 (fluturat) ❯ Romancë op. 28, nr.1,2,3 ❯ F. Liszt - Consolations; loja e ujit. ❯ F. Chopin Ballada: skerco; nocturne; valse; prelude; tarantela op.43; poloneze op.26 nr.2; variacione brilante op.12. ❯ J. Brahms - rapsodi op.79	➢ Ka njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme etj.; ➢ realizon tingëllimin e këtyre veprave; ➢ luan saktë dhe me emocion; ➢ interpreton muzikalisht programin.

	nr.1,2; ballada op. 10 nr.2. - C. Debussy - prelude libri i parë. - C. Debussy - jardins sous la pluie. - G. Faure - nocturn op.33; op.37; op.97. Impromtus op.31 nr.2; op.34. - Tema me variacione op.73; Vals kapriç op.30. - D. Kabalevsky - prelude op.38. - Sonata op. 46 nr. 3. - D.Shostakovich - 24 prelude op.24. - D.Shostakovich - loja fantastike op.5. - S.Prokofiev - 10 pjesë op.12. - S.Prokofiev - “Tregimet e gjyshes plakë “op.31. - M. Ravel - Le Tombeau de Couperin. - B. Bartok- suita op.14; Improviz op.20. - A. Skriabin -prelude op.11. - Rachmaninov - prelude op.23; op.32. - A. Schoenberg - pjesë për piano op.33.	

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 2 kontrolle teknike në çdo semestër. ➢ Katër shkallë maxhore ose minore të plota. ➢ Tetë etyde teknike ose katër etyde artistike.	***Programi në saxho:*** ➢ Një vepër polifonike. ➢ Një sonatë/koncert. ➢ Një pjesë shqiptare ose ➢ Një pjesë e huaj. <u>*Shënim.*</u> Ndarja semestrale se kur do të luhet sonata e plotë dhe koha e parë e sonatës, bëhet nga mësuesi i lëndës.	***Programi në saxho:*** ➢ Një vepër polifonike. ➢ Një sonatë/koncert. ➢ Një pjesë shqiptare ose një pjesë e huaj. ➢ Një sonatë skarlati.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Piano**
Klasat: XII
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Piano", klasa XII, nxënësi:

- ✓ përfton një formim më të plotë artistik, teorik dhe praktik;
- ✓ luan me një teknikë, ku të gjitha elementet e saj të jenë në funksion të realizimit artistik të veprave;
- ✓ organizon repertorin pianistik që ai/ajo përgatit, duke njohur më mirë epokat për të cilat ka studiuar gjatë viteve;
- ✓ lexon dhe të deshifron në nivel të mirë;
- ✓ njeh format e veprave të cilat ai/ajo interpreton;
- ✓ fiton njohuri në lidhje me periudhat, kompozitorët si dhe me veçoritë që ata kanë në krijimtarinë e tyre;
- ✓ interpreton veprat sipas programit të vitit: etyde, sonata, koncerte, pjesë polifonike etj.
- ✓ luan me ndjenjë dhe emocion programin artistik të përcaktuar.

Detyrim i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	) **2 shkallë të plota,** në 4 mënyra: *oktavë,* *tercë,* *sekstë,* *deçim.*) *Arpezhet* i shkurtër, i gjatë dhe arpezh i D7.) *Okavat* drejt dhe tremolo në dy drejtime.) *Akordet* të mbështetura dhe stakato.) Shkallët *dopio terca* dhe dopio seksta, legato e stakato. <u>*Shënim.*</u> 2 në vit; 1 në çdo semestër.	***Nxënësi:*** ➢ luan shkallët pastër; ➢ unifikon duart gjatë luajtjes; ➢ luan në temp real dhe të njëjtë për të gjitha mënyrat; ➢ luan shkallën me ritëm e temp të shpejtë; ➢ realizon shkallën në të gjitha mënyrat; ➢ luan lirshëm, me qëndrim të drejtë në piano; ➢ luan shkallët në 4 mënyra; ➢ luan shkallët duke realizuar kërkesat me rrjedhshmëri muzikore.
Etyde	**2 etyde koncerti në vit**) Schuman Paganini - Etyde op.3; op.10.) Arensky - Etyde op.36; op.41.) Chopin - Etyde op.10; op.25.) Liszt - Etyde koncerti	➢ Luan etydet pastër; ➢ realizon etydet me cilësi teknike dhe në temp real; ➢ realizon frazën dhe nuancën muzikalisht; ➢ realizon lojën me tingull e linja muzikore të qarta;

	⟩ Moszkovski - Etyde op.72; op.48. ⟩ Saint Saens - 6 etyde op.52. ⟩ Scriabin - Etyd op.12; op.45. ⟩ Rachmaninov-Etyde op.33; op.39. ⟩ Debussy- Etyde:3 - pour les Quartes, 4 - pour les Sixtes, 5 - pour les Octaves, 6 - pour les notes repetees.	➢ respekton partiturën duke përdorur me kujdes pedalin.
Pjesë polifonike	**Dy pjesë polifonike (1 në semestër)** ⟩ J.S.Bach – tokata. ⟩ Koncert italian. ⟩ Klavir i temperuar mirë-prelud-fuga,vol.1 dhe 2. ⟩ Partita D dur; C moll, E moll. ⟩ Fantazi kromatike e fugë. ⟩ Koncert D moll.	➢ Luan pastër veprën; ➢ luan saktë lojën në polifoni; ➢ realizon lojën në polifoni duke punuar me secilin zë; ➢ realizon lojën në polifoni, duke nxjerrë në pah elementet dalluese të veprës; ➢ realizon vazhdimësi të mendimit muzikor (frazimit), duke ruajtur strukturën polifonike të materialit; ➢ realizon me kërkesa impostimin e mjeteve shprehëse, siç janë: aplikatura (lidhjet e shprehjes, stakato, portato), grupet e zbukurimit (trilat, mordentet etj.); ➢ realizon tingëllimet, duke njohur karakteristikat e veprës dhe të stilit barok; ➢ transmeton karakterin e veprës në stilin barok, nëpërmjet marrjes së tingullit; ➢ ka njohuri teorike mbi periudhën dhe stilin; ➢ pasuron njohuritë e tij duke dëgjuar e mësuar nga ekzekutime të pianistëve botërorë; ➢ kryen punë individuale për të rritur fantazinë dhe për t'i dhënë mundësi zhvillimi pavarësisë së mendimit muzikor.
Sonatë ose koncert	⟩ W. A. Mozart- fantazi KV.475. ⟩ Sonata KV.457 C moll. Koncerte. ⟩ L. van Beethoven-sonata vol.1, 2. ⟩ 32 variacione Cmoll. koncert nr.2,3. ⟩ R. Schumann - sonata nr.2,op.22. ⟩ J. Brahms-sonata nr.1,2. ⟩ E. Grieg - Sonata E moll. Koncert op.16. ⟩ Prokofiev-sonata nr.1 D dur. ⟩ Scriabin - sonata op.6 nr.1;	➢ Lexon saktë dhe pastër partiturën; ➢ realizon tingull me cilësi; ➢ realizon veprën në *stil e karakter,* duke pasur të qartë mendimin për periudhat kur janë shkruar veprat; ➢ realizon frazim dhe për qartësi e vazhdimësi të mendimit muzikor; ➢ ka njohje të plotë mbi formën e sonatës, karakteristikat e strukturës së saj, të zhvillimeve harmonike; ➢ luan sonatën të konceptuar si një vepër unike, pavarësisht nga karakteret e ndryshme të kohëve të saj.

	op.19 nr.2; op.23 nr.3; op.30 nr.4. - Mussorgsky - tabllo nga ekspozita. - Mendelssohn - koncert op.25 nr.1. - Kapriço brilante op.22. - B. Britten - koncert op.13 nr.1 - I. Stravinsky - koncert për piano e orkestër. - Gershëin - rapsodi blu. *Shënim.* Një kohë të parë sonate ose koncerti (semestri I). Një sonatë të plotë ose koncert të plotë (semestri II).	
Pjesë shqiptare	**Një pjesë shqiptare** - Ç. Zadeja- tokata; prelud A moll. - Th. Gaqi – suita. - T. Harapi - rapsodi nr.1; Koncert. - Temë me variacione. - F. Ibrahimi - tokata. - P. Gaci - rapsod. - N. Zoraqi - koncert. - K. Lara - rapsodi.	➢ Luan me nivel artistik veprën shqiptare; ➢ luan partiturën saktë; ➢ luan pastër ritmet e thyera (në qoftë se ka); ➢ realizon veprën në tingëllim dhe në karakter; ➢ realizon impostim të drejtë të materialit.
Pjesë e huaj	**Një pjesë e huaj** - R. Schumann - Papillon op.2; Karnavali Vienez op.26. - F. Chopin- Prelud op.28; Nokturne op.27; op.48. Impromtus op.51; op.36. Balla da nr.1, 2. Poloneze op.44. Rondo op.16. Skerco op 31 nr.2. - J. Brahms - pjesë për piano op.76 nr.1; skerco op.4; Rapsodi op.79 nr 1, 2; Inermezo op 116; 117; 118. - E. Grieg - ballada op.24. - F.Liszt - sonetet e Petrarkës nr.2; - Rapsodi hungareze. - C.Frank - prelude Air et Final. - Prelude, Fugue et variacione	➢ Merr njohuri të periudhave, stileve, formave të ndryshme etj.; ➢ realizon tingëllimin e veprave; ➢ luan saktë dhe me emocion; ➢ tregon forcën individuale interpretative, virtuozitetin, duke vënë në funksionim aftësinë krijuese të tij, bashkëngjitur me njohuritë e fituara në vitet e shkollimit; ➢ interpreton muzikalisht programin.

	op.18. - G. Faure - barcarole op.66, nr.5. - Impromtus op.25 nr.1; Vals kapriç op.38, 59, 62. - C. Debussy - suite "Pour le Piano" (Prelude, Sarabande, Toccata). - M. Ravel - sonatina; vals nobles et sentimenntales. - I. Stravinsky - Serenate. - S. Rachmaninov - variacione me një temë të Chopin op.22. - B. Bartok - suitë rumune; suita op.14; allegro barbaro.	

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 2 shkallë maxhore të plotë (maxhore ose minore). - 2 etyde koncerti.	***Programi në saxho:*** ✓ Një vepër polifonike. ✓ Kohë e parë sonatë (ose koncert). ✓ Një vepër (formë e madhe) romantike ose kontemporane. <u>*Shënim.*</u> Ndarja semestrale se kur do të luhet sonata e plotë dhe koha e parë e sonatës, bëhet nga mësuesi i lëndës.	***Programi në saxho:*** ✓ Një vepër polifonike. ✓ Sonatë/koncert të plotë. ✓ Pjesë shqiptare. ✓ (Formë e madhe muzikore).
<u>*Shënim.*</u> Gjatë vitit shkollor, nxënësi do të luajë: *2 vepra polifonike, të zgjedhura sipas programit,* *1 sonatë e plotë dhe* *1 kohë I sonate klasike ose romantike ose kontemporane,* *1 sonatë Scarlatti,* *1 vepër të huaj,* *1 vepër shqiptare.*		

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është vazhdimësi e punës së nxënësit dhe mësuesit përgjatë arsimit bazë (AMU). Përmes studimit dhe zhvillimit të këtyre programeve rritet cilësia interpretative në të gjitha veprat që nxënësi do të studiojë dhe do të luajë.

Klasa X për nxënësin sjell ndryshimin e ciklit dhe, për këtë arsye, puna e mësuesit konsiston në faktin që nxënësi të jetë i përgatitur për të shprehur në mënyrë individuale, duke bashkëpunuar me mësuesin gjatë procesit mësimor, për realizim e veprës muzikore. Në këtë klasë, me formimin e tij tekniko-artistik, nxënësi duhet të jetë në gjendje të luajë, të organizojë dhe të interpretojë veprat sipas programit të vitit:

- *etyde,*
- *sonata,*
- *koncerte,*
- *pjesë polifonike etj.*

Gjatë këtij viti shkollor, nxënësi duhet të luajë në 4 kontrolle teknike dhe 2 saxho. Në çdo kontroll teknik, nxënësi do të luajë:

- 1 shkallë maxhore të plotë (ose minore) ku shkalla muzikore do të përcaktohet nga grupi i mësuesve, dhe do të jetë e njëjtë për të gjithë nxënësit e klasës përkatëse.
- 2 etyde teknike ose 1 etyd koncerti. Edhe etydet do të caktohen nga mësuesi, sipas programit mësimor.

Gjatë vitit shkollor, nxënësi do të luajë:

- vepra polifonike, të zgjedhura sipas programit;
- 1 sonatë të plotë;
- 1 kohë të parë sonate klasike, ose romantike, ose kontemporane;
- 1 sonatë scarlatti;
- 1 vepër të huaj;
- 1 vepër shqiptare.

Klasa XI është vazhdimësi e punës së nxënësit dhe mësuesit, për të rritur cilësinë interpretative në të gjitha veprat që nxënësi do të studiojë dhe do të luajë. Gjatë këtij viti, nxënësi merr njohuri më të plota nëpërmjet lëndëve formuese teorike, të cilat i japin mundësi të konceptojë më mirë e më qartë, formën muzikore të veprës që do të ekzekutojë. Gjithashtu, nxënësi duhet të mësojë të njohë e të dallojë lëvizjet harmonike në vepër, të cilat i japin mundësi të ekzekutojë me qartësi në stil.

Gjatë **klasës XII,** nxënësi/ja duhet të luajë në 2 kontrolle teknike dhe 2 saxho. Në çdo kontroll teknik, nxënësi do të luajë:

- shkallë maxhore të plotë, si dhe përkatësen e saj.
- 2 etyde koncerti.

Gjatë vitit shkollor, nxënësi do të luajë:

- 2 vepra polifonike të zgjedhura sipas programit;
- 1 sonatë/koncert të plotë;
- 1 kohë të parë sonate/koncert klasik(e), ose romantik(e), ose kontemporane;
- 1 vepër të huaj;
- 1 vepër shqiptare.

Gjatë 3 viteve, nxënësi/ja merr njohuri më të plota nëpërmjet lëndëve formuese teorike, të cilat i japin mundësi të konceptojë më mirë e më qartë formën muzikore të veprës që do të ekzekutojë.

Shënim. Për të qenë sa më afër origjinalitetit të veprës, rekomandohen partiturat që përmbajnë shënimet origjinale të kompozitorit (Urtext), siç janë botimet Henle Verlag ose Schott-Ëienner Urtext për kompozitorët gjermanë dhe botimet Boosey & Haëkes ose Sikorski për kompozitorët rusë.

4.VLERËSIMI

Gjatë procesit mësimor, nota është kompetencë e mësuesit. Vlerësimi i nxënësit në kontroll teknik dhe saxho bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria e shkollës. Në saxho (e kontrolle teknike) pjesëmarrja e mësuesve që kanë nxënës në klasën përkatëse, është e detyruar. Vlerësimi do të bëhet nga nota 1 (një) deri në notën 10 (dhjetë). Vlerësimi me 4 (katër) nuk është kalues.

Në rastet kur nxënësi paraqet justifikim (për arsye të ndryshme), për të mos shlyer detyrimet vjetore, merret vendim nga drejtoria e shkollës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo *korrekt:*

- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët,
- me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan *mirë:*

- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion,
- pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violinë**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Violinë", nxënësi:

- ✓ realizon programin sipas përzgjedhjes së mësuesit, bazuar në programin e lëndës;
- ✓ luan lirshëm para publikut;
- ✓ luan me pastërti intonative;
- ✓ luan me qartësi mendimi në frazim;
- ✓ luan veprat me emocion;
- ✓ ka arritje kualitative në tingull;
- ✓ krijon një performancë në interpretim ku të spikasin edhe elemente të individualitetit;
- ✓ ekzekuton me instrument para publikut pa partiturë;
- ✓ luan me intonacion të pastër dhe me tingull të bukur;
- ✓ realizon qartësi mendimi në lojë duke frazuar bukur;
- ✓ realizon teknika të ndryshme në materialin që luan;
- ✓ interpreton emocionalisht çdo material që luan;
- ✓ arrin një performancë në interpretim ku të spikasë individualiteti;
- ✓ ekzekuton para stafit pedagogjik dhe para publikut pa partiturë;
- ✓ ekzekuton me koncepte të qarta tekniko-pedagogjike;
- ✓ realizon një lojë emocionale të argumentuar me frazë.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"**

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Materiale teknike ndihmëse	) Shefcik op. 2, op. 3, op. 8, op. 9 Shradik.) Iftinki, ushtrime gishtash.) Dancla, shkolla e teknikës moderne.	***Nxënësi:*** ➢ Luan materialet me qëllim formimin sa më të mirë teknik të nxënësit për të mbushur mangësitë.
Shkallë muzikore	**8-10 shkallë maxhore e minore**) Me 7 arpezhet.) Dopio-akordet përkatëse (terca, seksta, oktava), sipas metodave Alard, Gregorian Flech.	➢ Luan pjesët muzikore pastër; ➢ luan me progresion ritmik dhe figurativ; ➢ luan dopio-akordet me intonacion të pastër dhe tingull të qartë; ➢ realizon tempin e ngadaltë me

		temp brilant.
Etyde ose kapricio	**10-12 etyde** nga autorët: - Kreutzer. - Mazas (fl. II) op. 36. - Dancla. - Fiorillo: 36 etyde. - Rode: 24 kapricio op. 22. - Wieniavski: etyde për 2 violina, op. 18 etj.	➢ Luan përmendsh etydet dhe pjesë të tjera; ➢ realizon mirë teknikisht dhe muzikalisht etydin apo kapriçon; ➢ ka nocione të qarta në frazimin logjik; ➢ luan në tempet e duhura.
Sonata paraklasike ose klasike	**1 sonatë e plotë** - Hendel: sonata nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6. - Tartini. - Vivaldi. - Corelli "La Foglia", - Vitali "Ciacona". - Bach me 6 sonata për violinë e piano. - Moxart sonata për piano e violinë etj.	➢ Njeh karakterin e veprës në stilin dhe epokën e autorit; ➢ punon për arritjen e një tingulli të pastër; ➢ realizon për vibraton sipas karakterit të veprës; ➢ realizon për dinamikën; ➢ luan me piano që në fillim të materialit, në rast se kemi sonata të Mozartit.
Koncerte ose vepër ciklike	Autorët: - Hayden: do+. - Moxart: Koncertet. - Bach: mi+. - Teleman: 12 fantazi për violinë solo. - Beriot: nr. 1, nr. 2. - Lipinski: koncert. - Shpor: nr. 2, nr. 7, nr. 8. - Rode: nr. 6, nr. 8. - Kreutzer: nr. 13, nr. 18, nr. 19. - Mendelson: koncert në Mi -. *Shënim.* Një koncert të plotë me 3 kohë, të shpërndara ose jo në 2 semestra.	➢ Realizon programin në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuara; ➢ ushtrohet për arritje tekniko-muzikore nëpërmjet: ➢ *frazimit,* ➢ *karakterit teknik,* ➢ *zbërthimit emocional;* ➢ performon në piano si instrument shoqërues;

Pjesë nga autorë të huaj e shqiptarë - bravurë klasike, romantike ose kontemporane	Dy pjesë bravura nga autorët: - Beethven - Moxart - Kraisler - Ëeiniavski - Novocek - Paganini - Sarasate - Cajkovski - Dvorak - Mendelson - Bela-Bartok etj. - P. Gaci - A. Peci - T. Daija - Paparisto etj.	➢ Përgatitet për daljen në publik; ➢ realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore; ➢ ndjen personalitetin e vet në lojë; ➢ transmeton emocioneve që transmeton.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik(2: - 1 shkallë maxhore ose minore me arpezhet dopio kordet (terca, seksta, oktavë). - 2-3 etyde ose kapriçio nga lënda e programit.	***Programi në saxho:*** - Sonatë (2 kohë). - Koncerti, koha I ose kohët II-III. - Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësit.	***Programi në saxho:*** - Sonatë (2 kohë). - Koncerti, koha I ose kohët II-III. - Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësit.
Shënim: 1 kapriçio Weiniavski ose Paganini është i barabartë me 2 etyde. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violinë**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme

Shkallë muzikore	**8-10 shkallë maxhore e minore**
	- 7 arpezhet dhe dopio-akordet përkatëse (terca, seksta, oktava) të autoreve
	  ✓ Alard,
	  ✓ Gregorian,
	  ✓ Flech etj.
		Nxënësi:
		➢ luan me të gjitha kriteret e kërkuara në vitin paraardhës duke i pasuruar ato me cilësitë e:
		✓ tingullit,
		✓ legatos,
		✓ brilancës së tempit dhe anës virtuoze.

Etyde ose kapriçio	**10-12 etyde** nga autorët: - Kreutzer: 42 etyde, - Mazas (fl. II-III), - Dancla: etyde, op. 73, - Fiorillo: 36 etyde, - Rode: 24 kapriçio, op. 22, - Wieniavski: shkolla moderne, op. 10, - Kampanjoli 7 Divertimente, - Paganini: 24 kapriçio, op. 1, - Dont: 24 kapriçio, op. 35.	➢ Luan përmendsh etydet apo kapriçiot; ➢ realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet dhe kapriçiot; ➢ luan pastër dhe me frazim logjik; ➢ respekton dinamikën; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ perfermon artistikisht në përfundim të çdo etydi.
Bach: Sonata dhe partita për violinë solo	**2 kohë kontraktuese** nga: - Partita e J. S Bach për violinë solo.	➢ Realizon teknikat e lojës së Bachut, ku spikasin teknika e akordeve, legatos, detaches (me kombinime harkatash); evidentimi i linjave dhe i zërave kryesorë etj., e cila kërkon një bashkëveprim me ndërgjegje të teknikave të të dyja duarve.
Sonata paraklasike ose klasike (vepër ciklike)	**1 sonatë të plotë me 3 ose 4 kohë të ndara:** - Hendel: sonata për violinë e piano (6 sonata), - Tartini: sonata, - Vitali: "Ciacona", - Bach me 6 sonata për violinë e piano,	➢ Realizon karakterin, e pjesës; ➢ realizon tingull të pastër gjatë lojës; ➢ realizon vibraton sipas karakterit të pjesës;

	⎫ Moxart: sonata për piano e violinë, ⎫ Bethoven: sonata për piano e violinë.	➢ realizon dinamikën; ➢ ushtrohet në piano si element partneriteti (sonata e Moxartit, Bethovenit).
Koncerte ose vepër ciklike	Autorët: ⎫ Moxart: koncertet. ⎫ Bach: koncert Mi+. ⎫ Bach: koncert me 2 violina në RE-. ⎫ Rode: koncertet Nr. 6, Nr. 8, ⎫ Shpor: koncertet Nr. 2, Nr. 7, Nr. 8. ⎫ Lipinski: koncert. ⎫ Viotti: koncert Nr. 22. ⎫ Teleman: fantazi për violinë solo. ⎫ Beriot: koncert Nr. 1, 2. ⎫ Kreuzer: koncert Nr. 13, 19. ⎫ Mendelson: koncert në Mi-. ⎫ E. Lalo: simfoni espanjole. ⎫ M. Bruch: koncert në Sol-. ⎫ Ëeiniavski: koncert Nr. 2. *Shënim*. Një koncert të plotë të shpërndarë ose jo në 2 semestrat.	➢ Realizon programin në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuara nga mësuesi; ➢ kupton formën muzikore nga ana kompozicionale; ➢ realizon veprën me të gjithë komponentët teknikë e muzikorë; ➢ luan pjesën muzikore me ekspresivitet dhe temperament; ➢ zhvillon individualitet në ekzekutimin e materialit.
Pjesë nga autorë të huaj e shqiptarë - bravurë klasike, romantike ose kontemporane	Dy pjesë bravura të ndara nga 1 në semestër, nga autorët: ⎫ Moxart. ⎫ Beethoven. ⎫ Kraisler. ⎫ Weiniavski. ⎫ Sen Sans. ⎫ Sarasate. ⎫ Paganini. ⎫ Novocek. ⎫ Cajkovski. ⎫ Dvorak. ⎫ Bela-Bartok. ⎫ Bloch. ⎫ Stravinski. ⎫ Shimanovski Prokofier. ⎫ P. Gaci. ⎫ T. Daija. ⎫ A. Peci. ⎫ C. Zadeja. ⎫ Th. Gaqi etj.	➢ Përgatitet për daljen në publik; ➢ realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore; ➢ zhvillon personalitetin e vet në lojë; ➢ transmeton përmes lojës emocionet.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 1 shkalle maxhore ose minore me arpezhet dopio- kordet (terca, seksta, okta). - 2-3 etyde ose kapriçio nga lënda e programit.	***Programi në saxho:*** - Sonatë (2 kohë) ose Bach (2 kohë). - Koncert, koha I ose kohët II-III. - Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësit.	Programi në saxho: - Sonatë (2 kohë) ose Bach (2 kohë). - Koncerti koha I ose kohët II-III. - Pjesë bravura sipas nivelit të nxënësit.
Shënim: 1 kapriçio Weiniavski ose Paganini është i barabartë me 2 etyde. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violinë**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1.**Përmbajtjet tematike të lëndës "Violinë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	**8-10 shkallë maxhore e minore** - Deri në 6 shenja shartimi, me 7 arpezhe dopio-akorde (terca, seksta, oktava, decima) sipas metodave Flech, Galamian,	**Nxënësi:** ➢ Realizon teknikisht e ritmikisht shumë mirë, duke arritur një nivel gjithnjë e në rritje të: ✓ tingullit, ✓ legatos, ✓ intonacionit etj.
Etyde ose kapricio	**6 etyde ose kapriçio** nga autorët: - Kreutzer - 42 etyde. - Rode - 24 kapricio, op. 22. - Dont - 24 kapricio. - Ëeiniavski - shkolla moderne, op. 10. - Paganin - 24 kapricio, op. 1.	➢ Luan përmendsh; ➢ realizon saktë teknikisht dhe muzikalisht etydet ose kapriçiot; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ luan me dinamikë të qartë; ➢ performon në mënyrë artistike; ➢ realizon 1 kapriçio nga: Weiniavski ose ➢ Paganinit që është i barabartë me 2 etyde te Kreutzer, Dont, Rode.
Bach: Sonata dhe partita për violinë solo	**2 kohë kontrastuese** - nga 3 sonatat ose - 3 partita për violinë solo - J. S. Bach-u.	➢ Realizon materialin duke arritur të kuptojë dhe dëgjojë zërat e veçantë dhe shkrirë ato në funksion të idesë; ➢ realizon shumë mirë elementet e teknikës së violinës dhe cilësinë e tingullit.
Sonatë klasike, romantike ose kontemporane	**1 sonatë të plotë me përmasa të mëdha** nga autorët: - Mozart - sonatat për piano e violinë. - Bethoven - sonatat për piano e violinë.	➢ Realizon sonatën brenda semestrit; ➢ realizon në një shkallë më të lartë elementet koncertale tekniko – muzikale; ➢ luan me kritere shumë të qarta të stilit dhe karakterit të veprës.
	Një koncert të plotë nga autorët: - Mendelson: koncert në Mi-	➢ Realizon programin në përputhje me etapat e punës

Koncert klasik ose kontemporan	⟩ Moxart: koncertet në La+, Sol+ etj. ⟩ Weiniavski: koncert në Re-nr. 2. ⟩ Bruch: koncert në Sol-. ⟩ E. Lalo: simfoni espanjole. ⟩ Gllazunov: koncert. ⟩ Hacaturian: koncert. ⟩ Prokofiev etj.	praktike të përcaktuara nga mësuesi; ➢ kupton formën muzikore nga ana kompozicionale; ➢ realizon veprat me të gjithë komponentët teknikë e muzikorë; ➢ luan pjesët muzikore me ekspresivitet dhe temperament; ➢ krijon individualitet në ekzekutimin e materialit.
Pjesë nga autorë të huaj e shqiptarë - bravurë klasike, romantike ose kontemporane	**2 bravura nga autorët:** ⟩ Moxart. ⟩ Bethoven. ⟩ Kraisler. ⟩ Sarasate. ⟩ Weiniavski. ⟩ Cajkovski. ⟩ Dvorak. ⟩ Prokofiev. ⟩ Bela-Bartok. ⟩ Sen Sans. ⟩ Bloch. ⟩ Shimanovski. ⟩ Stravinski etj. **1 pjesë nga autorët shqiptarë:** ⟩ A. Paparisto. ⟩ P. Gaci. ⟩ T. Daija. ⟩ N. Zoraqi. ⟩ A. Peci. ⟩ Th. Gaqi etj.	➢ Përgatitet për daljen në publik; ➢ realizon performancë artistike, duke i harmonizuar saktë elementet tekniko-muzikore; ➢ krijon personalitetin e vet në lojë; ➢ është krijues nëpërmjet emocioneve që transmeton.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 1 shkallë maxhore ose minore me 7 arpezhet e dopio-kordet përkatëse të shkallës (terca, seksta, oktava). - 2 etyde ose një nga kapriçiot të barasvlershme me 2 etydet.	***Programi në saxho:*** - Sonatë e plotë klasike, romantike ose konteporane. - Moxart koncertet La+, Re+, Sol+ me kadencë, koha I. - Pjesë bravura me dëshirë.	***Programi në saxho:*** - Bach: 2 kohë kontrastuese nga partitat ose sonatat për violinë solo. - Një kohë nga sonata klasike ose kontemporane ose, në mungesë të sonatës, koha I e një prej koncerteve të Moxartit La+, Re+, Sol+ me kadencë. - Koncert koha e I ose e II-III. - Pjesë bravura nga autorë të huaj. - Pjesë shqiptare.
Shënim. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano.		

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Duke qenë se nxënësit në ciklin e mesëm vijnë nga arsimi bazë(AMU), mjaft probleme të aparatit fizik, intonacionit, teknikës dhe interpretimit emocional janë përmbushur. Problemi kryesor që del në pah në **klasën X,** është njohja e nxënësit në mënyrë më të detajuar me stilet e ndryshme muzikore, të cilat ai do t'i hasë gjatë interpretimit të tij, p.sh,: njohja me stilin paraklasik, barok, klasik, romantik etj. Kjo duhet të arrihet me anë të dëgjimit të këtyre veprave në CD ose të dëgjimi i tyre përmes internetit. Mirë është që nxënësi të dëgjojë muzikë klasike dhe paraklasike në mënyrë sistematike. Arritja e një intonacioni perfekt dhe teknik të pëlqyeshëm, është e domosdoshme që nxënësi të studiojë çdo ditë ushtrimet e gishtave, shkallët, si dhe etydet, sidomos studim të detajuar duhet të kërkohet për momentet polifonike, si tek etydet dhe materialet ciklike (sonata, koncerte). Nxënësi duhet të lexojë mjaft mirë aprimavista dhe këtë duhet të arrijë nga leximi i shumë partiturave, në mënyrë që të jetë i aftë të luajë me orkestër ose ansambël muzikor.

Një aspekt shumë i rëndësishëm i perceptimit të veprave muzikore nga ana e nxënësit është dhe demonstrimi i tyre nga mësuesi. Me anë të këtij ballafaqimi, nxënësi krijon idenë e përgjithshme të stilit, të tempeve, të mënyrës emocionale në realizimin e veprës muzikore.

Gjithashtu, nxënësi mund t'i dëgjojë veprat në fonoteka të ndryshme ose t'i sigurojë ato përmes internetit. Gjithmonë nxënësi duhet të jetë përzgjedhës (seleksionues) në zgjedhjen e

interpretuesve të këtyre veprave, të cilët duhet të jenë interpretues shumë të mirë të veprave të autorëve vendës ose të huaj.
Një mënyrë shumë efikase dhe kontemporane e të studiuarit është "memories practice", ose punimi individual i nxënësit, pa instrument, vetëm me partiturën. Një mënyrë e tillë studimi e njeh më mirë nxënësin me veprën, formën e ndërtimit të saj, harmoninë, si dhe ndihmon në përvetësimin përmendsh të veprës në një kohë më të shkurtër.

4.VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan *jo korrekt*
  - me ritëm,
  - me tingull mesatar,
  - me intonacion jo të këndshëm,
  - me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë* ritmikisht, me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violë**
Klasat: X
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatete e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Violë", nxënësi:

- ✓ realizon sipas të gjitha kërkesave programin teknik dhe programin e veprave ciklike;
- ✓ deshifron përmes leximit muzikor veprat kontemporane;
- ✓ luan në instrument, duke ruajtur pastërtinë e pasazheve teknike, sidomos tek etydet dhe kadencat e koncerteve;
- ✓ interpreton, duke realizuar stilet, dhe duke i luajtur ato me origjinalitet individual;
- ✓ kupton karakteristikat e veprave romantike realizon gjatë luajtjes interpretim artistik;
- ✓ materializon elementet teknike dhe muzikale në interpretimin instrumental;
- ✓ konsolidon shprehitë ekzekutive dhe aftësitë artistike;
- ✓ zhvillon organizimin e lojës, duke u mbështetur në lirshmërinë e aparatit fizik, si dhe në intonacionin e pastër;
- ✓ lexon materialin muzikor "a primavista";
- ✓ luan veprat me tempet e kërkuara, si dhe realizon të gjitha elementet e teknikës së instrumentit të violës;
- ✓ studiojë në mënyrë sistematike etydet me elemente polifonike, të cilat janë ndihmesë për polifoninë e suitave të Bahut, si dhe të kadencave të koncerteve;
- ✓ zhvillon tingullin, duke realizuar në mënyrë korrekte vibratorin;
- ✓ përsos në mënyrë cilësore interpretimin;
- ✓ mundëson rritjen e sensibilitetit muzikor gjatë interpretimit;
- ✓ përsos lojën artistike, duke iu përmbajtur kërkesave të stilit dhe të dhënave të partiturës, por duke rritur aftësitë e veta krijuese.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Violë", klasa X (102 orë)**

Detyrimi i programit	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	**4 shkallë muzikore maxhore dhe minore**	**Nxënësi:** ➢ realizon teknikisht shkallën; ➢ luan rregullisht ushtrime gishtash.
Etyde	**10 etyde** nga: ❯ "Shradik" ❯ "Shevcik" ❯ "Kreytizer" W. I ❯ "Campagnoli" ❯ "Carse" nr. 3	➢ Realizon teknikisht etydet. ➢ respekton tempet e kërkuara; ➢ interpreton në mënyrë artistike.
Bach	❯ Suitë nr. 1 ❯ "Prelud"	➢ Interpreton stilin barok.

	⟩ "Alumannde" ⟩ "Corrente" ⟩ "Sarabande" ⟩ "Minuette" ⟩ "Gigue"	
Sonatë të plotë	⟩ "Eccles" ⟩ Sonatë në Re minor ⟩ Marcello - Sonatë Sol minor ⟩ Vivaldi - Sonatë Si b maxhor.	➢ Interpreton mirë stilin paraklasik; ➢ realizon një tingull të qartë dhe të pastër nga ana e intonacionit.
Koncert	⟩ Handeshkin - Koncert Do maxhor ⟩ Teleman – Koncert ⟩ Zelter - Koncert Mi b maxhor.	➢ Realizon stilin klasik. ➢ respekton tempet dhe ngjyrat artistike; ➢ zhvillon brenda veprës aftësitë individuale krijuese.
Bravura	⟩ Schumann – "Ëndërrim" ose "Këngë pa fjalë" etj.	➢ U përmbahet stileve të ndryshme të autorëve.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ⟩ 10 etyde.	***Programi në saxho:*** ⟩ Bach (3 kohë). ⟩ Sonatë ose 3oncert 3 ose 4 kohë. ⟩ Bravurë.	***Programi në saxho:*** ⟩ Bach (3 kohë) ⟩ Sonatë ose koncert 3 ose 4 kohë. ⟩ Bravurë.
Shënim. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano. mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violë**
Klasa : **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

2.1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Violë",

Detyrimi i programit	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**4 shkallë** - Shkallë maxhore dhe minore. - Me arpezhe, terca dhe oktava . - Nga "Flesh", sistemi i shkallëve maxhore.	Nxënësi: ➢ realizon teknikisht shkallën. ➢ realizon intonacionin tek tercat dhe oktavat; ➢ luan rregullisht ushtrime gishtash.
Etyde	**10 etyde** nga: - "Shradik" - "Shevcik" - "Hofmeister" - "Kreutzer", VI+II.	➢ Realizon teknikisht etydet; ➢ respekton tempet; ➢ interpreton artistikisht etydet; ➢ realizon siç duhet etydet me dopio akorde.
Bach	- Suitë nr.2 – Bach, kohët: - prelud. - Corrente. - Allemande. - Sarabande. - Minnette. - Gigue.	➢ Studion stilin barok; ➢ studion pjesët me polifoni; ➢ realizon një interpretim korrekt me ritmet e duhura të suitës.
Sonatë të plotë	- A. Vivaldi. - A. Korrelli - sonata dhe kamera. - Telleman - sonatë në La minore.	➢ Realizon stilin paraklasik; ➢ realizon qartësinë e tingullit.
Koncert	- Hoffmeister - koncert. - Hayden - koncert në sol maxhor.	➢ Studion stilin klasik; ➢ realizon interpretim të saktë të partiturës.
Bravura	- Paparisto – romancë. - Skënderi -melodi popullore.	➢ Luan me karakter veprat.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: - 10 etyde të ndara në 4 kontrolle teknike	***Programi në saxho:*** - Bach (3 kohë). - Sonatë ose koncert. - Bravurë.	***Programi në saxho:*** - Bach (3 kohë). - Sonatë ose koncert. - Bravurë.
Shënim. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano. mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violë**
Klasat: XII
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

Përmbajtjet tematike të lëndës "Violë"

Detyrimi i programit	**Repertori muzikor**	**Kërkesat për nxënësin**
Shkallë muzikore	**2 shkallë:** ✓ maxhore dhe minore, ✓ nga "Flesh".	Nxënësi: ➢ realizon shkallën në mënyrë të përsosur teknikisht dhe në drejtim të intonacionit.
Etyde	♪ **Etyde** nga: - Kreytzer. - Derit. - Palashko.	➢ Realizon në mënyrë profesionale etydet, sidomos ato polifonike.
Bach	♪ Suitë nr. 3 - Bach: - Prelud. - Allemande. - Gigue. - Sarabande. - Corente.	➢ Interpreton me mjeshtëri suitën e Bachut, me të gjitha kërkesat teknike e muzikale.
Sonatë të plotë	M. Glinka - Sonatë Re minor. F. Shubert - Arpegiona. A. Moxart - Sonatë minore. Vitali - Ciacone.	➢ Luan, duke vënë në pah karakteristikat e stilit romantik, sidomos te sonata Re minor e Glinkës.
Koncert	Shtamitz - Koncert Re maxhor A. Moxart - Koncert La maxhor. Hayden - Koncert Do maxhor.	➢ Përsos lojën interpretative në drejtim teknik dhe emocional.
Bravura	Shuman - Nokturn.	➢ Realizon gjatë lojës stilin romantik.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
➢ 2 shkallë maxhore ose minore. ➢ 4 etyde në 2 kontrolle.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (3 kohë). ➢ Sonatë /koncert. ➢ Bravurë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (3 kohë). ➢ Sonatë /koncert. ➢ Bravurë.
Shënim. Repertori luhet përmendsh dhe me shoqërim në piano. mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Duke qenë se nxënësit në ciklin e mesëm vijnë nga arsimi bazë (AMU) mjaft probleme të aparatit fizik, intonacionit, teknikës dhe interpretimit emocional, janë kapërcyer. Problemi kryesor që del në pah në klasën X është njohja e nxënësit në mënyrë më të detajuar me stilet e ndryshme muzikore, të cilat ai do t'i hasë gjatë interpretimit të tij, p.sh.: njohja me stilin paraklasik, barok klasik. Kjo duhet të arrihet me anë të dëgjimit të këtyre veprave në CD, ose dëgjimit të tyre përmes internetit. Mirë është që nxënësi të dëgjojë muzikë klasike dhe paraklasike në mënyrë sistematike. Për arritjen e një intonacioni të përsosur dhe një teknike të pëlqyeshme, është e domosdoshme që nxënësi të studiojë çdo ditë ushtrimet e gishtave, shkallët, si dhe etydet, sidomos studim të detajuar duhet të kërkohet për momentet polifonike, si tek etydet dhe te materialet ciklike (sonata, koncerte). Nxënësi duhet të lexojë mjaft mirë a primavista dhe këtë duhet të arrijë te leximi i shumë partiturave, në mënyrë që të jetë i aftë të luajë me orkestër ose ansambël muzikor. Një aspekt shumë i rëndësishëm i perceptimit të veprave muzikore nga ana e nxënësit është dhe demonstrimi i tyre nga mësuesi. Me anë të këtij ballafaqimi, nxënësi krijon idenë e përgjithshme të stilit, të tempeve, të mënyrës emocionale në realizimin e veprës muzikore.

Gjithashtu, nxënësi mund t'i dëgjojë veprat në fonoteka të ndryshme ose t'i sigurojë ato përmes internetit. Gjithmonë nxënësi duhet të jetë seleksionues në zgjedhjen e interpretuesve të këtyre veprave, të cilët duhet të jenë interpretues shumë të mirë vendës ose të huaj. Një mënyrë shumë efikase dhe kontemporane e të studiuarit është " "memories practice" ose punimi individual i nxënësit, pa instrument, vetëm me partiturën. Një mënyrë e tillë studimi, e njeh më mirë nxënësin me veprën, formën e ndërtimit të saj, harmoninë, si dhe bën përvetësimin përmendësh të veprës në një kohë më të shkurtër.

Gjatë mësimit të instrumentit violë, një praktikë interesante është edhe ballafaqimi i një fragmenti të luajtur nga nxënësi me instrumentin e violës me luajtjen e të njëjtit fragment nga mësuesi në instrumentin e pianos. Me anë të kësaj praktike, nxënësi arrin të qartësojë dhe të pastrojë intonacionin e tij. Rol shumë të rëndësishëm luan bashkëpunimi i nxënësit me mësuesin shoqërues të pianos. Ky bashkëpunim do të jetë vendimtar në diplomën e fundit për nxënësin.

Duke qenë se programi i nxënësit të klasës XII është mjaft i rënduar dhe i gjatë në kohë, është e rekomandueshme të alternohet studimi fizik me dëgjimin muzikor të veprave në CD ose internet. Gjithashtu, "masterklasat" e organizuara në Akademinë e Arteve kanë rezultuar shumë të suksesshme me nxënësit e këtyre klasave, pasi ata kanë përvetësuar përvojën më të mirë didaktike të pedagogëve vendës dhe të huaj.

4.VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt:*
- me ritëm,
- me tingull mesatar,
- me intonacion jo të këndshëm,
- me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë:*
- ritmikisht,
- me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violonçel/çello**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. **Rezultatet e pritshme:**

Në përfundim të mësimit të lëndës " Çello" nxënësi:

- ✓ përvetëson elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;
- ✓ realizon kalimin e pozicioneve, mënyrën e rregullt të lojës së shkallëve (lojën me kërkesë impostimi dhe intonacioni të tercave, sekstave dhe oktavave);
- ✓ ka kontrollin e llojeve të ushtrimeve që ka bërë në ciklin 9-vjeçar, duke i plotësuar ato që eventualisht nuk i ka bërë;
- ✓ luan me agjilitet dhe një vibrato të rregullt dhe të vazhdueshme, duke realizuar një kantilene me njëllojshmërinë e zërit;
- ✓ reagon në ndjeshmërinë muzikore, nuancat, muzikalitetin dhe të paraqitet në sasinë dhe në radhitjen e gjithë repertorit të detyrueshëm, si sonata, koncerte apo pjesë;
- ✓ përvetëson teknikën e dorës së djathtë, duke përvetësuar kolpet më të përdorshme të harkut, si: *stakato, stakatisimo, portato, sotie*, si dhe forma të tjera nga më të ndryshmet të ligaturave;
- ✓ luan me një potencë tingulli më të plotë përmes studimit, si tërheqja e harkut me nota të gjata në tela bosh apo nëpërmjet notave kromatike me vibrato të pandërprerë;
- ✓ luan me ekspresivitet pjesët muzikore duke përdorur një shumëllojshmëri të vibratos dhe të gjitha llojet e saj: të shpejtë, të imët, intensive etj.;
- ✓ angazhohet në jetën koncertale, tashmë që nxënësi ka formuar një shije të tij muzikore, dhe logjikon më shumë ndaj elementeve tekniko-muzikore që karakterizon një vepër;
- ✓ njeh me detaje veprat që luan, në të njëjtën kohë të njohë dhe partin e pianos, duke respektuar me rigorozitet nuancat dhe dinamikën e çdo të dhëne që ka partitura;
- ✓ lexon aprimavista partiturën;
- ✓ luan me një formim si instrumentist, duke i paraprirë kësisoj dhe elementeve kryesore të interpretimit;
- ✓ përsos shprehitë muzikore;
- ✓ realizon një lojë të gjallë, dinamike, me nuancë, duke u futur në stilin, brendinë dhe në karakteristikat e veçanta që ka vepra;
- ✓ sinkronizohet me pianistin shoqërues në raportin sonor që kërkohet;
- ✓ fiton një siguri dhe një lirshmëri natyrore në lojë;
- ✓ njeh veprat në tërësinë e saj, epokat muzikore, kërkesat ndaj rrymave të ndryshme të muzikës, asaj paraklasike, klasike, romantike apo kontemporane etj.;
- ✓ ushtrohet për përgatitjen e diplomës.

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Çello"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallët muzikore	**4 shkallë** maxhore, minore, arpezhe, terca, seksta,	***Nxënësi:*** ➢ realizon teknikisht ➢ shkallën; ➢ luan me tingull të ➢ plotë e të pastër; ➢ luan rrjedhshëm dhe

	oktava.	➢ shkathët; ➢ kriojn pavarësinë e ➢ duarve dhe bashkëveprimin e tyre.
Etyde	**8-10 etyde** nga Shevçik - Ushtrime ndihmëse: - Poper - Grutzmajer - Docauer - Sadlo - Fitzenhagen.	➢ Luan në tempin e duhur; ➢ realizon aplikaturën e etydit; ➢ përvetëson më mirë mënyrën e vendosjes në "capo-taste" të dorës së majtë; ➢ luan me intonacion të pastër sidomos etydet dyzanore.
Bach	Suita I ose II.	➢ Respekton aplikaturat ➢ që janë të vendosura; ➢ realizon linjat e zërave dhe të arrijë unifikimin e tyre; ➢ realizon legaton e mirë nëpërmjet kthesave të harkut.
Sonatë	⎫ Hendel - sonatë Fa + ⎫ Boccherini - sonatë Do + ⎫ H"ervelois ⎫ Koreli: temë me variacione.	⎫ Realizon për tingull të ⎫ pastër e të kultivuar; ⎫ njeh stilet përkatëse të autorëve; ⎫ realizon vibraton e vazhdueshme dhe të rregullt në funksion të karakterit të sonatës; ⎫ kultivon shijen artistike.
Koncert	⎫ Romberg: Re + ⎫ Golterman: La – ⎫ Sen-Sans: La – ⎫ Hajden: Do +	➢ Realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht; ➢ studion përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira' ➢ realizon mirë strukturën e veprës; ➢ realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor.
Pjesë shqiptare dhe bravura të huaja	⎫ R. Sokoli ⎫ Y. Skënderi ⎫ A. Paparisto ⎫ Poper ⎫ Çajkovski ⎫ Ç. Zadeja	➢ Realizon veprat nga ana teknike dhe emocionale; ➢ realizon karakteret përkatëse; ➢ luan duke krijuar individualitetin e vet.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho I	**Saxho II**
Programi në kontroll teknik: ➢ Një shkallë të plotë me (arpezhe, terca, seksta,	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert.

oktava). ➢ 2 deri në 3 etyde.	➢ 1-2 pjesë.	➢ 1-2 pjesë.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violonçel/Çello**
Klasat: XI
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Çello", klasa XI

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallët muzikore	**4-6 shkallë** - maxhore-minore - arpezhe, - terca, - seksta, - oktava - me aplikacione të ndryshme.	***Nxënësi:*** ➢ luan me tingull të njëjtë në pjesën e poshtme të tastierës; ➢ luan e të përvetësojë mirë ndërrimin e telit dhe kthesat e harkut; ➢ luan në definicionin e tyre.
Etyde	**8-10 etyde** nga autorët: - Shevçik- ushtrime për dorën e djathtë, - Ficenhagen, - Duport, - Poper, - Merk - Franchom: etyde ose kapriçio, - Piatti: etyde ose kapriçio.	➢ Realizon kolpet e ndryshme të harkut; ➢ realizon një intonacion të pastër sidomos në dy zanore; ➢ luan në ritëm e precizion; ➢ realizon melodikisht etydet muzikore.
Bach	⎫ Suita II ose III (e tëra e ndarë në dy semestra).	➢ Realizon sa më mirë gjatë lojës ndjeshmërinë e gishtit në tel; ➢ ndan qartë frazat dhe frymëmarrjet; ➢ bën dallimin e karaktereve të ndryshme të çdo kohë (valleje).
Sonatë	⎫ Koreli: variacione. ⎫ Bethoven: sonatë nr.2. ⎫ Boelman:, variacione.	➢ Zbaton me përpikëri partiturën sipas orientimit të mësuesit; ➢ zbërthen nga ana teknike sidomos kohët e shpejta; ➢ plotëson lojën e vet me shprehitë interpretative; ➢ luan me kërkesa maksimale artistike, duke i kushtuar rëndësi dinamikës.
Koncerte	**Koncerte** nga autorë: - Golterman: La- - Sen- Sans: La- - Boccherini: Si bemol maxhor - Lalo: Re -	➢ Zbërthen pasazhet teknike më të vështira; ➢ qartësohet për mënyrat e ndryshme të studimit; ➢ realizon më së miri elementet artistike të veprës; ➢ luan me temperament, të transmetojë emocion;

		➢ realizon lojë brilante.
Pjesë të huaja dhe shqiptare	- Foure - Skënderi - Paparisto - Sokoli - Dvorzhak - Shuman - Bach - Rimski-Korsakov	➢ Realizon veçoritë interpretative që ka çdo pjesë; ➢ përsos elementin e virtuozitetit; ➢ krijon personalitetin e tij artistik; ➢ performon në publik.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Një shkallë të plotë me arpezhe, terca, seksta, oktava. ➢ 2 deri në 3 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Violonçel/Çello**
Klasat: XII
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

Përmbajtjet tematike të lëndës "Çello"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallët muzikore	**2-3 shkallë** - maxhore ose minore arpezhe. - terca - seksta - oktava me aplikatura të ndryshme.	Nxënësi: ➢ luan në perfeksion intonativ; ➢ luan me saktësi e tingull të njëjtë; ➢ luan rrjedhshëm dhe shkathët.
Etydet	Poper Duport Piatti: etyde ose kapriçio. Franchom: etyde ose kapriçio.	➢ Zbërthen në mënyrë individuale çdo pasazh teknik; ➢ trajton etydet nga ana muzikore; ➢ rrit shprehitë virtuoze e interpretative sidomos te kapriçiot.
Bach	Bach: suitat 2 ose 3. Reger: suita e parë.	➢ Koncepton strukturën muzikore; ➢ luan me rigorozitet aplikaturat e dhëna, të cilat shërbejnë për realizimin sa më të mirë të mendimit muzikor; ➢ përsos akordet nga ana intonative e interpretative.
Sonata	Breval Grig Bethoven: La+ Brams: Mi- Shubert: arpezhione	➢ Qartësohet për ndërtimin muzikor të veprave; ➢ realizon gjendjen emocionale nga njëra kohë në tjetrën; ➢ përfiton vibrato të llojeve të ndryshme sipas veprave përkatëse; ➢ luan me shije të hollë artistike; ➢ konsolidon intuitën muzikore në prova me piano.
Koncerte	Lalo: Re- Hajden: Do + Hajden: Re + Boccherini: si bemol + Çajkovski:variacione "Rococo".	➢ Realizon zbërthimin teknik dhe etapat e punës praktike që duhet të bëjë; ➢ njeh formën muzikore; ➢ organizon mirë lojën në tërësi pa anashkaluar detajet; ➢ realizon partin e pianos.
Pjesët shqiptare dhe të huaja	Boccherini - rondo R. Dhomi - rondo Foure - elegji Y.Skënderi - këngë popullore T. Harapi - këngë.	➢ Përsos elementin virtuoz; ➢ realizon vetë veprën nga ana e mendimit ideoartistik; ➢ performon në skenë.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Një shkallë të plotë me arpezhe, terca, seksta, oktava. ➢ 2 deri në 3 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach (2-3 kohë). ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë.

Klasa X është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë (AMU) në atë të mesëm të lartë (AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

Klasa X është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave **X-XII.** Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë nxënësi:

- ✓ *procesi i njohjes;*
- ✓ *procesi i përvetësimit;*
- ✓ *procesi i interpretimit.*

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpeve të harkut, për zgjidhjen e vibratos së kultivuar si elemente artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e nxënësit për të përcaktuar programin që nxënësi do të luajë në provimin e vitit.

Klasa XII është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 12-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumëvjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

4.VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan *jo korrekt*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,

me intonacion jo të këndshëm,
me shkallë shpejtësie të ulët e
me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë*
ritmikisht,
me tingull e me intonacion,
pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kontrabas**
Klasat: X
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. Rezultatet e pritshme:
Në përfundim të mësimit të lëndës " Kontrabas", nxënësi:

- ✓ realizon elementet teknike dhe të ketë një pozicion normal të duarve;
- ✓ realizon kalimin e pozicioneve, mënyrën e rregullt të lojës së shkallëve;
- ✓ asimilon problemet e agjilitetit, të ketë një vibrato të rregullt dhe të vazhdueshme për të realizuar një kantilene me njëllojshmërinë e zërit;
- ✓ zhvillon ndjeshmërinë muzikore, nuancat, muzikalitetin dhe të paraqitet në sasinë dhe në radhitjen e gjithë repertorit të detyrueshëm, si sonata, koncerte apo pjesë;
- ✓ luan me një potencë tingulli më të plotë përmes studimit, si tërheqja e harkut me nota të gjata në tela bosh apo nëpërmjet notave kromatike me vibrato të pandërprerë;
- ✓ luan me ekspresivitet pjesët muzikore, duke përdorur një shumëllojshmëri të vibratos, dhe të gjitha llojet e saj: të shpejtë, të imët, intensive etj.;
- ✓ angazhohet në jetën koncertale, pasi ka formuar një shije të tij muzikore dhe logjikon më shumë ndaj elementeve tekniko-muzikore që karakterizon një vepër;
- ✓ njeh me detaje veprat që luan, në të njëjtën kohë njeh dhe partin e pianos, duke respektuar me rigorozitet nuancat dhe dinamikën e çdo të dhëne që ka partitura;
- ✓ lexon aprimavista partiturën;
- ✓ luan me një formim si instrumentist, duke i paraprirë kësisoj dhe elementeve kryesore të interpretimit;
- ✓ përsos shprehitë muzikore;
- ✓ realizon një lojë të gjallë, dinamike, me nuancë, duke u futur në stilin, brendinë dhe në karakteristikat e veçanta që ka vepra;
- ✓ sinkronizohet me pianistin shoqërues në raportin sonor që kërkohet;
- ✓ fiton një siguri dhe një lirshmëri natyrore në lojë;
- ✓ realizon veprat në tërësinë e tyre, epokat muzikore, kërkesat ndaj rrymave të ndryshme të muzikës, asaj paraklasike, klasike, romantike apo kontemporane etj.;
- ✓ realizon diplomën.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kontrabas"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	**Shkallë muzikore** ❯ shkallë maxhore ose minore; ❯ harmonike melodike; ❯ me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she; ❯ tempi 60, harkata të ndryshme.	Nxënësi: ➢ realizon teknikisht shkallën; ➢ luan me tingull të plotë e të pastër; ➢ luan rrjedhshëm dhe shkathët; ➢ krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre.

Etyde nga metoda teknike	) I. Bille - Metodë për kontrabas a 4 e 5 corde (ricordi).) *"Primo corso"*, fq. 92, duke njohur pozicionet dhe shkallët sipas pozicioneve maxhore, minore, arpezh, dhe relativet e tyre.) *"Secondo corso"*- Ushtrimet 1-9 me të gjitha variantet.) Rabbath - "New technique" – vëllimi I.) Ë. Sturm - "110 etyde për kontrabas", vëllimi 2, nr. 1, 2, 3, 5, 6, 13, 35, 47, 56, 59, 60, 80, 83.) F. Simandl, "30 etyde", fashikulli I. ***Shënim.*** Sasia e etydeve do të jepet në varësi të nivelit të nxënësve.	➢ Luan në tempin e duhur; ➢ realizon aplikaturën e etydit; ➢ luan me intonacion të pastër etydet.
Program artistik	) S. Sans - pjesë të vogla.) F. Boaden - petite suitë.) Giovannin - adagio, ballo, sarabanda, nga Sonata në La minore.) Schlemuller - minuet.	➢ Realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht; ➢ studion përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira; ➢ njeh dhe realizon strukturën e veprës; ➢ realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor; ➢ zbërthen veprat nga ana teknike dhe emocionale; ➢ evidenton karakteret përkatëse; ➢ luan duke krijuar individualitetin e vet.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ 1 shkallë maxhore dhe minore, harmonike melodike, me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she, tempi 60, harkata të ndryshme. ➢ Ushtrimet nr. 68, 74, 78, 83 nga "Primo corso metodo	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.

Bille”. ➢ Ushtrimet nr. 47, 56, 59, 83 nga Ë. Sturm, 110 etyde.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kontrabas**
Klasat: XI
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kontrabas"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë dhe arpezhe** mbi bazë pozicionesh: ❖ maxhore e minore dhe lidhja e tyre relative; ❖ shkallë maxhore ose minore; ❖ me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she ; ❖ Tempi 60, harkata të ndryshme.	**Nxënësi:** ➢ realizon teknikisht shkallën. ➢ luan me tingull të plotë e të pastër. ➢ luan rrjedhshëm dhe ➢ shkathët. ➢ krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre.
Metoda teknike	) Bille - Metoda "Primo corso" deri te pozicioni i shtatë, faqe 91.) Bille - Metoda "Secondo corso", të gjithë kapitujt.) Simandl, fashikulli i parë dhe i dytë.) Metoda "Primo corso pratico", nga fq. 51 deri në fund.) A. Slama - etyde.) Sturm -110 etyde, op. 20 , nga numrat: - 4 - 22, - 38,40, 48 - 53 - 58, - 61 - 65, - 82, 84 ,87, 88, - 95, 96, 99, 107.	➢ Luan në tempin e duhur; ➢ realizon aplikaturën e etydit; ➢ luan me intonacion të pastër etydet.
Program artistik	) Giovaninno - sonata në la minore për kontrabas e piano. - sonata në fa maxhore.) M. Dare - Gavota.) B. Hummel - sonatina për	➢ Realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht; ➢ realizon përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira; ➢ njeh mirë strukturën e veprës;

	kontrabas e piano. J T.Pitfield - sonatina për kontrabas e piano.	➢ realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor; ➢ zbërthen veprat nga ana teknike dhe emocionale; ➢ evidenton karakteret përkatëse; ➢ luan duke krijuar individualitetin e vet.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho I	**Saxho II**
Programi në kontroll teknik: ➢ 1 shkallë maxhore dhe minore, harmonike melodike, me arpezh relative deri në pozicionin 4 e 1/2 me nota 4-she, tempi 60, harkata të ndryshme. ➢ Ushtrimet nr. 111, 117, 123, 125 nga "Primo corso metodo Bille". ➢ Ushtrimet nr. 28, 54 , 55, 84, 95, 99 nga W. Sturm, op. 20.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kontrabas**
Klasat: XII
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Kontrabas"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë dhe arpezhe** mbi bazë pozicionesh: ⎫ maxhore e minore dhe lidhja e tyre relative; ⎫ 2 oktave me figura e variante të ndryshme sipas: Sturm, Bille, Simandl etj.	***Nxënësi:*** ➢ realizon teknikisht shkallën; ➢ luan me tingull të plotë e të pastër; ➢ luan rrjedhshëm dhe shkathët; ➢ krijon pavarësinë e duarve dhe bashkëveprimin e tyre.
Metoda teknike	⎫ Bille - Metoda për kursin e 3-të dhe për kursin e 4-t normal. ⎫ Bille - Metoda e 4-t, kurs plotësues, fq. 7-24. ⎫ F. Simandl - "New method" vëllimi i 2-të deri fq. 18. ⎫ Sturm -110 etyde, op. 20. Mund të zgjidhen rreth 20 etyde nga numrat: - 17, 18, 21, 26, 28, 29, - 32, 33, 34, 36, 37 - 42, 43, 45,46,49,50,51,57, - 62, 63, 64, 66, 76, 77, 86, 89, 90, - 92, 93, 100, 106, 108, 109.	➢ Luan në tempin e duhur; ➢ realizon aplikaturën e etydit; ➢ luan me intonacion të pastër etydet.
Programi artistik	⎫ J.S. Bach - gavota për kontrabas dhe piano. ⎫ H. Genzmer - sonatina. ⎫ Andersen - sonatina. ⎫ Marcello - 6 sonata. ⎫ P. Breuer - sonatina. ⎫ A. Kapuzzi - Koncert në Re maxhore. ⎫ G. Jacobs - "A little concert".	➢ Realizon veprën teknikisht dhe muzikalisht; ➢ realizon përmes mënyrave të ndryshme për pasazhet e vështira; ➢ njeh strukturën e veprës. ➢ realizon lojën e organizuar nga ana e mendimit muzikor; ➢ zbërthen veprat nga ana teknike dhe emocionale; ➢ evidenton karakteret përkatëse; ➢ luan duke krijuar individualitetin e vet.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ 1 shkallë maxhore minore, harmonike e melodike, me arpezhe e relativet me figura e variante të ndryshme. ➢ Bille III corso dhe nga Simandl fashikulli I, fq. 85-95 dhe fashikulli II, fq. 96-102. ➢ Sturm – ushtrime, nr. 32, 42, 43, 64, 76, 77, 105, 108.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.	***Programi në saxho:*** ➢ Bach: 2-3 kohë. ➢ Sonatë ose koncert. ➢ 1-2 pjesë.

2. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e nivelit sa më të lartë, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës në të cilën kanë hyrë.

Klasa X është një vit i rëndësishëm, pasi nxënësi kalon nga arsimi bazë (AMU) në atë të mesëm të lartë(AML). Këtë vit ora e mësimit duhet të ketë intensitet, të mos bëhet monotone, po të zgjojë interes te nxënësi. Koncepti i veprave hyn në një fazë të re. Duhet këmbëngulur në kultivimin e shijeve të sakta të lojës. Pas studimit të ngadaltë, nxënësi duhet nxitur për të luajtur (manovruar) më shpejt me materialet, por gjithnjë pa e tepruar dhe nën kontrollin e mësuesit, me perspektivën drejt vetëkontrollit. Nxënësi duhet të ndërgjegjësohet e të perceptojë me siguri të lartë atë çfarë ai prodhon. Të nxitet për të performuar në skenë.

Klasa XI është një urë lidhëse mjaft e rëndësishme midis klasave X-XII. Mësuesi duhet të këmbëngulë në elementet bazë, që duhet të njohë nxënësi:

- ✓ *procesi i njohjes;*
- ✓ *procesi i përvetësimit;*
- ✓ *procesi i interpretimit.*

Pas një studimi mekanik, vazhdon puna për kualifikimin e tingullit, për zgjidhjen e kolpeve të harkut, për zgjidhjen e vibratos së kultivuar si elemente artistike. Mësuesi/ja duhet të ketë një komunikim të mirë me nxënësit, duhet të njohë aftësitë e tyre për të përcaktuar programin që ata do të luajnë në provimin e vitit.

Klasa XII është viti kur nxënësit mbyllin ciklin e një pune 12-vjeçare dhe përgatiten për shkollën e lartë. E gjithë puna shumëvjeçare synon në formimin e plotë me dijet e aftësitë tekniko-muzikore dhe ideoartistike. Element i rëndësishëm i kësaj faze është ruajtja e konsolidimi i nivelit të arritur. Nxënësit nuk duhet të heqin dorë nga ushtrimet ditore, pavarësisht nga rritja që kanë. Mësuesit duhet të programojnë orën e mësimit në mënyrë të tillë që të dëgjojnë në çdo orë mësimi repertorin mekanik të nxënësit. Demonstrimi në instrument nga mësuesit është i domosdoshëm për të konkretizuar problemet që dalin. Nxënësit duhet të ballafaqohen me skenën dhe nxënësit e tjerë, duke organizuar koncerte ose orë mësimi në grup.

4. VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan *jo korrekt*
  - me ritëm,
  - me tingull mesatar,
  - me intonacion jo të këndshëm,
  - me shkallë shpejtësie të ulët e me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë*
  - ritmikisht,
  - me tingull e me intonacion, pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Kitarë", nxënësi:

- ✓ realizon programin e përzgjedhur nga mësuesi (bazuar në programin e lëndës);
- ✓ ka impostim të saktë të duarve;
- ✓ luan saktë tempet e pjesëve;
- ✓ realizon teknikat përkatëse të materialeve që luan;
- ✓ deshifron vetë programet nga ana ritmike;
- ✓ realizon elementet tekniko-artistike të programit të përcaktuar për klasën e 10-të;
- ✓ realizon shprehitë ekzekutuese, bazë për zhvillimin e aftësisë gjykuese në këtë moshë;
- ✓ realizon etydet tingullin dhe frazën e qartë në tempin real të tyre duke rritur aftësitë e veta krijuese;
- ✓ përpiqet për të zhvilluar tingullin dhe organizimin e tij në temp më të shpejtë, duke futur gradualisht të gjitha elementet e teknikës së kitares;
- ✓ interpreton saktë tirando;
- ✓ luan rrjedhshëm apojando;
- ✓ përvetëson shprehitë ekzekutuese;
- ✓ krijon një performancë ku të spikasë edhe individualiteti i tij;
- ✓ luan saktë stilet muzikore;
- ✓ luan me nota të lidhura dhe të mbajtura;
- ✓ luan saktë teknikisht dhe muzikalisht;
- ✓ luan me tingull të qartë dhe me nota të mbajtura;
- ✓ pickon qartë mbi telat e kitares;
- ✓ luan në të gjitha pozicionet e kitarës;
- ✓ luan rrjedhshëm aprimavista;
- ✓ zhvillon anën emocionale gjatë lojës në programin artistik të përcaktuar;
- ✓ luan me një tingull të qartë dhe të bukur.

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	**8 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet).) Ushtrime teknike. **Metoda:** Mauro Giuliani, Ruggero Chiesa, Abel Carlevaro	***Nxënësi:*** ➢ realizon teknikisht shkallën, dhe me nota të lidhura; ➢ realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë; ➢ luan me progresion ritmik dhe figurativ.

	Mauro Storti Julio Sagreras etj.	
Etyde	Metoda M.Carcassi op 60(25 etyde). - Metoda Sor & Coste(Chiesa) - Metoda Aguado. - Metoda Julio Sagreras - Metoda Carulli (Arr. Chiesa). - Metoda Giuliani(Arr.Chiesa) etj.	➢ Realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ luan përmendësh. ➢ realizon figurat ritmike; ➢ luan tingull të lidhur; ➢ luan pozicionet në kitare.
Kohë nga suitat **Paraklasike**	**1-2 Kohë** nga suitat: - Bach - Sanz - De visee - Milan etj.,	➢ Luan në tempin dhe stilin e duhur; ➢ ndien zërat dhe linjat polifonike; ➢ realizon gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit; ➢ luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira.
Sonatinë, Sonatë ose një pjesë të periudhave të ndryshme stilistike si : Paraklasike,klasike,romantike,konterporane *<u>Shenim:</u>* *Pjesa të jepet sipas dëshirës së mësuesit,duke u bazuar në një nga periudhat stilistike të mësipërme.Sonata të luhet një vetëm një kohë.*	- Scarlati - Giuliani - Paganini - Diabeli - Carcassi - Carrulli - Sor - Tarrega - Etj.	➢ Luan në tempin dhe stilin e duhur sipas epokës; ➢ dallon frazat dhe zhvillimin e tyre; ➢ respekton shenjat dinamike; ➢ realizon impostim të saktë.
Vepër ciklike (klasike)	**Temë me variacion, koncert ose suitë** - F.Sor, - M.Giuliani - A.Diabelli - M. Carcassi, - F.Carrulli A.Vivaldi, Gragranji etj.	➢ Realizon tempet e kohëve te koncertet; ➢ njeh ndërtimin dhe tempet e variacioneve tek temat me variacione; ➢ ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi; ➢ realizon kërkesat tekniko-muzikore përmes *frazimit, karakterit teknik dhe zbërthimit emocional*.

Bravura romantike ose kontemporane	**2 bravura** nga autorë, si: F.Tarrega, J.Ferrer, A.Barrios J.Sagreras *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th.Assimakopulos*	➢ Luan në stilet dhe tempet e duhura; ➢ realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo bravure; ➢ luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze; ➢ ndjen personalitetin e tij në lojë.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 4 kontrolle teknike përgjatë vitit. ➢ 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. ➢ 2 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite. ➢ 1-kohë sonatë,sonatin ose pjesë nga periudha stilistike të ndryshme. ➢ Vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite. ➢ 1-kohë sonatë,sonatinë ose pjesë nga periudha stilistike të ndryshme. ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	**8 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet).) Ushtrime teknike. **Metoda:** Mauro Giuliani Ruggero Chiesa Abel Carlevaro Mauro Storti Julio Sagreras etj.	Nxënësi: ➢ luan shkallët me apojando dhe tirando në të gjitha mënyrat; ➢ realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e Barres dhe të Flazholetës; ➢ realizon kalimet deri në pozicionin e 12-të.
Etyde ose kapriçio	- Metoda M.Carcassi op 60(25 etyde). - Metoda Sor & Coste(Chiesa) - Metoda Aguado. - Metoda Julio Sagreras - Metoda Carulli (Arr. Chiesa). - Metoda Giuliani(Arr.Chiesa) etj.	➢ Realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet; ➢ ndjen frazimet; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ luan me një tingull të qartë dhe brilant.
Kohë nga suitat **paraklasike**	**1-2 kohë** (kontrastuese) nga suitat: - Bach, - Sen Sanz, - Roncall, - R.De Vise etj.	➢ Luan në stilin e duhur; ➢ dallon tempet e kohëve të ndryshme të suitave; ➢ luan duke mbajtur notat në formë pedali; ➢ dallon qartë linjat e zërave.
Sonatinë, Sonatë ose një pjesë të periudhave të ndryshme stilistike si : Paraklasike,klasike,romantike,konterporane.	- Scarlati - Giuliani - Paganini - Diabeli - Carcassi - Carrulli	➢ Luan në stilin e duhur sipas epokës; ➢ luan bukur emocionalisht dhe me dinamikën e duhur.

	- Sor - Tarrega - Etj *<u>Shënim:</u>* *Pjesa të jepet sipas dëshirës së mësuesit nga periudhat stilistike të mësipërme.Sonata të luhet një kohë për Saxho.*	
Vepër ciklike (klasike)	**2 vepra të plota ciklike:** M.Giuliani, F.Carulli , F. Sor M.Carcassi etj.	➢ Njeh formën dhe ndërtimin harmonik të veprës që luan; ➢ realizon stilin e autorit; ➢ dallon tempet e ndryshme brenda veprës; ➢ realizon individualitetin e tij në lojë; ➢ luan me një tingull brilant dhe i përshtatet lojës dinamike të veprës.
Bravura romantike ose kontemporane	**2-3 bravura** nga autorë, si: F.Tarrega V.Llobos L.Brouwer J.Sagreras J.Ferrer etj. *<u>Shënim</u>: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th.Assimakopulos*	➢ Luan në mënyrë virtuoze duke përfshirë elementet teknike dhe artistike; ➢ luan saktë për sa i përket dinamikës kontrastuese sidomos te bravurat kontemporane; ➢ luan duke i përcjellë publikut (në saxho) emocionet e tij të brendshme.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 4 kontrolle teknike përgjatë vitit. ➢ 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore. ➢ 2 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suitë. ➢ 1kohë sonatë,sonatinë ose pjesë e periudhave të ndryshme stilistike . ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suitë. ➢ 1kohë sonatë,sonatinë ose pjesë e periudhave të ndryshme stilistike ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Materiale ndihmëse teknike	**4 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). - Ushtrime teknike. **Metoda:** Mauro Giuliani Ruggero Chiesa Abel Carlevaro Mauro Storti F.Tarrega etj.	Nxënësi: ➢ luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi; ➢ përsos sa më mirë materialin duke iu përgjigjur një pasazhi të vështirë.
Etyde	**Etyde** koncertale: - Leo Brouëer - Villa Lobos - M.Carcassi - F.Sor - M.Giuliani - Etj *Shënim:* *Nga Brouwer të luhen 5 etyde,sipas mendimit të mësuesit dhe nivelit të nxënësit.*	➢ Realizon tekni-kisht etydet; ➢ luan në ritmet dhe tempet e duhura; ➢ luan me kont-rastet dinamike; ➢ luan me kujdes aksentet.
Kohë nga suitat **paraklasike**	**2 - 3 kohë** nga suitat: - J.S.Bach - G.Sanz - R.de Visse etj.	➢ Luan në stilin e Bahut; ➢ realizon strukturës polifonike të kohëve të suitës; ➢ luan me nota dhe tinguj të zgjatur; ➢ luan ndryshimin e tempeve për secilën kohë të suitës.
Vepër ciklike, si: **- Temë me variacione** **- Koncert ose** **- Suitë**	**2 vepra ciklike të plota** nga: - F.Sor, - M.Giuliani - L.Legniani etj.	➢ Interpreton stilin e autorit që do të luajë; ➢ performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.
Bravura	**2-3 bravura** nga autorë, si: - I.Albeniz	➢ Njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë;

klasike **romantike apo** **kontemporane**	- J.Ferrer - V.Llobos - A.Barios - F.Tarrega etj. *Shënim: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th.Assimakopulos*	➢ performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale; ➢ transmeton emocione; ➢ ndjen individualitetin e tij në lojë.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 2 kontrolle teknike në vit. ➢ 4-5 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite . ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite . ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.

4. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësi i **klasës X,** duhen pasur parasysh disa hapa që bëjnë të mundur realizimin e programit, si: zgjedhja e materialeve teknike dhe artistike nga mësuesi për secilin nxënës (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).

Programi do të ndahet në 3 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Për arritjen e një niveli sa më të mirë të nxënësit të **klasës XI,** mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit. Programi do të ndahet në **3 orë** mësimi. Mësuesi duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale. Në këtë klasë, prioritet do t'u jepet teknikave të apojandos, tirandos, si dhe 12 pozicioneve në kitarë (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur si paraprijëse e provimit të diplomës.

Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Në klasën XII, nxënësi duhet të arrijë të deshifrojë vetë pa vështirësi gjithë programin e zgjedhur nga mësuesi. Mësuesi duhet të punojë me nxënësin me pasazhet e veçanta (aty ku nxënësi shfaq vështirësi). Prioritet të veçantë do t'i jepet performancës artistike, në mënyrë që nxënësi të realizojë sa më mirë programin e diplomës dhe të përgatitet për përballjen me publikun.

Në klasën XII nxënësi do të shlyejë vetëm 2 kontrolle teknike dhe saxhon e semestrit të parë.

Rekomandime për kontrollet teknike

- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike.
- Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar 2 shkallë (mazhore-minore, terca,oktava,) me të gjitha mënyrat, si dhe 2 etyde.
- I gjithë programi luhet përmendsh.

Rekomandime për saxhot

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho .

Në çdo saxho luhet në mënyrë të detyruar:

- 1-2 kohë suite Bach, Sanz,Milan,Visee,Ëeis etj. (paraklasikë).
- 1 kohë sonatinë,sonatë ose pjesë nga periudha të ndryshme stilistike.(paraklasike ose klasike,romantike etj).
- 1 vepër ciklike, si: Temë me variacione ose koncert (klasike).
- 1 bravura (klasike, romantike, kontemporane).

I Gjithë programi luhet përmendësh.

5. VLERËSIMI

- Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).
- Vlerësimi do të jetë nga notat e vendosura për materialet që luan nxënësi.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi i nxënësit në saxho do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta).
- I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.
- Vlerësimet e nxënësve do të diskutohen nga anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur *:*

- ka lëvizje me ritmin;
- ka pickim të dobët dhe tingull mesatar;
- luan me intonacion jo të këndshëm;
- nuk ka qartësi në lojë;
- luan me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur*:*

- luan mirë ritmikisht;
- luan me tingull e me intonacion;
- luan pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* ritmikisht;

- luan me tingull te qartë dhe të lidhur;
- luan përmëndësh dhe pa gabime;
- interpreton dhe luan me ndjeshmëri pjesët.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë - fillestar**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **Klasa XII (34 x 4 orë/javë =136 orë)**

1.Synimet e lëndës

Në përfundim të mësimit të lëndës "Kitarë", nxënësi duhet të:

- ✓ ketë realizuar programin e përzgjedhur nga mësuesi (bazuar në programin e lëndës).
- ✓ ketë impostik të saktë të duarve.
- ✓ dallojë tonalitetin e pjesëve dhe të njohi shenjat në armaturë.
- ✓ luajë saktë tempet e pjesëve.
- ✓ jetë i përgatitur për teknikat përkatëse të materialeve që luan.
- ✓ arrijë të deshifrojë vetë programet nga ana ritmike.
- ✓ interpretojë saktë tirando.
- ✓ luaj saktë stilet muzikore.
- ✓ luajë saktë teknikisht dhe muzikalisht.
- ✓ luajë me tingull të qartë dhe me nota të mbajtura.
- ✓ pickojë qartë mbi telat e kitares.
- ✓ njohë të gjitha pozicionet e kitarës.
- ✓ zhvillojë anën emocionale gjatë lojës në programin artistik të përcaktuar.
- ✓ luajë me një tingull të qartë dhe të bukur.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë", klasa X (144 orë)

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	**Shkallë muzikore** të metodës Segovia ose Ruggero Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). ⟩ Ushtrime teknike. **Metoda:** Julio Sagreras, Mauro Giuliani, Ruggero Chiesa, Abel Carlevaro, Mauro Storti, etj.	**Nxënësi:** ➢ Realizon teknikisht shkallën, dhe me nota të lidhura; ➢ realizon të gjitha mënyrat e dorës së djathtë, dhe të respektojë gishtat e dorës së majtë; ➢ luan me progresion ritmik dhe figurativ.
Etyde	⟩ Metoda M.Carcassi op 60(25 etyde). - Metoda Sor & Coste(Chiesa) - Metoda Aguado. - Metoda Julio Sagreras - Metoda Carulli (Arr. Chiesa).	➢ Realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ luan përmëndësh; ➢ realizon figurat ritmike; ➢ luan tingull të lidhur.

	- Metoda Giuliani(Arr.Chiesa) etj.	
Kohë nga suitat **Paraklasike**	**1 Kohë** nga suitat: - Bach - Sanz - De visee - Luis Milan etj.	➢ Luan në tempin dhe stilin e duhur; ➢ ndien zërat dhe linjat polifonike; ➢ kupton gjatë luajtjes në instrument vazhdimësinë dhe rrjedhshmërinë e tingullit; ➢ luan ushtrime gishtash për pasazhet e vështira.
Vepër ciklike (klasike)	**Temë me variacion, Rondo, Capriccio** - F.Carrulli - M.Giuliani - F.Sor M. Carcassi A.Vivaldi M.Gragranji etj.	➢ Realizon tempet e kohëve; ➢ realizon tempet e variacioneve tek temat me variacione; ➢ ndërgjegjësohet për realizimin e programit në përputhje me etapat e punës praktike të përcaktuar nga mësuesi; ➢ realizon kërkesat tekniko-muzikore përmes *frazimit, karakterit teknik dhe zbërthimit emocional*.
Bravura romantike ose kontemporane	**2 bravura** nga autorë, si: F.Tarrega J.Ferrer D.Fortea J.Sagreras etj. *<u>Shënim</u>: Për bravurat mësuesi të mbështetet dhe në metodat e Th.Assimakopulos*	➢ Luan në stilet dhe tempet e duhura; ➢ realizon duke nxjerrë në pah karakterin e çdo bravure; ➢ luan bukur emocionalisht dhe në mënyrë virtuoze; ➢ zhvillon personalitetin e tij në lojë.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen vetëm 2 kontrolle teknike në simestrin e dytë. ➢ 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore,Terca, Oktava ➢ 2 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1 kohë suite(barok). ➢ 1 Vepër (klasike). ➢ 1 bravura.	***Programi në saxho:*** ➢ 1kohë suite (barok) ➢ 1 vepër (klasike). ➢ 1 bravura.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë - fillestar**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **Klasa 12 (34 x 4 orë/javë =136 orë)**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe materiale ndihmëse teknike	**8 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Ruggero Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet).) Ushtrime teknike. **Metoda:** Julio Sagreras Mauro Giuliani Ruggero Chiesa Abel Carlevaro Mauro Storti etj.	Nxënësi: ➢ luan shkallët me apojando dhe tirando; ➢ realizon ushtrimet teknike për të përvetësuar teknikën e Barres dhe legatot; ➢ realizon kalimet deri në pozicionin e 12-të.
Etyde ose kapriçio	**10-12 etyde** - Metoda Carcassi op 60. - Metoda Sor (R.Chiesa) - Metoda Giuliani (R.Chiesa). - Metoda M.Carcassi op. 60. - H.Tauchert etj.	➢ Realizon teknikisht dhe muzikalisht etydet; ➢ realizon frazimet; ➢ luan në tempin e duhur; ➢ realizon me një tingull të qartë dhe brilant.
Kohë nga suitat paraklasike	**2- kohë** (kontrastuese) nga suitat: - J.S.Bach, - G.Sanz, - L.Roncall, - R.De Vise etj.	➢ Luan në stilin e duhur; ➢ dallon tempet e kohëve të ndryshme të suitave; ➢ luan duke mbajtur notat në formë pedali; ➢ dallon qartë linjat e zërave.
Vepër ciklike (klasike)	**2 vepra të plota ciklike:** M.Giuliani, F.Carulli , F. Sor M.Carcassi A.Diabelli etj.	➢ Njeh formën dhe ndërtimin harmonik të veprës që luan; ➢ realizon stilin e autorit; ➢ realizon tempet e ndryshme brenda veprës; ➢ shpalos edhe individualitetin e tij në lojë; ➢ luan me një tingull brilant dhe t'i përshtatet lojës dinamike të veprës.
Bravura romantike ose kontemporane	**2- bravura** nga autorë, si: F.Tarrega J.Ferrer, J.Sagreras, D.Fortea	➢ Luan në mënyrë virtuoze duke përfshirë elementet teknike dhe artistike; ➢ luan saktë për sa i përket dinamikës kontrastuese sidomos te bravurat kontemporane;

	etj.	➢ luan duke i përcjellë publikut (në saxho) emocionet e tij të brendshme.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 2 kontrolle teknike në çdo semestër. ➢ 2 shkallë: 1 maxhore dhe 1 minore, me të shtatë mënyrat. ➢ 2 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suitë(Barok). ➢ 1 vepër ciklike(Klasike) ➢ 1 bravura.(Romantike ose konterporane)	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suitë(Barok). ➢ 1 vepër ciklike(Klasike) ➢ 1-bravura.(Romantike ose konterporane)

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kitarë - fillestar**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Kitarë", klasa e 12-të (136 orë)

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Materiale ndihmëse teknike	**8 shkallë muzikore** të Metodës Segovia ose Ruggero Chiesa (maxhore, minore, me terca dhe oktava, akordet dhe arpezhet). Ushtrime teknike. **Metoda:** Julio Sagreras, Mauro Giuliani, Ruggero Chiesa, Abel Carlevaro, Mauro Storti, etj.	Nxënësi: ➢ luan të gjitha materialet ndihmëse në funksion të shkallës së vështirësisë që ka programi; ➢ përsos sa më mirë materialin duke iu përgjigjur një pasazhi të vështirë.
Etyde	**etyde** koncertale: - Leo Brouwer - F.Sor - M.Giuliani - M.Carcassi - V.Lobos	➢ Realizon tekni-kisht etydet; ➢ luan në ritmet dhe tempet e duhura ➢ luan me kontrastet dinamike; ➢ luan me kujdes aksentet.
Kohë nga suitat **Paraklasike**	**1-2 kohë** nga suitat: - Bach - G.Sanz - R.Visse - S.L.Weiss etj.	➢ Luan në stilin e Bahut. ➢ njeh ndërtimin e strukturës polifonike të kohëve të suitës; ➢ luan me nota dhe tinguj të zgjatur; ➢ luan ndryshimin e tempeve për secilën kohë të suitës.
Vepër ciklike, si: **- Temë me variacione** **- Koncert ose** **- Suitë**	**2 vepra ciklike të plota** nga: - F.Sor - M.Giuliani - L.Legniani - A.Diabelli etj.	➢ Interpreton stilin e autorit që do të luajë; ➢ performon bukur, në mënyrë koncertale nga ana teknike artistike.
Bravura kontemporane	**2- bravura** nga autorë, si: - J.Pernabuco - F.Tarrega - V.Llobos - A.Barios	➢ Njeh epokat dhe stilet e autorëve që do të luajë; ➢ performon bukur me të gjitha elementet tekniko-profesionale.

	etj.	

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Seaxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: ➢ Kryhen 2 kontrolle teknike në vit. ➢ 4-5 etyde.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite (paraklasike). ➢ 1-kohë sonatë ose pjesë periudha të ndryshme stilistike. ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 kohë suite (paraklasike). ➢ 1-kohë sonatë ose pjesë periudha të ndryshme stilistike. ➢ 1 vepër ciklike e plotë. ➢ 1 bravura.

6. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e një niveli të mirë te nxënësi i **klasës X,** duhen pasur parasysh disa hapa që bëjnë të mundur realizimin e programit, si: zgjedhja e materialeve teknike dhe artistike nga mësuesi për secilin nxënës (duke marrë parasysh problemet teknike dhe përshtatjen e materialit artistik me karakterin e nxënësit).Duhet të kemi parasysh që ky program duhet t'u përshtatet nxënësve fillestarë dhe atyre që kanë njohuri mbi kitaren. Te nxënësit fillestar mësuesi duhet t'i kushtojë një vëmendje të madhe impostimit të saktë të duarve. Duhet t'i japë ushtrime plotësuese për një pozicion të saktë të dorës së majtë dhe tihet t'i japë ushtrime si shkallë apo ushtrime kromatike për dorën e majtë.

Programi do të ndahet në 4 orë mësimi gjatë javës, në mënyrë që nxënësi të jetë sa më i qartë me shpjegimin dhe të jetë vazhdimisht në proces studimi. Nxënësi fillestar nuk merr pjesë në dy kontrollet teknikë të parë, në këtë mënyrë mund të ketë më shumë kohë të rregulloj pozicionet e duarve, dhe del vetëm në saxhon e parë.Nxënësi merr pjesë në saxhoe dytë mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Për arritjen e një niveli sa më të mirë të nxënësit të **klasës XI,** mësuesi duhet të bëjë kujdes në zgjedhjen e programit sipas nivelit të nxënësit duke patur parasysh që është një nivel fillestar nxënësish. Duhet të punojë me nxënësin në mënyrë që ai të shpalosë dhe vlerat e tij individuale, në mënyrë që të mos jetë thjesht një kopje e mësuesit. Në këtë klasë, prioritet do t'u jepet teknikave të apojandos, tirandos, si dhe 12 pozicioneve në kitarë (mbështetur gjithmonë në materialet plotësuese teknike). Nxënësi duhet të jetë në gjendje që të arrijë një performancë sa më të bukur si paraprijëse e provimit të diplomës.

Nxënësi merr pjesë në saxho mbasi ka kryer detyrimet e të dyja kontrolleve teknike. Në rast se nxënësi është me raport mjekësor, do të shlyejë detyrimin në një datë tjetër të caktuar nga komisioni.

Në klasën XII, nxënësi duhet të arrijë të deshifrojë vetë pa vështirësi gjithë programin e zgjedhur nga mësuesi. Mësuesi duhet të punojë me nxënësin me pasazhet e veçanta (aty ku nxënësi shfaq

vështirësi). Prioritet iveçantë do t'i jepet performancës artistike, në mënyrë që nxënësi të realizojë sa më mirë programin e diplomës dhe të përgatitet për përballjen me publikun.

Në klasën **XII,** nxënësi do të shlyejë vetëm 2 kontrolle teknike dhe saxhon e semestrit të parë.

Rekomandime për kontrollet teknike

- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4kontrolle teknike gjithsej(klasa X fillestar,nuk do të bëjë 2 kontrollet e para).
- Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyruar 2 shkallë (mazhore-minore-terca-oktava), si dhe 2 etyde.
- I gjithë programi luhet përmendsh.

Rekomandime për saxhot

Gjatë vitit shkollor zhvillohen 2 saxho .

Në çdo saxho luhet në mënyrë të detyruar:

- 1-2 kohë suite Bach, Sanz etj. (paraklasikë).
- 1 vepër ciklike, si: temë me variacione ose koncert (klasike).
- 1-2 bravura (klasike, romantike, kontemporane).

I Gjithë programi luhet përmendsh.

7. VLERËSIMI

- Vlerësimi i nxënësit në kontrollet teknike do të bëhet nga komisioni i përbërë nga të gjithë mësuesit që kanë nxënës në klasën përkatëse (me jo më pak se 3 veta).
- Vlerësimi do të jetë nga notat e vendosura për materialet që luan nxënësi.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga të gjithë anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi i nxënësit në saxhot semestrale do të bëhet nga komisioni i mësuesve të caktuar nga drejtoria (me jo më pak se 3 veta).
- I përfshirë në vlerësimet e komisionit do të jetë edhe vlerësimi i mësuesit përkatës të nxënësit.
- Vlerësimet e nxënësve do të diskutohen nga anëtarët e komisionit.
- Vlerësimi përfundimtar i nxënësit do të dalë si rezultat i mbledhjes dhe përpjesëtimit matematikor të notave të vëna nga anëtarët e komisionit, plus notën e mësuesit të lëndës.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur luan jo *korrekt:*

- ✓ me ritëm,
- ✓ me tingull mesatar,
- ✓ me intonacion jo të këndshëm,
- ✓ me shkallë shpejtësie të ulët e
- ✓ me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur luan *mirë:*

- ✓ ritmikisht,
- ✓ me tingull e me intonacion,
- ✓ pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot**
Klasa: X
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Fagot", nxënësi:

- ✓ përsos elementet teknike dhe artistike për këtë grupmoshë;
- ✓ vendos shprehitë teknike, ekzekutuese dhe konceptuale mbi etydet dhe pjesët;
- ✓ zhvillon në të gjithë regjistrin e instrumentit mënyrën e të luajturit lirshëm dhe pa sforcime.
- ✓ luan me shenjat përkatëse dinamike programin artistik të përcaktuar dhe në pasurimin interpretativ;
- ✓ luan etyde të vështirësisë së lartë dhe solot orkestrale të "Fagotit"në veprat e ndryshme, në të cilin përkon ky instrument;
- ✓ luan materialet didaktiko-artistike, duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike, me ritëm të ngadaltë, me tingull të plotë dhe metronom, duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	⟩ Shkalla Do Maxhore dhe Si bemol Maxhore (tri oktava). ⟩ Shkalla Fa diez Maxhore dhe Re bemol Maxhore (me dy oktava). ⟩ Shkalla Si bemol Minor melodik me (tri oktava). ⟩ Shkalla kromatike (me tri oktava). ⟩ Shkallën Sol diez Minor dhe Do diez Minor melodik (me dy oktava) ⟩ Arpezhet e këtyre shkallëve me dy dhe me tri oktava dhe me dominant septakordet përkatëse e me diminuitin përkatës për shkallët minore.	Nxënësi: ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët, ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato, portato, stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamikë *p, mf, f* gjer në regjistrat e lartë; ➢ luan në temp shkallët muzikore.
Ushtrime dhe etyde	6 etyde nga metodat përkatëse (çdo muaj). **Metodat:** Julius Weissenborn fl. II dhe	➢ Luan me përpikëri *aplikaturat* e etydit; ➢ respekton dinamikën; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe

	III, Giamperi Otto Langey Ëoxman (metodë e mesme).	intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Program artistik	⟩ 5-6 duete që luhen me pedagogun - nga metoda e fagotit. ⟩ Percetina - albumi Hilling dhe Bergman. ⟩ Forest Buchtel - vals.	➢ Luan duetet me mësuesin; ➢ kupton pjesët muzikore që do të luajë nga ana e solfexhit dhe interpretative; ➢ realizon hap pas hapi momentet e vështira muzikore; ➢ zbërthen partin muzikor nga ana ndërtimore dhe ideoemocionale; ➢ realizon partin muzikor përmes ilustrimit; ➢ zhvillon pavarësinë artistike e nxënësit.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ -1-2 pjesë. ➢ -Vepër ciklike: -sonatë paraklasike, -koncert koha e parë, -koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot**
Klasa: XI
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	⁾ Shkalla Do Maxhore dhe Si bemol Maxhore (tri oktava). ⁾ Shkalla Fa diez Maxhore dhe Re bemol Maxhore (me dy oktava). ⁾ Shkalla si bemol minor melodik me (tri oktava). ⁾ Shkalla kromatike me tri oktava. ⁾ Shkalla Sol diez Minor dhe Do diez Minor melodik (me dy oktava). ⁾ Arpezhet e këtyre shkallëve me dy dhe me tre oktava, së bashku me dominant septakordet përkatëse dhe diminuitin përkatës për shkallët minore.	**Nxënësi:** ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato, portato, stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamikë *p*, *mf*, *f* gjer në regjistrat e lartë; ➢ luan në temp shkallët muzikore.
Ushtrime dhe etyde	**8 etyde** nga metodat përkatëse (çdo muaj) **Metodat:** Julius Weissenborn fl. II Giamperi Milde gama etydi.	➢ Luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë shqiptare	⁾ V. Nova – melodi. ⁾ P. Dungu- melodi. ⁾ K. Laro-temë me variacione.	➢ Luan pjesët shqiptare, duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	⁾ F. Teleman – sonatë. ⁾ Fash- sonatë.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës.
Koncerté	⁾ F. Fash- koncert. ⁾ Shtumf- koncertino (të shoqëruar me piano).	➢ Luan koncertin, duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës;

		➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

2.2 Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	Të gjitha shkallët mazhore e minore me: - arpezhet përkatëse, - dominant septakordet; - diminuitet në tempet optimale të shpejtësisë me metronome 100-109 me aplikatura trolet; - kuartol dhe me lëvizje xhirosh harmonike.	Nxënësi: ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan në temp shkallët muzikore. ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato, portato, stakato në një temp të shpejtë, me dinamikë *p, mf, f*.
Ushtrime dhe etyde	⌡ 6 etyde në muaj nga metodat përkatëse **Metodat:** Ozi- Kapriço, Bogdanov- etyde, Milde - gama etydi, Milde - etyde koncertale.	➢ Luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë shqiptare	⌡ P. Gaci - melodi, "Nina – nana". ⌡ V. Nova- melodi. ⌡ K. Laro - temë me variacione të plota.	➢ Luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	⌡ 6 sonata nga F. Teleman. ⌡ Con Cone- 5-6-duete. ⌡ Marcelo – sonatë. ⌡ Fash- sonatë.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës.
Koncerte	⌡ F. Fash- koncert. ⌡ Koncert Moxart- tri kohë (të shoqëruar me piano).	➢ Luan koncertin, duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ realizon pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

3. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjatë punës për zbatimin e programit duhet bërë kujdes që të tregohen rrugët e duhura për arritjen e objektiveve, duke filluar nga materialet teknike, si edhe ato muzikore. Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik e emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin.. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij në lidhje me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Materiali didaktik duhet t'i përgjigjet nivelit që kërkon grupmosha e jo nivelit të ulët, po ashtu edhe programi artistik. Për këtë arsye bëhet zbërthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe i miratuar nga drejtuesi specialist i shkollës. Përgatitja e nxënësit duhet të bëhet e kontrolluar edhe me variante të ndryshme për të pasur më shumë efektivitet. Gjatë zhvillimit të orëve të para, materiali teknik dhe didaktik të kërkohet në një ritëm të ngadaltë dhe duke avancuar në tempin real. Kërkesat bazë, si: përpikëria në ritëm, konceptimi i frymëmarrjes mbi bazën e logjikës konceptuale muzikore e teknike, realizimi i aplikaturave dhe loja me koncept të drejtë me tingull të pastër, përbëjnë elementet kryesore të suksesit dhe të arritjes së rezultateve optimale.

Shënim. Materiali artistik, ku përfshihen koncertet dhe sonatat, veprat ciklike, mund të zëvendësohet nga ana e mësuesit të lëndës me materiale të tjera, por ato të jenë në të njëjtën shkallë vështirësie dhe të miratohen nga komisioni përkatës.

4. VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i lëndës, për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

luan jo *korrekt*
me ritëm,
me tingull mesatar,
me intonacion jo të këndshëm,
me shkallë shpejtësie të ulët e

me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë*
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot - fillestarë**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Fagot", nxënësi:

- perfeksionon elementet teknike dhe artistike për këtë grupmoshë (vit shkollor);
- merr impostacionin në mënyrë natyrale dhe lirshëm;
- vendos shprehitë teknike, ekzekutuese dhe konceptuale mbi etydet dhe pjesët;
- luan materialet didaktiko-artistike duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike, me ritëm të ngadaltë dhe me tingull të plotë;
- luan me shenjat përkatëse dinamike programin artistik të përcaktuar dhe në pasurimin interpretativ;
- zhvillon në të gjithë regjistrin e instrumentit mënyrën e të luajturit lirshëm dhe pa sforcime;
- luan etyde të vështirësisë së lartë dhe solot orkestrale të "fagotit"në veprat e ndryshme në të cilin përkon ky instrument;
- luan materialet didaktike artistike duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike, me ritëm të ngadaltë, me tingull të plotë dhe metronom, duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	) Shkalla Do maxhore dhe Si bemol maxhore (dy oktave).) Shkalla Fa maxhore dhe La bemol maxhore (me dy oktava).) Shkalla Mi bemol maxhore (me dy oktave).) Shkalla kromatike me dy oktava.) Shkalla Sol maxhor minor dhe Re maxhor Si minor melodik (me dy oktava).) Arpezhet e këtyre shkallëve me dy oktava së bashku me arpezhet përkatëse.	***Nxënësi:*** ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato portato stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamikë *p, mf, f* gjer në regjistrat e lartë; ➢ luan në temp shkallët muzikore.
Ushtrime dhe etyde	**6 etyde nga metodat përkatëse (çdo muaj)** **Metoda:** Ozi- kapriço, Bogdanov- etyde, Milde - gama etydi, Milde – etyde koncertale.	➢ Luan me përpikëri *aplikaturat* e etydeve. ➢ respekton dinamikën; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e

		logjikës muzikore e teknike.
Program artistik	) Con Cone- 5-6- duete, me pedagogun.) Gjashtë sonata nga F. Teleman.	➢ Luan duetet me mësuesin. ➢ luan nga ana e solfexhit dhe interpretive. ➢ punon hap pas hapi momentet e vështira muzikore. ➢ zbërthen partin muzikor nga ana ndërtimore dhe ideoemocionale. ➢ demonstron partin muzikor përmes ilustrimit. ➢ forcon pavarësinë artistike të tij.
Pjesë shqiptare	P. Gaci – melodi "Nina- nana" V. Nova - melodi. K. Laro - temë me variacione të plota.	➢ Luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	Marcelo – sonatë. Fash- sonatë.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës.
Koncerte	) F. Fash- koncert.) Koncert Moxart- tri kohë (të shoqëruar me piano).	➢ Luan koncertin duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa e 10-të		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike, - koncert koha e parë, - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot - fillestarë**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultate të pritshme**
Shkallë muzikore	⟩ Shkalla Do maxhore dhe Si bemol maxhore (tri oktava). ⟩ Shkalla Fa diez maxhore dhe Re bemol maxhore me (dy oktave) ⟩ Shkalla Si bemol minor melodik me (tri oktava). ⟩ Shkalla kromatike me tri oktava. ⟩ Shkallën Sol diez minor dhe Do diez minor melodik (me dy oktava). ⟩ Arpezhet e këtyre shkallëve me dy dhe me tri oktava. Së bashku me dominant septakordet përkatëse dhe diminuitin përkatës për shkallët minore.	***Nxënësi:*** ➢ Luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato portato, stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamikë *p, mf, f* gjer në regjistrat e lartë; ➢ luan në temp shkallët muzikore.
Ushtrime dhe etyde	8 etyde nga metodat përkatëse (çdo muaj). **Metodat:** Julius Weissenborn fl. II. Giamperi Milde gama etydi.	➢ Luan duke respektuar *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë shqiptare	V. Nova – melodi. ⟩ P. Dungu- melodi. ⟩ K. Laro-temë me variacione.	➢ Luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	⟩ F. Teleman – sonatë. ⟩ Fash- sonatë.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës.
Koncerté	⟩ F. Fash- koncert. Shtumf- koncertino, të shoqëruar me piano.	➢ Luan koncertin duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat;

		➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike: - Sonatë paraklasike. - Koncert koha e parë. - Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike: - Sonatë paraklasike. - Koncert koha e parë. - Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fagot - fillestarë**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fagot"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	⟩ Të gjitha shkallët mazhore e minore me: - arpezhet përkatëse - dominant septakordet - diminuitet në tempet optimale të shpejtësisë me metronome 100-109 me aplikatura trolet, - kuartol dhe me lëvizje xhirosh harmonike.	**Nxënësi:** ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan në temp shkallët muzikore; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët si legato portato stakato në një temp të shpejtë, me dinamikë *p, mf, f.*
Ushtrime dhe etyde	⟩ 6 etyde ne muaj nga metodat përkatëse **Metodat:** Ozi- kapriço. Bogdanov- etyde. Milde - gama etydi. Milde – etyde koncertale.	➢ Luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë shqiptare	⟩ P. Gaci – melodi (nina-nana). ⟩ V. Nova- melodi. ⟩ K. Laro - temë me variacione të plota.	➢ Luan pjesët shqiptare duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	6 sonata nga F. Teleman. Con Cone- 5-6- duete. Marcelo – sonatë. Fash- Sonatë.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës.
Koncerte	⟩ F. Fash- koncert. ⟩ Koncert Moxart- tri kohë. (të shoqëruar me piano).	➢ Luan koncertin duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike. - koncert koha e parë. - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** ➢ 1-2 pjesë. ➢ Vepër ciklike: - sonatë paraklasike. - koncert koha e parë. - koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Repertorin mund ta ndryshojë mësuesi me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

3.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjatë punës për zbatimin e programit duhet bërë kujdes që të tregohen rrugët e duhura për arritjen e objektiveve, duke filluar nga materialet teknike, si edhe ato muzikore.

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik e emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit dhe rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin.Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij në lidhje me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Materiali didaktik duhet t'i përgjigjet nivelit që kërkon grupmosha e jo nivelit të ulët, po ashtu edhe programi artistik. Për këtë arsye bëhet zbërthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe i miratuar nga drejtuesi specialist i shkollës. Përgatitja e nxënësit duhet të bëhet e kontrolluar edhe me variante të ndryshme për të pasur më shumë efektivitet. Gjatë zhvillimit të orëve të para, materiali teknik dhe didaktik të kërkohet në një ritëm të ngadaltë dhe duke avancuar në tempin real. Kërkesat bazë, si: përpikëria në ritëm, konceptimi i frymëmarrjes mbi bazën e logjikës konceptuale muzikore e teknike, realizimi i aplikaturave dhe loja me koncept të drejtë me tingull të pastër, përbëjnë elementet kryesore të suksesit dhe të arritjes së rezultateve optimale.

Shënim. Materiali artistik, ku përfshihen koncertet dhe sonatat, veprat ciklike, mund të zëvendësohet nga ana e mësuesit të lëndës me materiale të tjera, por ato të jenë në të njëjtën shkallë vështirësie dhe të miratohen nga komisioni përkatës.

4.VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Mësuesi i lëndës, për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,
  me intonacion jo të këndshëm,

me shkallë shpejtësie të ulët e
me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë*
ritmikisht,
me tingull e me intonacion,
pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Flaut**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. **Rezultatet e pritshme**

Në përfundim të mësimit të lëndës "Flaut", nxënësi:

- ✓ përsos bazën tekniko-artistike të lojës në flaut, duke e trajtuar atë në funksion të praktikave bashkëkohore të interpretimit;
- ✓ përvetëson një impostim të rregullt, duke qenë veçanërisht i vëmendshëm *në lirshmërinë e tingullit, lirshmërinë e krahëve e të gishtave,* si dhe në përdorimin organik të diafragmës;
- ✓ lëviz natyrshëm në regjistrat e instrumentit dhe pozicionet e tij më të vështira;
- ✓ zhdërvjelltësohet në elementet teknike e artistike të lojës në instrument;
- ✓ përdor sa më shumë nuanca interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik, por edhe në shkallët e të gjitha llojeve e në etydet teknike;
- ✓ imposton në mënyrë të sigurt goditjen legato, portato, detashe;
- ✓ thellon njohuritë mbi solfezhin dhe analizën e formave muzikore;
- ✓ merr njohje të gjerë të periudhave të ndryshme historike, stileve krijuese e interpretative, duke filluar nga shprehjet e hershme të barokut e deri te muzika e shekullit të 20-të**;**
- ✓ respekton dinamikën e pjesëve që interpreton, duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj. ;
- ✓ përdor tingullin e instrumentit në funksion të plotë me përmbajtjen e veprave që interpreton.
- ✓ harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos;
- ✓ luan saktë edhe me formacionet e dhomës, orkestrat e vogla dhe orkestrat simfonike.

2. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Flaut"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	) Të gjitha shkallët e grupit të parë me diezis dhe minoret përkatëse.) Të gjitha shkallët e grupit të parë me bemola dhe minoret përkatëse.) Dominant septakordi për maxhoret dhe septakordi i zvogëluar për minoret.) Metoda e shkallëve nga Tafanel – Goubert.	***Nxënësi:*** ➢ realizon shkallët përmendsh e me tingull të plotë; ➢ luan shkallët stakato e legato në temp mesatar e të shpejtë; ➢ luan në mënyrë të lirshme dominant septakordin për maxhoret dhe sepatakordin për minoret; ➢ bën kujdes për aplikaturat.
Ushtrime dhe etyde	**2-3 etyde** në muaj nga:) B. Berbiguer: 18 etyde.) G. Gariboldi.) Gali.	➢ Realizon kërkesat e reja didaktike e artistike në të gjitha elementet teknike; ➢ konsolidon elementet e tingullit,si:pastërtia,

	⟩ E. Kohler. ⟩ Luis Moyse: teknika e flautit.	tejshkueshmëria, vibrimi dhe ngjyrat; ➢ Mban intonacion të pastër.
Programi artistik	⟩ 3-4 duete për flaut. ⟩ 2 kohë sonatë. ⟩ 1 kohë koncerti. ⟩ Minuete. ⟩ Romanca. ⟩ Teleman: sonata Nr. 1 e 2. ⟩ Hendel: sonatë. ⟩ J. S. Bach: sonatë. ⟩ Blavet: sonatë nga përmbledhja e sonatave për flaut. ⟩ Teleman: suitë. ⟩ J.S. Bach: minuete Nr. 1, 2, 3. ⟩ Fils: koncert për flaut. ⟩ A. Vivaldi: koncertet Nr. IV dhe V. ⟩ Stamitz: koncert. ⟩ Pjesë nga kompozitorët shqiptarë si: - P. Gaci, - N. Zoraqi, - F. Ibrahimi, - L. Dizdari.	➢ Luan në klasë së bashku me mësues/in,-en ose me shokët/qet e klasës; ➢ zbërthen partin muzikor nga ana ndërtimore dhe ideo-emocionale; ➢ ndan partin në blloqe, ku të evidentohen momentet më të vështira; ➢ evidenton karakteristikat kryesore të pjesëve shqiptare dhe të huaja dhe të organizojë mirë punën për studimin e tyre.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ shkallë të plota nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. ➢ 2 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ 2 kohë sonatë ➢ 1 kohë e parë koncerti me kadencë, ose koha II dhe III së bashku. ➢ 1 pjesë e huaj. ➢ 1 pjesë nga autorë shqiptarë.	***Programi në saxho:*** ➢ 2 kohë sonatë ➢ 1 kohë e parë koncerti me kadencë, ose koha II dhe III së bashku. ➢ 1 pjesë e huaj. ➢ 1 pjesë nga autorë shqiptarë.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **FLAUT**
Klasa: XI
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Flaut"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	⎫ Të gjitha shkallët e grupit të dytë me diezis. ⎫ Të gjitha shkallët e grupit të dytë me bemola. ⎫ Shkallë kromatike. ⎫ Metoda e shkallëve nga Tafanel – Goubert.	Nxënësi: ➢ luan përmendsh në shtrirje të gjerë, me stakato e legato; ➢ luan në temp të shpejtë e shumë të shpejtë; ➢ zbaton aplikaturat rigorozisht.
Ushtrime dhe etyde	**2-3 etyde** në muaj nga: ⎫ H. Kohler: etyde. ⎫ E. Kohler: fashikulli i dytë, op. 33. ⎫ B. Berbiguer: 18 etyde. ⎫ V. Pllatonov: etyde. ⎫ Luis Moyse: teknika e flautit, vol. 2. ⎫ Furstenau – etyde. ⎫ Marsel Moyse – etyde.	➢ Përvetëson kërkesat e reja didaktike e artistike në lidhje me etydet; ➢ konsolidon elementet e tingullit, si: tejshkueshmëria, vibrimi e dinamika; ➢ ndjek me vëmendje demonstrimin nga ana e mësuesit; ➢ krijon pavarësi dhe siguri në trajtimin e materialeve; ➢ respekton dinamikat e ushtrimeve; ➢ u kushton vëmendje e veçantë tingullit dhe intonacionit të pastër.
Programi artistik	⎫ G. Teleman – sonata Nr. 1 dhe 2. ⎫ J. S. Bach: sonatë. ⎫ C. Ph. E. Bach: sonatë solo. ⎫ L. W. Bethoven: Sonata si b maxhor. ⎫ F. Devienne: sonatë. ⎫ A. Vivaldi - nga volumi i 6-të koncerteve. ⎫ J. Quantz: koncertet në sol maxhore dhe re maxhore. ⎫ E. Kohler: koncert op. 97. ⎫ J. Hajden: koncert D Dur.	➢ Luan saktësisht karakterin e pjesëve; ➢ realizon gjatw lojws veçoritë e individualitetit krijues të autorëve; ➢ zbulon tiparet e veçanta të epokës kur janë shkruar veprat; ➢ Realizon me qartësi veçoritë e formës muzikore; ➢ luan me emocion dhe me përfytyrim të qartë figurat artistike; ➢ bëhet pjesëmarrës aktiv i lojës sofistike; ➢ demonstron qartësisht e në mënyrë organike kontrastet e rrjedhshme e

	⎫ F. Shubert: temë me variacione. ⎫ J. S. Bach: suitë në si minor dhe do minor. ⎫ G. Foure: fantasie ⎫ Paparisto – romancë.	ato ballafaquese të çdo vepre.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
➢ ***Programi në kontroll teknik*** ➢ 2 shkallë me arpezhet përkatëse nga shkallët e zhvilluara dhe dominant septakordet e septakordet e zvogëluara për minorin. ➢ 2 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** ➢ Dy deri në katër kohë sonatë. ➢ 1 kohë e parë koncerti me kadencë ose koha e dytë dhe e tretë së bashku. ➢ 1 pjesë bravurë nga autorë shqiptarë ose të huaj.	***Programi në saxho:*** ➢ Sonatë e plotë. ➢ Tri kohë koncerti. ➢ Një pjesë bravure nga autorë shqiptarë ose të huaj.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Flaut**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: 34 javë x 3 orë/javë = 102 orë

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Flaut"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore	⟩ Të gjitha shkallët sipas modelit Marcel Moyse, ose sipas sistemit melodik të përmbysjeve të shkallëve maxhore e minore. ⟩ Metoda e shkallëve nga Tafanel – Goubert. ⟩ Soussman: op.53.	Nxënësi: ➢ Luan përmendsh e me temp të shpejtë; ➢ unifikon të të gjitha elementeve teknike; ➢ procedohet në formë studimi me dinamikat *p, mf, f* dhe në të kundërt *f, mf, p*.
Ushtrime dhe etyde	**2-3 etyde** në muaj nga: ⟩ E. Kohler: Op. 33. ⟩ J. Andersen: 20 etyde të volumit 24. ⟩ Pllatonov: 12 etyde frazholet. ⟩ E. Prill: etyde, fashikulli 2. ⟩ Furstenau: etyde koncertale. ⟩ Luis Moyse: teknika e lojës në flaut, nr. 1, 2, 3.	➢ Zbaton me rigorozitet aplikaturat; ➢ u kushton një vëmendje të veçantë nuancave shprehëse; ➢ respekton dinamikën e etydeve; ➢ realizon një tingull të plotë, frymëmarrje të lirshme dhe intonacion të pastër.
Programi artistik	**2-3 duete** për flaut ⟩ Katër kohë sonatë. ⟩ Tri kohë koncerti. ⟩ Pjesë bravura nga autorë shqiptarë e të huaj, si: G. Foure, Fantasie. ⟩ Doppler: fantasie. ⟩ G. Bizet: suitë nga opera "Karmen". ⟩ C. Debussy: "Sirinx" për flaut solo. ⟩ N. Zoraqi: romancë. ⟩ T. Daija: rapsodi. ⟩ J. S. Bach: sonatat Mi maxhor, Mi minor dhe Si minor. ⟩ C. Ph. E. Bach: sonata për flaut solo.	➢ Luan duetet në klasë së bashku me mësuesin ose me nxënësit e klasës; ➢ praktikon zgjidhje të reja teknike e artistike, në përshtatje me teknikat e shekullit të 20-të, si frazholetë, frulato etj.; ➢ praktikon mësimin e pjesëve përmendsh; ➢ konsolidon elementet e tingëllimit, si: pastërtia timbrike, vibrimi dhe ngjyrat; ➢ Realizon individualitetin e autorëve dhe tregon qartë karakteristikat e epokës historike; ➢ zbërthen teorikisht e praktikisht veçoritë e formës muzikore dhe

	) W.A. Mozart: 6 sonata.) F. Devienne: sonatë për flaut e piano.) F. Poulenc: sonatë.) W.A. Mozart: koncert në Sol maxhor.) W.A. Mozart: koncert në Re maxhor.) E. Kohler: koncert në Sol minor, op.97.) Th. Boehm: koncert në Sol maxhor.) C. Chaminade:koncertino) Langer: koncert për flaut.	t'i bëjë ato pjesë organike e interpretimit muzikor.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik ➢ 3 shkallë të përzgjedhura nga shkallët e praktikuara. ➢ 3 nga programi .	***Programi në saxho:*** ➢ 1 sonatë e plotë. ➢ 1 koncert nga programi i semestrit. ➢ 1 pjesë bravure nga autorë shqiptarë ose të huaj.	***Programi në saxho:*** ➢ 3 kohë koncerti. ➢ 4 kohë sonate. ➢ 1 bravurë, solo flaut. ➢ Pjesë shqiptare.
Shënim. Mësuesi mund të ndryshojë repertorin e nxënësit me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi. Në përzgjedhjen e shkallëve, etydeve dhe pjesëve (sonata, koncerte, bravura, etj.), ai duhet të mbajë parasysh edhe nivelin e përvetësimit nga ana e nxënësit dhe talentin e tij.		

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për të arritur një nivel sa më të mirë të lojës në instrument, nxënësi duhet edukuar të studiojë në mënyrë sa më sistematike. Në këtë proces, puna e mësuesit duhet të jetë e vazhdueshme, e thelluar dhe e lidhur ngushtë me vëzhgimin psikologjik e emocional të nxënësit, që nga shkallët e para të formimit, deri në plotësinë e mjaftueshme të tij. Për të pasur rezultate sa më të mira, trajtimi psikoemocional duhet të shtrihet gjatë gjithë vitit dhe të synojë, në radhë të parë, një administrim sa më të mirë të orës së mësimit. Po ashtu, ndërthurja e kërkesave teknike të lojës në instrument me kërkesat artistike të veprave të veçanta, do t'i jepte orës së mësimit më shumë frymëmarrje dhe do ta bënte atë më të pëlqyeshme për nxënësin.

Në lidhje me zbatimin praktik të programit, do të ishte i nevojshëm ndërgjegjësimi i nxënësit me kuptimin e tij, rëndësinë që ka secila pjesë në formimin sistematik të nxënësit dhe mundësitë që krijojnë

ato për avancimin e tij gradual. Kështu, ushtrimet, etydet dhe pjesët e tjera artistike të programit duhet t'u përgjigjen grupmoshave të ndryshme dhe, nga ana tjetër, t'u japin mundësi individëve më të përparuar të ecin lirshëm e pa sforcime.

Është mirë që, në momente të caktuara të realizimit të programit, të planifikohen forma të veçanta të kontrollit të dijeve e të nivelit të nxënësit. Këto do të ishin mbështetje e sigurt për shkallët e tjera të realizimit dhe do ta ndihmonin nxënësin t'i kuptonte nga afër kërkesat e mëtejshme të mësuesit. Për këtë, edhe kontrolli i materialeve teknike dhe i pjesëve të tjera artistike të programit duhet të përputhet me shkallët e studimit të tyre: ngadalë (ushtrim e kontroll në detaje); pak më shpejt (vërtetim i studimit të saktë të materialit dhe siguri për më tej); më shpejt e, së fundi, trajtim i materialit në tempin e kërkuar nga partitura. Sipas kësaj dinamike, edhe kontrolli i përgjithshëm i dijeve do të ishte një fazë e rëndësishme në formimin e nxënësit dhe do të shërbente për një menaxhim më të mirë të mundësive dhe mangësive të tij për të ardhmen.

2. VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt:*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,
  me intonacion jo të këndshëm,
  me shkallë shpejtësie të ulët e
  me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë:*
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Flaut - fillestar**
Klasat: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Flaut", nxënësi duhet:

- ✓ njeh instrumentin, historikun e lindjes dhe të zhvillimit të instrumentit të flautit;
- ✓ koncepton tërësinë e instrumentit, duke u njohur fillimisht me pjesët përbërëse të tij, si: trupi, bokina, tastjera dhe pastaj, me lidhjen unike të tyre;
- ✓ merr një impostim të rregullt, duke qenë veçanërisht i vëmendshëm në lirshmërinë e tingullit, mbajtjen lirshëm të instrumentit, lirshmërinë e krahëve e të gishtave, si edhe përdorimin e diafragmës në frymëmarrje;
- ✓ fiton njohuri të mira për regjistrat e instrumentit dhe pozicionet bazë të tij;
- ✓ përvetëson elementet teknike dhe artistike të lojës në instrument;
- ✓ përdor nuanca interpretative, jo vetëm në pjesët e repertorit artistik, por edhe në shkallëte të gjitha llojeve e në etydet teknike;
- ✓ imposton në mënyrë të sigurt goditjen legato, portato, detashe;
- ✓ luan shkallët deri në katër shenja # (Diezis) dhe b (Bemola);
- ✓ përfiton një formim teorik dhe edukim muzikor për njohjen sa më të gjerë të periudhave të ndryshme ihistorike, stileve krijuese, interpretative nga Periudha e Barokutderi tek muzika e shekullit të XX;
- ✓ luan ushtrimet e etydet dhe pjesët në tempet reale duke zhvilluar aftësitë krijues të tijbrenda kërkesave teknike artistike;
- ✓ respekton dinamikën (pp, p, mf, f e ff etj.), duke e bërë atë funksionale në të gjitha lidhjet e mundshme të ritmit, tempit, metrit, koloristikës etj.;
- ✓ realizon idenë e shprehjeve të unifikuara e të pandara nga njëra tjetra;
- ✓ luan në instrument me tingull të plotë e intonacion të saktë, duke u përpjekur të shmangë tingujt e përciptë dhe rrëshqitjet aksidentore të intonacionit;
- ✓ harmonizon lojën e tij me atë të instrumentit shoqërues të pianos;
- ✓ kontrollon intonacionin në marrëdhënie të dyanshme.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Flaut"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e prtishme
	Shkallë të thjeshta • Shkallë deri në 2-3 shenja # (Dieziz) dhe relativet e tyre me ritëm të ngadaltë dhe mesatar. • Shkallët deri në 2-3 shenja b	***Nxënësi:*** ➢ realizon në mënyrë të veçantë impostimin(bokaturën); ➢ praktikon frymëmarrjen dhe frymënxjerrjen e rregullt(diafragmën); ➢ përdor lirshëm atakun

Pjesë të huaja	**G. F. Teleman** -sonatë në la minore, 4 kohë. **Belini** - koncert në mi b maxhore. **A. Vivaldi** - koncert në re minore. **J . Hajden** - koncert në C - dur, koha I.	➢ Zbërthen çdo pjesë muzikore mbi bazën shkrimore dhe emocionale; ➢ njeh kompozitorët që kanë shkruar pjesët; ➢ luan pjesën muzikore saktë në ritëm dhe intonacion; ➢ interpreton pjesët me ndjenjë dhe emocion.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik -1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. 2-3 ushtrime apo etydet e bëra. 1-2 fragmente nga pjesët e realizuara.	***Programi në saxho:*** 1 - 2 pjesë muzikore. 1 kohë koncerti.	***Programi në saxho:*** 1 - 2 pjesë muzikore. 1 kohë koncerti.

2.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik dhe emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional duhet të bëhet gjatë gjithë vitit që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do të bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin.

Puna e diferencuar mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin e klasës.

Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij/saj lidhur me programin, në individë që e përvetësojnë atë më shpejt.

Në repertorin muzikor përfshihen pjesë të huaja dhe shqiptare. Ato mund të jenë: romanca, sonata dhe koncerte. Përmes luajtjes së tyre duhet të nxirren në pah karakteristikat kryesore tekniko-muzikore. Për sa i përket anës së muzikalitetit, mësuesi duhet të demonstrojë në instrument teknikat e interpretimit, idetë dhe emocionet e veprës gjithmonë duke u bashkëngjitur dhe shpjegimin e karakteristikave për periudhat, në të cilat janë shkruar veprat muzikore. Me mbylljen e këtij cikli mësimor disavjeçar, nxënësi ka marrë bazat kryesore të formimit muzikor dhe atij instrumental të oboes. Materialet e lëndës së oboes janë bazuar mbi përzgjedhjen e elementeve teknike dhe muzikore.

Disa nga metodat janë:

- ✓ metoda **1 - 2 dhe 3 - 4,** të cilat janë një përmbledhje bazë e teknikave të ekzekutimit në këtë instrument;
- ✓ metoda **Hinke;**
- ✓ metoda **Videman;**
- ✓ metoda **Salviani.**

3.VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale.

Mësuesi i lëndës, për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë.

Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolle teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

luan jo *korrekt*
me ritëm,
me tingull mesatar,
me intonacion jo të këndshëm,
me shkallë shpejtësie të ulët e
me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

luan *mirë*
ritmikisht,
me tingull e me intonacion,
pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë kur:

luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Saksofon - fillestar**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Saksofon", nxënësi :

- ✓ realizon elementet teknike dhe artistike për këtë grupmoshë;
- ✓ realizon impostacionin në mënyrë natyrore dhe lirshëm;
- ✓ realizon shprehitë teknike, ekzekutuese dhe konceptuale mbi etydet dhe pjesët;
- ✓ luan materialet didaktike artistike, duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike me ritëm të ngadaltë dhe me tingull të plotë;
- ✓ lexon partitura aprimavista dhe të mësojë transportet me çelësin e tenorit dhe të solit;
- ✓ luan me shenjat përkatëse dinamike programin artistik të përcaktuar dhe të bëjë pasurimin interpretativ;
- ✓ luan etyde të vështirësisë së lartë dhe solot orkestrale të "saksofonit" në veprat e ndryshme, ku përkon ky instrument;
- ✓ luan materialet didaktike artistike duke ruajtur kërkesat teknike dhe artistike, me ritëm të ngadaltë, me tingull të plotë dhe metronom.

2.Përmbajtjet tematike të lëndës "Saksofon"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	Shkallët Mi, Si, Do Maxhor me dy oktava. Shkalla Fa Diez Minor dhe Do Diez minor melodik. Nga nota Do shkallën kromatike. (Shkallët maxhore luhen me dominant septakordet përkatëse dhe minoret me septakord të zvogëluar).	***Nxënësi:*** ➢ Luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato portato stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamike *p, mf, f*.
Ushtrime dhe etyde	6 ushtrime në muaj nga metodat përkatëse. **Metoda:** Mule - etyde për saksofon Klosse-metodë për zhvillimin e mekanizmit. Klosse - metodë e avancuar, volumi i dytë.	➢ Luan me përpikëri *aplikaturat*; ➢ respekton dinamikën; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër.
Program artistik	5-6 duete të thjeshta nga - Percetina nga Christofor Norton. - Petro Iturralde- suit helenique. - Suit- J.S.Bach.	➢ Luan duetet me mësuesin; ➢ kupton nga ana e solfexhit dhe nga ana interpretuese pjesët muzikore që do të luajë; ➢ punon hap pas hapi momentet e vështira muzikore; ➢ zbërthen partin muzikor nga ana

		ndërtimore dhe ideoemocionale; ➢ demonstron partin muzikor përmes ilustrimit; ➢ stimulon pavarësia artistike e nxënësit.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** -1-2 pjesë. -Vepër ciklike. -Sonatë paraklasike. - Koncert koha e parë. -Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** -1-2 pjesë. -Vepër ciklike. -Sonatë paraklasike. -Koncert koha e parë. -Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Saksofon**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. **Përmbajtjet tematike të lëndës "Saksofon"**

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Kërkesa për nxënësin**
Shkallë muzikore	❖ Shkalla do maxhore dhe si bemol maxhore (tri oktava). ❖ Shkalla fa diez maxhore dhe re bemol maxhore (dy oktava). ❖ Shkalla si bemol minor melodik (tri oktava). ❖ Shkalla kromatike me tri oktava. ❖ Shkalla sol diez minor dhe do diez minor melodik (dy oktava). ❖ Arpezhet e këtyre shkallëve me dy dhe me tri oktava, së bashku me dominant septakordet përkatëse dhe diminuitin përkatës për shkallët minore.	Nxënësi: ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato portato, stakato në një temp mesatar me metronome me shpejtësi 80 me dinamike *p, mf, f* gjer në regjistrat e lartë; ➢ luan në temp shkallët muzikore.
Ushtrime dhe etyde	8 etyde nga metodat përkatëse (çdo muaj). **Metodat:** Julius Weissenborn fl. II Giamperi Milde gama etydi.	➢ Luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë shqiptare	V. Nova - melodi. P. Dungu - melodi. K. Laro -temë me variacione	➢ Luan pjesët shqiptare, duke respektuar karakteristikat e kësaj muzike.
Pjesë të huaja	F. Teleman - sonatë Fash - sonatë	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës;
Koncerte	F. Fash – koncert. Shtumf - koncertino (të shoqëruar me piano).	➢ luan koncertin duke pasqyruar anën emocionale dhe karakteristikat e pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. - 2-3 ushtrime apo etydet e bëra.	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike. Sonatë paraklasike. Koncert koha e parë. Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike. Sonatë paraklasike. Koncert koha e parë. Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Saksofon**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Saksofon"

Programi i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	Shkallët Si bemol maxhor. Fa diez maxhor (dy oktava) dhe arpezhet përkatëse. Dominant septakordet e septakordet e zvogëluara të shkallëve minore respektive.	**Nxënësi:** ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët; ➢ luan në temp shkallët muzikore; ➢ luan me tingull të plotë të gjitha shkallët, si legato portato stakato në një temp të shpejtë, me dinamikë p, mf, f.
Ushtrime dhe etyde	6 etyde në muaj nga metodat përkatëse. **Metodat:** Klosse - metodë e avancuar Mule - 15 etyde Jems Roe Frederik Jacobs	➢ Luan dhe respekton *ritmikën* dhe *aplikaturat* e etydeve; ➢ luan me dinamikë të rregullt; ➢ luan duke respektuar frymëmarrjen, stakaton dhe legaton; ➢ realizon gjatë luajtjes tingull dhe intonacion të pastër; ➢ realizon performancë mbi bazën e logjikës muzikore e teknike.
Pjesë të huaja	F. Teleman - sonatë. Bach - Allemande - Currante Con Cone -5-6- duete, me pedagogun. Marcelo - sonatë. Hendel - sonatë. Debussy - rapsodi. Raul Himdemith - sonatë. Darius Milohaid - suitë. Gllazunove - koncert.	➢ Luan duke zbërthyer çdo detaj të anës melodike dhe ritmike të pjesës; ➢ luan duke respektuar kërkesat; ➢ kupton pjesën dhe kohën së cilës i përket.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 1 shkallë e plotë nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. - 2-3 ushtrime apo etydet e	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike. Sonatë paraklasike. Koncert koha e parë. Koncert koha e dytë	***Programi në saxho:*** 1-2 pjesë. Vepër ciklike. Sonatë paraklasike. Koncert koha e parë. Koncert koha e dytë dhe e tretë së bashku.

bëra.	dhe e tretë së bashku.	
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

2.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Gjatë punës për zbatimin e programit duhet bërë kujdes në mënyrë që të tregohen rrugët e duhura për arritjen e objektivave, përfshirë materialet teknike dhe ato muzikore.

Për arritjen e nivelit sa më optimal, nxënësi duhet të nxitet në sistematikën e tij në mënyrë rigoroze. Puna e mësuesit duhet të jetë shumë kërkuese dhe e njëtrajtshme. Vëzhgimi psikologjik e emocional i nxënësit përbën një nga detyrat më të vështira të mësuesit. Puna për të rritur administrimin psikoemocional, duhet të bëhet gjatë gjithë vitit, që të kemi rezultate sa më të larta. Administrimi i orës së mësimit me intensitet dhe etapa të përcaktuara qartë, do të rrisin shkallën e të nxënit e rendimentin e orës së mësimit. Ndërthurja e kërkesave teknike me ato artistike do ta bëjë orën e mësimit të pëlqyeshme për nxënësin. Puna e diferencuar, mbi bazën e mundësive fizike e intelektuale të çdo nxënësi, do të zhvillojë në mënyrë të drejtë e më të shpejtë nivelin cilësor të klasës. Mbi bazën e ecurisë së programit, mësuesi mund të avancojë në kërkesat e tij në lidhje me programin, me individë që e përvetësojnë atë më shpejt. Materiali didaktik duhet t'u përgjigjet nivelit që kërkon grupmosha e jo nivelit të ulët, po ashtu edhe programit artistik. Për këtë arsye, bëhet zbërthimi i programit nga çdo mësues për çdo muaj dhe miratohet nga drejtuesi specialist i shkollës. Përgatitja e nxënësit duhet të bëhet e kontrolluar dhe me variante të ndryshme për të pasur më shumë efektivitet. Gjatë zhvillimit të orëve të para, materiali teknik dhe didaktik të kërkohet në një ritëm të ngadaltë dhe duke avancuar në tempin real. Kërkesat bazë, si: përpikëria në ritëm, konceptimi i frymëmarrjes mbi bazën e logjikës konceptuale muzikore e teknike, realizimi i aplikaturave dhe loja me koncept të drejtë e me tingull të pastër, përbëjnë elementet kryesore të suksesit dhe arritjes së rezultateve optimale.

Shënim. Në materialin artistik ku përfshihen koncertet, sonatat dhe veprat ciklike mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit të lëndës me të tjera, por duhet të jenë të së njëjtës shkallë vështirësie, të cilën e përcakton komisioni përkatës.

3.VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt:*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,
  me intonacion jo të këndshëm,
  me shkallë shpejtësie të ulët e
  me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë:*
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Perkusion**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Rezultatet e pritshme
Në përfundim të mësimit të lëndës "Perkusion", nxënësi:

- ✓ krijon muzikalitetin e duhur gjatë luejtjes me instrumente;
- ✓ luan ushtrimet dhe pjesët muzikore në ritëm;
- ✓ përvetëson teknikën e duhur në shkallë apo etyde;
- ✓ luan duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore;
- ✓ zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike;
- ✓ interpreton në instrument duke zhvilluar muzikalitetin.

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Perkusion"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe teknikë për snare drum	**Të gjitha shkallët muzikore:** ❖ maxhore dhe minore, deri në shtatë shenja në armaturë (# dhe b); ❖ shkallët kromatike.	***Nxënësi:*** ➢ luan pastër dhe pa gabime shkallët gjer në regjistrat e lartë; ➢ realizon përmbysjet me triola dhe legato gjatë luajtjes; ➢ luan përmbysjet e arpezheve; ➢ realizon shkallët me tingull të mirë, pozicion të mirë dhe me teknikë.
Ushtrime dhe etyde	⁾ M. Goldenberg (ksilofon) - *Etyde.* ⁾ G. Capitani (snare drum) - *etyde.* ⁾ G. Capitani - *Ushtrime për teknikën dhe pozicionin.*	➢ Luan mirë teknikikisht; ➢ luan saktë dhe në ritëm; ➢ realizon një pozicion të lirshëm dhe mbi bazën e një logjike muzikore; ➢ lexon duke organizuar mirë frakturat teknike të etydit.
Programi muzikor	⁾ M. Goldenberg - "Flauti Magjik"- ⁾ (W. A. Moxart), ksilofon. ⁾ M. Goldenberg - "Sherezade" ⁾ (Koncert koha e 4-t), Snare ⁾ Drum. ⁾ G. Capitani – "Master the Drums".	➢ Luan duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore; ➢ zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike; ➢ interpreton në instrument duke zhvilluar muzikalitetin.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 6 shkallë të plota nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. - 4 etyde ose 8 ushtrime.	***Programi në saxho:*** 6 pjesë muzikore.	***Programi në saxho:*** 6 pjesë muzikore.
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Perkusion**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Perkusion"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe teknikë për snare drum	**Të gjitha shkallët muzikore**: -maxhore dhe minore,deri në shtatë shenja në armaturë (# dhe b); -shkallët kromatike.	***Nxënësi:*** ➢ realizon pjesët muzikore, duke punuar me një pozicion të plotë dhe me një teknikë të mirë; ➢ realizon me saktësi teknike elementet teknike, si: *tercat, triolat, arpezhet etj.;* ➢ shoqëron elementet teknike me elementet muzikore: *legato, piano, forte* dhe me forma të tjera studimi.
Etyde	⟩ Wm.f. Ludwig (snare drum) - etyde. ⟩ Ian Wright (timpan) - etyde. ⟩ M. Goldenberg (ksilofon) - etyde.	➢ Luan saktë në ritëm; ➢ realizon një teknikë shumë të lirshme; ➢ lexon dhe organizon mirë frakturat teknike të etydit.
Programi muzikor	Ian Wright - Fanfare, (timpan). M.Goldenberg - Bach koncert violine në La minor (adaptuar për ksilofon). G. Capitani - "Master the drums", (bateri). M.Goldenberg – "Third simphony"-Ë. Schuman, (snare drum).	➢ Luan pjesët e programit duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore; ➢ zbërthen strukturën e çdo pjese nga ana teknike dhe nga loja e figurave ritmike; ➢ zhvillon muzikalitetin duke demonstruar teknikat e interpretimit, idetë dhe emocionet e veprës që luan.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik - 6 shkallë të plota nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës. -6-8 etyde ose 10 ushtrime.	***Programi në saxho:*** 6 pjesë muzikore.	***Programi në saxho:*** 6 pjesë muzikore.
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Perkusion**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1.Përmbajtjet tematike të lëndës "Perkusion"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Shkallë muzikore dhe teknikë për Snare drum	**Të gjitha shkallët muzikore** : - maxhore & minore, deri në shtatë shenja në armaturë (# & b); - shkallët kromatike.	***Nxënësi:*** ➢ realizon shkallët me një teknikë të plotë dhe të pastër; ➢ realizon me saktësi teknike, elementet teknikë të shkallës përmes tercave, triolave dhe kuartolave; ➢ shoqëron elementet teknike nga elementet muzikore, si: *legato, piano, forte* dhe me forma të tjera studimi, të cilat zhvillojnë teknikën e shpejtë të kyçeve dhe të gishtërinjve.
Ushtrime dhe etyde	- Wm.f. Ludwig - Snare drum, *24 etyde.* - Ian Wright – Timpan, *20 etyde.* - G. Capitani – Srum teknik, (bateri) *30 etyde.*	➢ Luan mirë në teknikë; ➢ luan saktë dhe në ritëm; ➢ realizon një pozicion të lirshëm dhe mbi bazën e një logjike muzikore; ➢ lexon duke organizuar mirë frakturat teknike të etydit.
Programi muzikor	- M.goldenberg - "Pique Dame", snare drum. - M. Goldenberg - duete në snare drum. - M. Goldenberg - Paganini koncert për violinë, adaptuar për ksilofon. - M. Goldenberg "Petrouchka", I. Stravinsky, adaptuar për ksilofon. - Ian Wright - "Alla Marchia", për timpan. - Ian Wright - rondino, për timpan. - G. Capitani – "Master of Drum", për bateri.	➢ Luan duke nxjerrë në pah karakteristikat kryesore tekniko – muzikore; ➢ zbërthen strukturën e çdo pjese për sa i përket anës teknike dhe lojës së saktë të figurave ritmike; ➢ interpreton në instrument duke zhvilluar muzikalitetin.

Klasa XII	
Kontrolle teknike	**Saxho**

	Saxho e parë	Saxho e dytë
Programi në kontroll teknik - 6-8 shkallë të plota nga shkallët e zhvilluara brenda periudhës' - 6-8 etyde ose 10 ushtrime.	***Programi në saxho:*** 8 pjesë muzikore.	***Programi në saxho:*** 8 pjesë muzikore.
Shënim. Mësuesi mund ta ndryshojë repertorin me pjesë të tjera të së njëjtës vështirësi.		

2.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Me mbylljen e këtij cikli mësimor disavjeçar, nxënës/i,-ja ka marrë bazat kryesore të formimit muzikor dhe atij instrumental perkusionit. Përzgjedhja e programit teknik dhe muzikor është bërë mbi bazën e një përvoje disavjeçare në mësimdhënie.

Materialet e lëndës së perkusionit janë bazuar mbi përzgjedhjen e elementeve teknike dhe muzikore , si dhe nga metodat e autorëve tanë dhe të huaj.

- Metoda **1 – 2** dhe **3 – 4**, e cila është një përmbledhje bazë e teknikave të ekzekutimit në këtë instrument.
- Metoda e Wm.f.Lutwig.
- Metoda "Modern school for snare drum" - Morris Goldenberg.
- Metoda "Master the Drums" - Gianluca Capitani etj. janë metoda që në përmbajtjen e tyre kanë elementet bazë teknike dhe muzikore që do t'i shërbejnë një perkusionisti të ardhshëm. Pas përfundimit të këtij cikli mësimor, në nivelin më të lartë vlerësues, duke paraqitur vlerat e tij më të larta, nxënësi është i aftë të konkurrojë për në Akademinë e Arteve të Bukura.

Në perkusion bëjnë pjesë veglat me goditje, p.sh.: snare (trumpet), ksilofon, timpan, drums, bateri etj.

3.VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt:*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,
  me intonacion jo të këndshëm,
  me shkallë shpejtësie të ulët e
  me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- luan *mirë:*
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

Shënim. Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kanto**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Kanto", nxënësi:

- ✓ përvetëson *elementet teknike* dhe *artistike* të programit të detyruar;
- ✓ zhvillon shprehitë teknike, ekzekutuese dhe gjykuese mbi ushtrimet dhe pjesët (të huaja dhe shqiptare), që përcaktohen në program;
- ✓ zhvillon regjistrin e vokalit në gjithë shtrirjen e mundshme të tij;
- ✓ të interpretojë ushtrimet e pjesët duke zhvilluar aftësitë krijuese të tij brenda kërkesave teknike artistike;
- ✓ interpreton me ndjenjë dhe me emocion programin artistik të përcaktuar.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kanto"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Rezultatet e pritshme**
Programi teknik	**Ushtrime** **14 ushtrime teknike dhe melodike të thjeshta:** Concone: ushtrime melodike. Vaccai: ushtrime teknike. Panofka: ushtrime teknike. **Metodat:** -Ushtrime për frymëmarrjen me diafragmë. -Vokaliza për impostimin e zërit (tingëllimi i drejtë dhe në rezonancë i tij). -Ushtrime për hapjen e gojës në mënyrë sa më natyrale.	***Nxënësi:*** ➢ këndon saktë ushtrimet teknike dhe melodike; ➢ realizon drejt mbështetjen në diafragmë.; ➢ realizon saktë teknikisht impostimin e vokalit.
Programi artistik shqiptar	**Pjesë shqiptare** ❯ 3 – 4 pjesë nga kompozitorë shqiptarë. ❯ Këngë popullore: -*"Vinte cika"* - *"Karafilat që ka Shkodra"*, - *"Asaman, trëndafili celës" etj.*	➢ Interpreton saktë dhe në mënyrë korrekte; ➢ Interpreton pa ekzagjerime; ➢ dallon ndryshimin e pjesëve shqiptare nga ato të huaja gjatë interpretimit; ➢ këndon pastër nga ana teknike

	) Romanca shqiptare nga autorët: A.Mulaj, T. Harapi, L.Dizdari, K.Kono etj.	dhe melodike; ➢ këndon duke respektuar karakterin e aries; ➢ merr njohuri rreth autorit të pjesës.
Program artistik i huaj	**Pjesë të thjeshta nga autorë të huaj**) 1 – 2 arie antike të kompozitorëve të shek. XVI, XVII dhe XVIII: - G. Caccini, - B. Marcello, - Vivaldi, - Scarlatti, - Pergolese, - Monteverdi, - Cavalli, - Martini, - Bononcini, - Handel, - Fasolo, - Falconieri, - Lotti, - Calsara, - Gluck etj.) Liede ose arie të vogla: - Mozart, - Handel, - Gluck etj.	

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho e parë**	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik:) kryhen 5 – 6 kontrolle teknike përgjatë vitit;) 1 – 2 ushtrime të thjeshta teknike dhe melodike.	Programi në saxho: 2 ushtrime të thjeshta teknike melodike. 1 këngë popullore ose romancë nga: autorë shqiptarë, autorë të huaj. Një pjesë të thjeshtë nga autorët: Mozart, Shubert, Shuman. 1 arie antike.	***Programi në saxho:***) 2 ushtrime të thjeshta teknike melodike.) 1 këngë popullore ose romancë nga:) autorë shqiptarë,) autorë të huaj.) 1 arie antike nga autorët:) G. Caccini,) B. Marcello, Vivaldi,) A. Scarlatti etj.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kanto**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kanto"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Kërkesat për nxënësin**
Programi teknik	**Ushtrime** - 14 ushtrime teknike dhe melodike të shkallës mesatare të vështirësisë. - Concone: ushtrime teknike op.9 dhe op.10. - Vaccai: ushtrime teknike. - Panofka: ushtrime teknike. - Zaidler: ushtrime teknike. - Bordogni: ushtrime teknike. - ABT: ushtrime teknike.	***Nxënësi:*** ➢ këndon saktë ushtrimet teknike dhe melodike; ➢ realizon saktë teknikisht impostimin e vokalit; ➢ realizon notat akute; ➢ realizon saktë pasazhet teknike.
Programi artistik	**Pjesë:** 8 – 10 *pjesë* nga kompozitorë shqiptarë dhe të huaj. *Romanca shqiptare* nga autorët: - L. Dizdari, - A. Mula, - A. Peci, - Gjoka, - V.Nova, - G. Cako etj.	➢ Interpreton saktë dhe në mënyrë korrekte veprën muzikore; ➢ realizon gjatë këndimit karakteristikat kryesore të pjesëve shqiptare apo të huaja; ➢ nejh jetën dhe veprimtarinë e kompozitorit të veprës që këndon; ➢ këndon pastër nga ana teknike dhe melodike; ➢ këndon duke respektuar karakterin e pjesëve të marra; ➢ interpreton me ndjenjë pjesët muzikore brenda karakterit dhe dinamikës së pjesës.
	Pjesë të autorëve të huaj *Luide dhe romanca* nga autorët: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven etj. *Arie* nga opera ose *oratorio* dhe *kantata* të autorëve: Bah, Handel, Moxart etj. *Arie* nga operat e shekullit XIX, nga autorët: Verdi, Pucini,	

	Rossini, Donizetti etj. **Arie antike** Arie antike të autorëve të shek. XVI,XVII dhe XVIII, si: - G. Caccini, - B. Marcello, - Vivaldi, - Scarlatti, - Pergolesi, - Monteverdi, - Cavalli, - Martini, - Bononcini, - Handel, - Fasolo, - Falconieri, - Lotti, - Calsara, - Gluck etj.	

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho e parë**	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: Kryhen 5-6 kontrolle teknike përgjatë vitit. 2-3 ushtrime me shkallë mesatare vështirësie teknike dhe melodike.	**Program në saxho:** *1 ushtrim* teknike dhe melodike. *Romancë* nga autorë shqiptarë. *Lide dhe romanca* nga: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven etj. *Arie* nga operat e shekullit XIX: Pucini, Verdi, Rossini etj. *Arie antike* të shekullit XVI, XVII dhe XVIII: Monteverdi, Pergolesi, Vivaldi, Gluck etj. *Arie* nga *oratorio* dhe *kantata* të autorëve: Bah, Handel, Moxart etj.	**Programi në saxho:** 1 *ushtrim* të shkallës mesatare të vështirësisë. *Romancë* nga autorë shqiptarë. *Lide dhe romanca* nga: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven, etj. *Arie* nga operat e shekullit XIX: Pucini, Verdi, Rossini, etj. Arie antike të shekullit XVI, XVII dhe XVIII: Monteverdi, Pergolesi, Vivaldi, Gluck, etj.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Kanto**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 4 orë/javë = 136 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Kanto"

Programi i detyrueshëm	**Repertori muzikor**	**Kërkesat për nxënësin**
Programi teknik	**Ushtrime** - 5 ushtrime melodike. - Concone: ushtrime teknike op.9 dhe op.10. - Vaccai: ushtrime teknike. - Panofka: ushtrime teknike. - Zaidler: ushtrime teknike. - Bordogni: ushtrime teknike. - ABT: ushtrime teknike.	***Nxënësi:*** ➢ këndon saktë ushtrimet teknike dhe melodike; ➢ realizon saktë teknikisht impostimin e vokalit; ➢ realizon notat akute; ➢ realizon saktë pasazhet teknike; ➢ këndon, duke respektuar frazat; ➢ respekton shenjat e ngjyrimit.
Programi artistik	**Pjesë:** 8 – 10 *pjesë* nga kompozitorë shqiptarë dhe të huaj. *Romanca shqiptare* nga autorët: - P. Jakova, - L. Dizdari, - A. Mula - A. Peci, - V.Nova, - K. Kono, - N. Zoraqi etj.	➢ Interpreton saktë dhe në mënyrë korrekte veprën muzikore; ➢ realizon gjatë këndimit karakteristikat kryesore të pjesëve shqiptare apo të huaja; ➢ realizon saktë karakteristikat e operas italiane, duke bërë dallimet midis arieve dhe arieve antike; ➢ njeh subjektin e operave, nga të cilat këndon arie të ndryshme; ➢ njeh jetën dhe veprimtarinë e kompozitorit të veprës që këndon; ➢ këndon pastër nga ana teknike dhe melodike; ➢ këndon, duke respektuar karakterin e pjesëve të marra; ➢ interpreton me ndjenjëpjesët muzikore brenda karakterit dhe dinamikës së pjesës.
	Pjesë të autorëve të huaj *Lide dhe romanca* nga autorët: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven, etj. *Arie nga oratorio dhe kantata* të autorëve: Bah, Handel, Moxart etj. *Arie* nga operat e shekullit XIX, nga	

	autorët: Verdi, Pucini, Rossini etj. **Arie antike** Arie antike të autorëve të shek. XVI,XVII dhe XVIII, si: - Monteverdi, - Pergolesi, - Vivaldi, - Gluck etj.	

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho e parë**	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik: 2-3 ushtrime melodike.	**Program në saxho:** 1 *ushtrim*i shkallës së lartë të vështirësisë. *Romancë* nga opera apo operetta dhe nga autorë shqiptarë. *Lide dhe romanca* nga: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven, etj. *Arie nga operat* e shekullit XIX: Pucini, Verdi, Rossini etj. *Arie antike* të shek. XVI, XVII dhe XVIII: Monteverdi, Pergolesi, Vivaldi, Gluck etj. *Arie nga oratorio dhe kantata* të autorëve: Bah, Handel, Moxart etj.	**Programi në saxho:** 1 *ushtrim melodik* të shkallës mesatare të vështirësisë. *Romancë*nga autorë shqiptarë. *Lide dhe romanca* nga: Brams, Shubert, Belini, Mendelson, Bethoven, etj. *Arie* nga operat e shekullit XIX: Pucini, Verdi, Rossini, etj. *Arie antike* të shek. XVI, XVII dhe XVIII: Monteverdi, Pergolesi, Vivaldi, Gluck, etj. *Arie nga oratorio dhe kantata* të autorëve: Bah, Handel, Moxart etj.

2. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Për të bërë të mundur përvetësimin e programit mësimor dhe arritjen e niveleve sa më të larta në ekzekutimin muzikor në kanto, mësuesit dhe nxënësit duhet të kenë të qartë fazën e punës me të cilën kanë hyrë.

Klasa X është shumë e rëndësishme për përcaktimin e bazave mbi të cilat do të mbështetet puna gjatë katër vjetëve të studimit. Program i studimit fillon me fokusimin në katër fusha të rëndësishme: ritëm, tonalitet, timbër dhe stil. Gjithashtu ata do të përvetësojnë elementet teknike dhe artistike të programit të detyruar të kantos, duke zhvilluar shprehitë teknike, ekzekutuese dhe gjykuese mbi ushtrimet dhe pjesët (të huaja dhe shqiptare), që përcaktohen në program. Zhvillimi i rregjistrit të vokalit është shumë i rëndësishëm në gjithë shtrirjen e mundshme të tij. Ekzekutimi dhe interpretimi i ushtrimeve dhe pjesëve është shumë i rëndësishëm për krijimin e figurës së një këngëtari, duke zhvilluar aftësitë krijuese brenda kërkesave teknike artistike.

4.VLERËSIMI

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- ✓ interpreton jo në ritëm,
- ✓ interpreton me vokal të vogël,
- ✓ interpreton me intonacion jot ë këndshëm,
- ✓ nuk është i saktë në kapjen e notave acute,
- ✓ ka mangësi në interpretimin e pasazheve teknike,
- ✓ i mungon interpretimi emocional dhe në karakter,
- ✓ bën disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar, kur:

- ✓ interpreton mirë ritmikisht, me vokal e me intonacion,
- ✓ i mungon interpretimi emocional, legato, mimika, kap me vështirësi notat akute,
- ✓ këndon pastër e pa gabime,
- ✓ është i ftohtë emocionalisht.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- ✓ interpreton shumë mirë të gjitha elementet e mësipërme.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë**
Klasa: **X**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. Rezultatet e pritshme

Në përfundim të mësimit të lëndës "Fizarmonikë", nxënësi:

- ✓ realizon elementet teknike dhe artistike në lojën në instrument;
- ✓ realizon shprehitë ekzekutive bazë për zhvillimin e aparatit lëvizor dhe aftësitë gjykuese në këtë mosh;
- ✓ zhvillon tek etydet tingullin dhe frazën e qartë në tempin real të tyre, duke rritur aftësitë vetëkrijuese;
- ✓ realizon tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë, gradualisht në të gjitha elementet e teknikës së lojës në fizarmonikë;
- ✓ zhvillon aftësitë vetëkrijuese dhe interpretative;
- ✓ luan me ndjenjë dhe emocion gjithë programin e përcaktuar.

2. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"

Program i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë muzikore** - Me tri shenja shartimi. - Paralele me dy duart. - Me linja të kundërta. - Me tercë në bas. - Arpezhet/akordet. - Me përmbysjet e tyre. - Paralel me dy duart.	***Nxënësi:*** ➢ realizon teknikisht shkallën; ➢ zhvillon tingullin; ➢ sistemon lëvizjet e kacekut.
Ushtrime unison	**Ushtrime unison - Hanon**	➢ Artikulon mirë gishtat në të dyja duart; ➢ unifikon lojën e dy duarve.
Pjesë polifonike	**Burre, invecion, prelude dhe minuete** - Bah, - Moxart, - Shubert etj.	➢ Të zhvillojë shprehitë ekzekutive; ➢ të zhvillojë frazën e qartë dhe shprehitë interpretative.
Ushtrime teknike dhe etyde	**Ushtrime teknike** **Metodat:** - Cerni, - Anzaghi, - Farfisa, - Fugazza - Kramer etj.	➢ Të zhvillojë tingullin dhe organizimin e tij në temp të shpejtë; ➢ të realizojë frymëmarrjen e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore.

Pjesë shqiptare	**Pjesë shqiptare** ⁾ Krajka, ⁾ F. Deda, ⁾ A.Peçi, ⁾ A.Balliçi etj.	➢ Të realizojë teknikisht pjesën, frazat, tempin; ➢ të ndajë në blloqe partin, duke evidentuar momentet e vështira; ➢ të realizojë pjesën në karakterin e duhur; ➢ të zhvillojë aftësitë shprehëse dhe interpretative.
Pjesë të huaja	**Pjesë klasike:** uverturë, poloneze, sonate, tokatë etj. ⁾ Mozart, ⁾ Oginski, ⁾ Bellini, ⁾ Frontini, ⁾ Rossini, ⁾ Cimarosa, ⁾ Bach etj. **Pjesë variete:**Vals, tango, polka, swing, jazz,blues, rumba etj. ⁾ Galliano, ⁾ Piazzolla, ⁾ Astier, ⁾ Shopen, ⁾ Shtraus, ⁾ Larcange, ⁾ Murena etj. **Pjese kontemporane**: ⁾ B.Dowlasz, ⁾ R.Poterov etj.	➢ Të realizojë partin duke evidentuar momentet e vështira teknike; ➢ të realizojë gjatë luajtjes tempin dhe frazat; ➢ të realizojë teknikisht pjesët muzikore; ➢ të punojë frazat në bazë të logjikës teknike e muzikore; ➢ të ekzekutojë pjesën në stilin e duhur, duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale.

Klasa X		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik (4 ⁾ 1shkallë maxhore, minore,arpezhe dhe akorde. ⁾ 1 ushtrim unison hanon. ⁾ 2 etyde.	***Programi në saxho*** ⁾ Pjesë shqiptare. ⁾ Pjesë polifonike. ⁾ Pjesë variete. ⁾ Pjesë kontemporane .	***Programi në saxho*** ⁾ Pjesë shqiptare. ⁾ Pjesë polifonike. ⁾ Pjesë variete. Pjesë kontemporane .

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë**
Klasa: **XI**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"

Program i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë muzikore** - Me gjashtë shenja shartimi. - Paralele me dy duart. - Me linja të kundërta. - Me tercë në bas. - Arpezhet/akordet. - Me përmbysjet e tyre. - Paralel me dy duart.	***Nxënësi :*** ➢ realizon teknikisht shkallën; ➢ Unifikon lojën me dy duart; ➢ zhvillon tingullin; ➢ Sistemon frazën dhe lëvizjet e kacekut.
Ushtrime unison	**Ushtrime unison - Hanon**	➢ Artikulon mirë gishtat në të dyja duart; ➢ unifikon lojën e dy duarve dhe tingullin; ➢ Interpreton me temp të shpejtë; ➢ Luan me tingull të plotë.
Pjesë polifonike	**Prelude, invencione dhe fuga:** - Bah, - Hendel, - Shubert etj.	➢ Zhvillon mirë frazën, duke sistemuar lëvizjet e kacekut; ➢ zhvillon shprehitë ekzekutive; ➢ zhvillon frazën e qartë ➢ shprehitë interpretative.
Ushtrime teknike	**Ushtrime teknike** - Cerni, - Anzaghi, - Farfisa, - Kramer, - Heler, - Fugazza, - Shenderev vetj.	➢ Organizon tingujt me temp të shpejtë; ➢ realizon frymëmarrjen e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore; ➢ zhvillon aftësitë ekzkekutive.
Pjesë shqiptare	**Pjesë shqiptare** - Krajka, - F. Deda, - A. Balliçi - F.Deda etj.	➢ Realizon teknikisht pjesën, frazat, tempin; ➢ ndan në blloqe partin, duke evidentuar momentet e vështira; ➢ realizon pjesën në karakterin e duhur; ➢ zhvillon aftësitë shprehëse dhe interpretative.
	Pjesë kontemporane: suitë	

Pjesë të huaja	⟩ Zolatorio ⟩ Poterov ⟩ Derbenko etj. **Pjesë variete:**valse,tango,samba,rumba,xhaz ⟩ Galliano ⟩ Astier ⟩ Vlasov ⟩ Larcange ⟩ Shtraus etj. P**jesë klasike:** sonatë ⟩ Moxart ⟩ Skarlati ⟩ Hajden etj.	➢ Realiozon gjatë luajtjes tempin dhe frazat; ➢ realizon teknikisht pjesët muzikore; ➢ Luan në karakterin e duhur. ➢ punon frazat në bazë të logjikës teknike e muzikore; ➢ ekzkeuton pjesën në stilin e duhur duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale.

Klasa XI		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik (4) ⟩ 1shkallë maxhore, minore,arpezhe dhe akorde. ⟩ 1 ushtrim unison hanon ⟩ 2 etyde.	***Programi në saxho*** ⟩ Pjesë shqiptare. ⟩ Pjesë polifonike. ⟩ Pjesë variete. ⟩ Pjesë kontemporane .	***Programi në saxho:*** ⟩ Pjesë shqiptare. ⟩ Pjesë polifonike. ⟩ Pjesë variete. Pjesë kontemporane.

Dega: **Muzikë**
Specialiteti: **Fizarmonikë**
Klasa: **XII**
Sistemi: **Arsimi i mesëm i lartë**
Kohëzgjatja: **34 javë x 3 orë/javë = 102 orë**

1. Përmbajtjet tematike të lëndës "Fizarmonikë"

Program i detyrueshëm	Repertori muzikor	Rezultatet e pritshme
Shkallë muzikore	**Shkallë muzikore të të gjitha formave** - Maxhore dhe minore. - Paralele me dy duart. - Me linja të kundërta. - Me terca. - Me seksta. - Me oktava. - Arpezhet/akordet. - Me përmbysjet e tyre. - Paralel me dy duart.	***Nxënësi:*** ➢ realizon të gjitha elementet tekniketë shkallëve; ➢ realizon saktë tingujt; ➢ zhvillon tingullin; ➢ realizon në sinkron të dy duart gjatë luajtjes në instrument.
Pjesë polifonike	**Prelude, invencione, fuga, tokata dhe fantazi** - Bah, - Moxart, - Hendel etj.	➢ Luan me tingull të plotë veprat; ➢ luan aplikaturat e caktuara; ➢ zhvillon mirë frazën duke sistemuar lëvizjet e kacekut; ➢ zhvillon shprehitë ekzekutive dhe shprehitë interpretative.
Etyde	**Etyde** **Metodat:** - Farfisa, - Kramer - Cerni, - Anzaghi, - Heler, - Shenderev etj.	➢ Realizon mirë tingujt me temp të shpejtë; ➢ realizon frymëmarrjen dhe lëvizjet e kacekut mbi bazën e logjikës teknike e muzikore; ➢ zhvillon aftësitë ekzekutive.
Pjesë shqiptare	**Fantazi, pjesë koncertale, valle instrumentale, muzikë filmash** - A.Peçi - A. Krajka - F.Deda etj.	➢ Realizon teknikisht pjesën, frazat, tempin; ➢ Luan në karakterin e veprës; ➢ Respekton simbolet muzikore në partiturën e veprës; ➢ realizon pjesën në karakterin e duhur; ➢ zhvillon aftësitë shprehëse dhe interpretative.
	Pjesë klasike **Pjesë kontemporane** **Variete** (koncert,suitë, sonatë, temë me	

Pjesë të huaja	variacion,uverturë, vals, polka, tango etj) - Shtraus, - Shopen, - Duleu, - Brams, etj. - Shtraus, - Criscio, - Frossini, etj. - Monti, - O. Metra, - Bize, - Frontini, - Rossini etj.	➢ Realizon të gjitha elemnetet teknike dhe artistike të veprave; ➢ rrealizon gjatë luajtjes tempin dhe frazat; ➢ realizon teknikisht pjesët muzikore në bazë të logjikës teknike e muzikore; ➢ ekzekuton pjesën në stilin e duhur, duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale.

Klasa XII		
Kontrolle teknike	**Saxho**	
	Saxho e parë	**Saxho e dytë**
Programi në kontroll teknik (2) - 1shkallë maxhore me të gjitha shenjat e shartimit, minore,arpezhe dhe akorde - 2 etyde	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë polifonike. - Pjesë variete. - Pjesë kontemporane . Sipas të gjitha pjesëve të sugjeruara në program	***Programi në saxho*** - Pjesë shqiptare. - Pjesë polifonike. - Pjesë me variacion. - Pjesë ciklike. - Pjesë variete. Pjesë kontemporane.

2.UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Dihet që fillimi i mirë dhe i saktë i procesit mësimor për luajtjen në instrument që në temat e para, krijon premisa që nxënësi të aftësohet dhe të ekzekutojë lirshëm, duke interpretuar shumë mirë muzikalisht. Mësuesi duhet t'i japë një rëndësi të veçantë që në fillim, vendosjes së duarve mbi tastierë, harkimit të bukur të gishtave, mbajtjes së lirë të pulsit të dorës. Gjithashtu kaceku ka rëndësi shumë të madhe, sepse përdorimi jo i mirë i tij, copëton frazën muzikore dhe dëmton interpretimin e një pjese muzikore, kur e hapim në mes të masës ose frazës. Nxënësi duhet të realizojë të gjitha elementet teknike, të organizojë tingujt gradualisht në temp të shpejtë, të realizojë teknikisht pjesën, frazat, tempin, të zhvillojë aftësitë shprehëse dhe interpretative, duke realizuar të gjitha elementet teknike dhe artistike gjatë luajtjes. Një rëndësi e veçantë duhet t'i jepet edhe ekzekutimit të pjesëve në stilin e duhur, duke zhvilluar më tej aftësitë interpretative individuale.

Rekomandime për kontrollet teknike dhe saxhot

- Programi teknik bazë është ndërtuar mbi metodat italiane të mësimit të fizarmonikës: **Farfisa 1-2, Anzaghi etj.**
- Gjatë vitit shkollor zhvillohen 4 kontrolle teknike.
- Në çdo kontroll teknik luhen në mënyrë të detyrueshme :
  - 1 shkalle (maxhore , minore) arpezhe, akorde;
  - 1 ushtrim hanon;
  - 2 etyde

  Gjatë vitit shkollor zhvillohen dy saxho:
- Pjesë shqiptare.
- Pjesë polifonike.
- Polka , vals , tango , etj.
- Pjesë klasike.
- Pjesë kontemporane.
- I gjithë programi luhet përmendësh.
- Ndryshimi i programit dhe zëvendësimi i veprave mund të bëhet në varësi të nivelit të nxënësit.

3.VLERËSIMI

Vlerësimi në kontrollet teknike dhe në saxho bëhet në mënyrë kolegjiale. Për njohjen e drejtpërdrejtë të punës së nxënësit në klasë, mësuesi i lëndës ka të drejtë të ulë ose të ngrejë një notë. Mbi bazën e **3 notave, 2 kontrolleve teknike dhe 1 saxho**, vendoset nota semestrale.

Nxënësi arrin nivelin e ulët, kur:

- luan jo *korrekt*
  me ritëm,
  me tingull mesatar,
  me intonacion jo të këndshëm,
  me shkallë shpejtësie të ulët e
  me disa gabime.

Nxënësi arrin nivelin mesatar kur:

- luan *mirë*
  ritmikisht,
  me tingull e me intonacion,
  pastër e me pak gabime.

Nxënësi arrin nivelin e lartë, kur:

- luan *shumë mirë* në të gjitha elementet e mësipërme.

<u>Shënim.</u> Pjesët mund të zëvendësohen nga ana e mësuesit specialist me pjesë të të njëjtit nivel.